



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 155

Tiranë – E mërkurë, 25 tetor 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 564, datë 5.10.2023	Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, z. Endrit Hoxha 16831
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 565, datë 5.10.2023	Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Nina Guga 16832
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 566, datë 5.10.2023	Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Albana Tole 16833
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 604/1, datë 17.10.2023	Për një ndryshim në urdhrin e ministrit të Drejtësisë nr. 604, datë 16.10.2023, “Për delegim kompetence” 16835
Vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr. 41, datë 18.9.2023	Me objekt shfuqizimi e vendimit nr. 00-2022-1630 (279), datë 14.7.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rigjykim në të njëjtën gjykatë, me tjetër trup gjykues..... 16835
Vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr. 42, datë 19.9.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-959, datë 6.6.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues..... 16848
Vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr. 43, datë 19.9.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1201 (246), datë 16.6.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rigjykim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë..... 16863

Vendim i Gjykatës Kushtetuese,
nr. 44, datë 26.9.2023

Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt
ligjor si rezultat i mosgjykimit nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të
Përgjithshëm Tiranë të çështjes nr. 21234-02321-30-2022, datë
regjistrimi 17.11.2022

Konstatimin e mungesës së një mjeti ligjor efektiv për përshpejtimin e
gjykimit.....

16876

Vendim i Gjykatës së Shkallës së
Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm
Berat nr. 414, datë 26.5.2023

Vendim (i shkurtuar) për zëvendësimin e kujdestarit të shtetasës Vasilika
Qytyku.....

16888

**URDHËR****Nr. 564, datë 5.10.2023****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE
DHE CAKTIMIN E DETYRAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT TË ARSIMIT
DHE SPORTIT, Z. ENDRIT HOXHA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neneve 22 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, z. Endrit Hoxha, për ushtrimin e kompetencave në fushën e sportit.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të kryejë detyrat e mëposhtme:

a) Ndjek dhe nënshkruan akte për zbatimin e programit të qeverisë lidhur me hartimin, zbatimin dhe monitorimin strategjive kombëtare në fushën e sportit, si dhe planeve të veprimit në zbatim të tyre;

b) Kontribuon në hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, për organizimin dhe veprimtarinë në fushën e sportit;

c) Inicion dhe ndjek përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore bazuar në planin e miratuar të akteve dhe rregulloreve;

ç) Trajton dhe miraton standardet dhe kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, në fushën e sportit, si dhe monitoron zbatimin e tyre;

d) Siguron të dhëna të detajuara dhe analiza periodike për politikën e zhvillimit të sportit;

dh) Ndjek dhe monitoron zbatimin e planit të veprimit për organizimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, si dhe në ushtrimin e detyrave të tyre profesionale;

e) Trajton dhe nënshkruan programet e financimit dhe investimeve në fushën e sportit,

përfshirë edhe ato që lidhen me digitalizimin, si dhe ndjek dhe monitoron ecurinë e zbatimit të tyre;

ë) Nënshkruan dhe drejton grupe pune me nëpunës të MAS-it apo të strukturave vartëse për hartimin e akteve ligjore, nënligjore në fushën e sportit, verifikime të veprimtarive të organizatave sportive, si dhe ndjek procesin për realizimin e detyrave të tyre;

f) Nënshkruan, ndjek dhe monitoron zbatimin e programeve dhe projekteve në fushën e sportit;

g) Nënshkruan, ndjek dhe monitoron programet në fushën e sportit dhe planet e veprimit në zbatim të legjislacionit në fuqi;

gj) Ndjek dhe monitoron performancën e strukturave arsimore të varësisë, duke marrë masa për organizimin e punës me strukturat përgjegjëse, me fokus AFS-në dhe institucionet e varësisë që kanë fokus dhe objekt të punës sportin;

h) Trajton, nënshkruan, ndjek dhe monitoron projektet strategjike dhe programet sportive, duke bashkërenduar punën me ministritë e linjës dhe institucionet partnere ndërkombëtare;

i) Drejton grupe pune, në funksion të analizimit të programeve e projekteve dhe inicion përmirësimin e tyre në bashkëpunim me partnerë dhe ekspertë vendës dhe të huaj;

j) Nënshkruan dhe miraton rregulloret tip të institucioneve të varësisë dhe manualët operacionale tip, për punën e institucioneve të sportit;

k) Nënshkruan statutet dhe ndryshimet statutores të organizatave sportive, heqjen e emërimit “Federatë Shqiptare”, sipas legjislacionit në fuqi, shkresat që u drejtohen institucioneve paralele për çështje të antikorupsionit dhe bashkëqeverisjes;

l) Trajton dhe nënshkruan shpërblimet e sportistëve elitare;

ll) Trajton dhe monitoron kthimin e përgjigjeve për shkresat, kërkesat dhe ankesat e ardhura nga institucionet shtetërore dhe organizmat e tjerë për fushën e sportit;

m) Trajton dhe nënshkruan përgjigjet për kontrollet dhe raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të auditit të brendshëm, sipas fushës së përgjegjësisë të koordinuara nga Sekretari i Përgjithshëm;

n) Përfaqëson ministrinë në këshilla vendës apo të huaj, grupe pune ndërinstitucionale, komisione sipas delegimit përkatës për fushën e përgjegjësisë që mbulon apo evente të tjera;



n) Përfaqëson institucionin në grupe pune lidhur me fushën e sportit, me qëllim hartimin dhe ndjekjen e programeve, projekteve dhe politikave sportive në vend;

o) Bashkëpunon dhe koordinon punën me zëvendësministrat për çështjet e arsimit, për çështje të caktuara që i përkasin edhe fushës së përgjegjësisë dhe veprimtarisë së dy ose më shumë zëvendësministrave;

p) Informon periodikisht dhe sa herë është e nevojshme, ndjekjen e detyrave dhe zbatimin e tyre, pranë Kabinetit të Ministrit;

q) Ndjek procedurat e ngarkuara apo të autorizuar nga ministri bazuar në legjislacionin në fuqi.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë të lehtësojë dhe mbështesë zëvendësministrin për përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

4. Ngarkohet zëvendësministri, z. Endrit Hoxha, dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu

URDHËR

Nr. 565, datë 5.10.2023

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE DHE KAKTIMIN E DETYRAVE TË ZËVENDËSMINISTRIT TË ARSIMIT DHE SPORTIT, ZNJ. NINA GUGA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neneve 22 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Nina Guga, për

ushtrimin e kompetencave në fushën e arsimit parauniversitar.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të kryejë detyrat e mëposhtme:

a) Ndjek dhe nënshkruan të gjitha aktet për zbatimin e programit të qeverisë lidhur me hartimin, zbatimin dhe monitorimin strategjive kombëtare në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe planeve të veprimit në zbatim të tyre;

b) Kontribuon në hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, për organizimin dhe veprimtarinë në fushën e arsimit parauniversitar;

c) Inicion dhe ndjek përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore bazuar në planin e miratuar të akteve dhe rregulloreve;

d) Trajton, nënshkruan dhe monitoron zbatimin e standardeve dhe kritereve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, në fushën e arsimit parauniversitar;

dh) Drejton dhe koordinon me institucionet përgjegjëse realizimin dhe monitorimin e Maturës Shtetërore dhe trajton e nënshkruan të gjitha aktet për realizimin e saj, në përputhje me legjislacionin dhe politikën e MAS-it;

e) Siguron të dhëna të detajuara dhe analiza periodike për politikën e zhvillimit të arsimit parauniversitar;

ë) Ndjek dhe monitoron zbatimin e planit të veprimit për organizimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, si dhe në ushtrimin e detyrave të tyre profesionale;

f) Nënshkruan, ndjek dhe monitoron ecurinë e programeve të financimit të arsimit parauniversitar, investimeve në arsimin parauniversitar, përfshirë edhe ato që lidhen me digjitalizimin e arsimit parauniversitar;

g) Nënshkruan dhe drejton grupe pune me nëpunës të MAS-it apo të strukturave vartëse për hartimin e akteve ligjore, nënligjore në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe ndjek procesin për realizimin e detyrave të tyre;

gj) Nënshkruan, ndjek dhe monitoron zbatimin e programeve dhe projekteve në fushën e arsimit parauniversitar;

h) Ndjek dhe monitoron Programet dhe Planet e Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Arsimit dhe planet e veprimit në zbatim të legjislacionit në fuqi;



i) Ndjek, monitoron dhe nënshkruan akte që lidhen me performancën e strukturave arsimore të varësisë, duke marrë masa për organizimin e punës me strukturat përgjegjëse, me fokus strukturat e DPAP-së, ASCAP-it dhe institucionet e varësisë që kanë fokus dhe objekt të punës arsimin parauniversitar;

j) Ndjek, monitoron dhe nënshkruan akte që lidhen me projektet strategjike dhe programet arsimore, duke bashkërenduar punën me ministrinë e linjës dhe institucionet partnere ndërkombëtare;

k) Nënshkruan ngritjen e grupeve të punës dhe i drejton ato në funksion të analizimit të programeve e projekteve dhe inicion përmirësimit të tyre në bashkëpunim me partnerë dhe ekspertë vendës dhe të huaj;

l) Nënshkruan dhe miraton rregulloret tip të institucioneve të varësisë dhe manualët operacionale tip, për punën e institucioneve të arsimit parauniversitar;

ll) Trajton dhe nënshkruan shkresat që u drejtohen institucioneve paralele për çështje të antikorrupsionit dhe të bashkëqeverisjes;

m) Ndjek dhe nënshkruan kthimin e përgjigjeve për shkresat, kërkesat dhe ankesat e ardhura nga institucionet shtetërore dhe organizmat e tjerë për fushën e arsimit parauniversitar;

n) Nënshkruan dhe trajton dhënien e lejeve dhe të licencave në fushën e arsimit parauniversitar, apo miratimin e drejtuesve didaktik dhe kritereve të tjera të licencimit në arsimin parauniversitar;

nj) Trajton dhe nënshkruan përgjigjet për kontrollat dhe raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të auditit të brendshëm, sipas fushës së përgjegjësisë të koordinuara nga Sekretari i Përgjithshëm;

o) Përfaqëson ministrinë në këshilla vendës apo të huaj, grupe punë ndërinstitucionale, komisione, sipas delegimit përkatës për fushën e përgjegjësisë që mbulon apo evente të tjera.

p) Përfaqëson institucionin në grupe pune, lidhur me fushën e arsimit, me qëllim hartimin dhe ndjekjen e programeve, projekteve dhe politikave arsimore në vend;

q) Bashkëpunon dhe koordinon punën me zëvendësministrat për çështjet e arsimit të lartë dhe sportit, për çështje të caktuara që i përkasin edhe fushës së përgjegjësisë dhe veprimtarisë së dy ose më shumë zëvendësministrave;

r) Ndjek procedurat e ngarkuara apo të autorizuar nga ministri, bazuar në legjislacionin në fuqi;

rr) Informon periodikisht dhe sa herë është e nevojshme, ndjekjen e detyrave dhe zbatimin e tyre, pranë Kabinetit të Ministrit.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë të lehtësojë dhe mbështesë zëvendësministrin për përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

4. Ngarkohet zëvendësministri, znj. Nina Guga, për zbatimin e këtij urdhri dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 566, datë 5.10.2023

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE
DHE CAKTIMIN E DETYRAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT TË ARSIMIT
DHE SPORTIT, ZNJ. ALBANA TOLE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neneve 22 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Albana Tole, për ushtrimin e kompetencave në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të kryejë detyrat e mëposhtme:

a) Ndjek dhe nënshkruan akte për zbatimin e programit të qeverisë lidhur me hartimin, zbatimin dhe monitorimin strategjive kombëtare në fushën e



arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe planeve të veprimit në zbatim të tyre;

b) Kontribuon në hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, për organizimin dhe veprimtarinë në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

c) Inicion dhe ndjek përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore bazuar në planin e miratuar të akteve dhe rregulloreve;

ç) Monitoron dhe organizon punën për zbatimin e strategjive kombëtare për arsimin në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor dhe nënshkruan akte që lidhen me to, përfshirë programet dhe planet e veprimit të Strategjisë Kombëtare të Arsimit dhe Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe planet e veprimit të tyre, në zbatim të legjislacionit në fuqi;

d) Trajton dhe miraton standarde dhe kriterë të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe monitoron zbatimin e tyre;

dh) Siguron të dhëna të detajuara dhe analiza periodike për politikat e zhvillimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

e) Ndjek dhe monitoron zbatimin e planit të veprimit për organizimin dhe për zhvillimin e burimeve njerëzore, si dhe në ushtrimin e detyrave të tyre profesionale;

ë) Trajton dhe nënshkruan programet e financimit dhe të investimeve në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, përfshirë edhe ato që lidhen me digitalizimin, si dhe ndjek dhe monitoron ecurinë e zbatimit të tyre;

f) Nënshkruan dhe drejton grupe pune me nëpunës të MAS-it apo të strukturave vartëse për hartimin e akteve ligjore, nënligjore në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe ndjek procesin për realizimin e detyrave të tyre;

g) Trajton dhe nënshkruan lejet për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të institucioneve të arsimit të lartë për të gjitha ciklet e studimit, certifikimin e kapaciteteve pritëse dhe rialokimin e kuotave të miratuara brenda njëjësive kryesore;

gi) Trajton dhe miraton statutet dhe ndryshimet statutorë të institucioneve të arsimit të lartë;

h) Nënshkruan, ndjek dhe monitoron zbatimin e programeve dhe projekteve në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

i) Ndjek dhe monitoron performancën e strukturave arsimore të varësisë, duke marrë masa për organizimin e punës me strukturat përgjegjëse, me fokus strukturat e AKFAL-it, AKKSHI-t, ASCAL-it dhe institucionet e varësisë, që kanë fokus dhe objekt të punës arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor;

j) Nënshkruan, ndjek dhe monitoron projektet strategjike dhe programet e studimit të të gjitha cikleve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, duke bashkërenduar punën me ministritë e tjera dhe të gjitha institucionet partnere kombëtare dhe ndërkombëtare;

k) Drejton grupe pune, në funksion të analizimit të programeve e projekteve dhe inicion përmirësimin e tyre në bashkëpunim me partnerë dhe ekspertë vendës dhe të huaj;

l) Nënshkruan dhe miraton rregulloret tip të institucioneve të varësisë dhe manualët operacionale tip, për punën e institucioneve të varësisë në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

ll) Trajton dhe nënshkruan shkresat që u drejtohen institucioneve paralele për çështje të antikorrupsionit dhe bashkëqeverisjes, në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

m) Trajton dhe monitoron kthimin e përgjigjeve për shkresat, kërkesat dhe ankesat e ardhura nga institucionet shtetërore dhe organizmat e tjerë për fushën e arsimit të lartë;

n) Trajton dhe nënshkruan përgjigjet për kontrollet dhe raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të auditit të brendshëm sipas fushës së përgjegjësisë, të koordinuara nga Sekretari i Përgjithshëm;

nj) Përfaqëson ministrinë në këshilla vendës apo të huaj, grupe pune ndër-institucionale, komisione sipas delegimit përkatës për fushën e përgjegjësisë që mbulon apo evente të tjera;

o) Përfaqëson institucionin në grupe pune lidhur me fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, me qëllim hartimin dhe ndjekjen e programeve, projekteve dhe politikave arsimore në vend;

p) Bashkëpunon dhe koordinon punën me zëvendësministrat për çështjet e arsimit parauniversitar dhe sportit, për çështje të caktuara që i përkasin edhe fushës së përgjegjësisë dhe veprimtarisë së dy ose më shumë zëvendësministrave;



q) Informon periodikisht dhe sa herë është e nevojshme ndjekjen e detyrave dhe zbatimin e tyre, pranë Kabinetit të Ministrit;

r) Ndjek procedurat ngarkuara ose autorizuar nga ministri bazuar në legjislacionin në fuqi.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të lehtësojë dhe mbështesë zëvendësministrin për përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

4. Ngarkohet zëvendësministri, znj. Albana Tole, dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu

URDHËR

Nr. 604/1, datë 17.10.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN E MINISTRIT TË DREJTËSISË NR. 604, DATË 16.10.2023, “PËR DELEGIM KOMPETENCE”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

Në pikën 1, të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 603, datë 16.10.2023, “Për delegim kompetence”, bëhet ndryshimi si vijon:

Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për datat 17.10.2023 deri më 20.10.2023, zëvendësministrit të Drejtësisë, z.Klajd Karameta.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

VENDIM

Nr. 41, datë 18.9.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 14.9.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (D) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: DRITAN XHIXHA

SUBJEKT I INTERESUAR:

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
POLICISË SË SHTETIT

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1630 (279), datë 14.7.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në të njëjtën gjykatë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 41, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “P”, 132, pika 1 dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (*DPPSH*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Dritan Xhixha ka qenë në marrëdhënie shërbimi me Policinë e Shtetit. Fillimisht ai është pranuar në Policinë e Shtetit më datë 10.3.1994 dhe është emëruar në repartin “RENEA”, shërbim që është ndërprerë më datë 29.7.1995, kur është nxjerrë në lirim për shkurtrim të funksionit organik. Ai është ripranuar në Policinë e Shtetit më datë 16.7.1997, kur është emëruar përsëri në repartin “RENEA”, ndërsa shërbimi në këtë rast ka vijuar deri më datë 30.6.2002, kur është liruar me kërkesën e tij. Më pas, kërkuesi është ripranuar në Policinë e Shtetit më datë 16.7.2002, kur është emëruar në Drejtorinë e Policisë së qarkut Elbasan, shërbim ky që ka vijuar deri më datë 1.5.2003. Së fundi, kërkuesi është ripranuar në Policinë e Shtetit më datë 24.11.2011, kur me urdhrin nr. 114, nxjerrë në bazë të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, ai është emëruar përsëri në repartin “RENEA”.

2. Gjatë vijimit të marrëdhënies së shërbimit, në zbatim të detyrimeve sipas ligjit nr. 138/2015, datë 17.12.2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” (ligji nr. 138/2015), të ndryshuar, kërkuesi ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit. Me qëllim verifikimit të saktësisë së deklarimeve, sipas kriterëve të këtij ligji, kërkuesi ka depozituar edhe shenjat daktiloskopike sipas detyrimit ligjor. Në kuadër të verifikimit të deklarimeve të bëra nga kërkuesi në formularin e vetëdeklarimit, është administruar informacioni nr. 5391/8, datë 12.10.2017 i Institutit të Policisë Shkencore (IPSH), sipas të cilit, pas krahasimit në sistemin AFIS/APIK të gjurmëve të gishtave të kërkuesit, ka rezultuar se ai kishte në bazën e të dhënave, sipas sistemit AFIS, një kartelë daktiloskopike, pa të dhëna se ku dhe kur është marrë (informacioni i IPSH-së).

3. Referuar informacionit të IPSH-së, Drejtoria e Standardeve Profesionale në DPPSH ka filluar ndaj kërkuesit një hetim disiplinor. Kërkuesi është njoftuar me shkresën nr. 39/29K prot., datë 11.12.2017, me të cilën i bëhet e ditur se do të kryhen hetime për shkeljen e rëndë dhe shkakun për të cilin ka filluar hetimi disiplinor, konkretisht e dhëna në informacionin e IPSH-së.

4. Gjatë hetimit disiplinor kërkuesit i janë kërkuar sqarime dhe ai ka deklaruar: “Shumë kohë më parë kur kam qenë në moshe të re, isha pa filluar punë në strukturat e Policisë së Shtetit dhe si djem të rinj qëndronim pasditeve së bashku në lagje. Nuk mund të kujtoj kohën e saktë, periudhën kohore, por kujtoj se kam qenë shoqëruar nga grupet e gatshme të policisë të asaj kohe, konkretisht në Komisaratin e Policisë nr. 2, Tiranë. Lidhur me këtë rast ishim së bashku me disa shokë të tjerë banorë të lagjes dhe pasi na kanë marrë gjurmët, jemi lënë të lirë. Theksoj se nuk jam shoqëruar për kryerjen e një veprë penale apo të jem proceduar penalisht, sikurse nuk kam thirrur në prokurori apo gjykatë lidhur me këtë fakt apo për ndonjë ngjarje tjetër. Për sa kam deklaruar në Formularin e Deklarimit për zbatimin e ligjit nr. 138, viti 2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, janë të vërteta dhe nuk ka asgjë për të deklaruar më tepër apo të kem fshehur ndonjë të dhënë në kundërshtim me këtë ligj.”. Po kështu, është kërkuar informacion nga Sektori i Policisë Shkencore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë, Tiranë (DVP-ja, Tiranë), i cili, me shkresën nr. 314/1, datë 23.2.2018, ka informuar se kërkuesi është daktiloskopuar në Komisaratin e Policisë nr. 2, Tiranë në vitin 1989, për “tendenca të ndryshme”.

5. Krahas kësaj, gjatë hetimit disiplinor është kërkuar informacion nga Drejtoria e Analizës së Informacionit Kriminal nëse për kërkuesin janë evidentuar të dhëna sipas kriterëve të udhëzimit të ministrit të Brendshëm nr. 56/1, datë 27.5.2013 “Për përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave”. Në përgjigjen nr. 2084/1, datë 15.2.2018, kjo drejtori ka informuar se kërkuesi figuron i regjistruar si person me precedent kriminal nga strukturat e hetimit të krimit në DVP-në, Tiranë (informacioni i Drejtorisë së Analizës së Informacionit Kriminal).

6. Në përfundim të hetimit disiplinor, me vendimin nr. 173, datë 26.3.2018, drejtori i Departamentit për Sigurinë Publike pranë DPPSH-së (vendimi i drejtorit të Departamentit për Sigurinë Publike), ka marrë ndaj kërkuesit masën disiplinore “Përfshirje nga policia”, bazuar në nenin 46, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 108/2014, datë 31.7.2014 “Për Policinë e Shtetit” (ligji nr. 108/2014) dhe në nenin 182, pika 2, shkronja “d”, të rregullores së Policisë së Shtetit (miratuar me VKM-në nr. 750, datë 16.9.2015).



7. Vendimi i drejtorit të Departamentit për Sigurinë Publike është ankimuar administrativisht nga kërkuesi përpara Komisionit Qendror të Apelit (KQA) pranë DPPSH-së. KQA-ja, me vendimin nr. 110, datë 26.3.2018 (*vendimi i KQA-së*), ka vendosur ta konsiderojë të motivuar masën “Përfshirje nga Policia” dhënë ndaj kërkuesit, duke vlerësuar se janë respektuar procedurat standarde të hetimit disiplinor dhe se pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë. Sipas komisionit, hetimi disiplinor ndaj kërkuesit ka filluar për shkeljen e rëndë, sipas nenit 205, pika 3, të rregullores së Policisë së Shtetit, që parashikon se punonjësi i policisë është përgjegjës për sjellje të rëndë diskredituese, nëse gjatë aplikimit për t’u pranuar në polici apo edhe pas pranimit, nuk është i sinqertë dhe nuk ka thënë të vërtetën me gojë dhe shkrim, në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të kaluarën e tij, dokumentacionin e paraqitur, pa marrë parasysh nëse janë nën betim ose jo. Në përfundim të hetimit disiplinor është arritur në konkluzionin se ai ka kryer shkeljen disiplinore “Sjellje e rëndë diskredituese”, pasi ka rezultuar se: - kërkuesi është shoqëruar në Komisaratin e Policisë nr. 2, Tiranë, ku pas procedurave është lënë i lirë, jo për kryerjen prej tij ose të përfshirjes në veprimtari kriminale; - kërkuesi figuron i regjistruar si person me precedent kriminal, me dosje të arkivuar, nga strukturat e hetimit të krimit në DVP-në, Tiranë sipas informacionit të Drejtorisë së Analizës së Informacionit Kriminal. Mbi këtë bazë, për kërkuesin konstatohet “Pavlefshmëri e aktit administrativ të pranimit”, bazuar në nenin 46, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 108/2014 dhe në nenin 182, pika 2, shkronja “d”, të rregullores së Policisë së Shtetit, referuar informacionit të Drejtorisë së Analizës së Informacionit Kriminal.

8. Në vijim, me urdhrin nr. 2363, datë 14.6.2018, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka urdhëruar përjashtimin e kërkuesit nga Policia e Shtetit për “Pavlefshmëri të aktit administrativ të pranimit”, të parashikuar në nenin 46, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 108/2014 dhe nenin 182, pika 2, shkronja “d”, të Rregullores së Policisë së Shtetit (*urdhri i përjashtimit nga Policia e Shtetit*).

9. Kërkuesi ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar shfuqizimin e urdhrin të përjashtimit nga Policia e Shtetit dhe të vendimit të KQA-së, që ka lënë në fuqi vendimin e drejtorit të Departamentit për Sigurinë Publike. Ai ka pretenduar se aktet

administrative të kundërshtuara janë të paligjshme dhe masa disiplinore e dhënë është shumë e rëndë. Sipas tij, pranimi në Policinë e Shtetit është bërë në përputhje me ligjin dhe gjatë gjithë karrierës në polici ai ka punuar me korrektësi, përgjegjësi dhe përkushtim, duke mos u ndëshkuar asnjëherë me masë disiplinore. Në formularin e vetëdeklarimit, sipas ligjit nr. 138/2015, nuk ka deklaruar të dhëna të rreme dhe as ka fshehur të dhëna që duheshin deklaruar prej tij. Për sa u përket të dhënave daktiloskopike, ato janë marrë pas shoqërimit të tij në vitin 1989, kur ka qenë në moshën 17-18 vjeç dhe, për këtë shkak, nuk e mbante mend, ndërkohë që nuk ka pasur asnjë komunikim nëse ka qenë person nën hetim ose në procedim penal. Së fundi, nuk ka pasur asnjë precedent penal, çka provohet me vërtetimin e gjendjes gjyqësore.

10. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3729, datë 22.10.2018, ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se kërkuesi nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për plotësimin e formularit të vetëdeklarimit konform kërkesave të ligjit nr. 138/2015 dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, duke mos pasqyruar të dhënat në rubrikën nr. 4 të këtij formulari. Në pikën 3, shkronja “ç”, të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë parashikohet se pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta passjell përjashtimin e menjëhershëm nga strukturat e Policisë së Shtetit. Fakti që kërkuesi nuk mban mend situatën konkrete për të cilën është shoqëruar në polici, nuk e përjashton nga përgjegjësia në deklarimin e saktë të të dhënave. Për shkak të detyrës së veçantë të ushtruar në shërbim të publikut ai ka pasur detyrimin të deklarojë të dhënat e mësipërme dhe pretendimet e tij nuk e përjashtojnë nga përgjegjësia disiplinore. Veprimet e tij janë konsideruar “Sjellje e rëndë diskredituese”, sipas nenit 205, pikat 3 dhe 10, të rregullores së Policisë së Shtetit, që përbëjnë shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 46, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 108/2014, që parashikon: “2. Punonjësi i policisë lirohet nga policia në rastet kur: ...; d) konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ të pranimit;...”. (*shih faqet 8-9 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*). Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

11. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 522(86-2021-636), datë 18.10.2021, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së



shkallës së parë, duke pranuar padinë dhe shfuqizuar urdhrin e përjashtimit nga Policia e Shtetit dhe vendimin e KQA-së, si dhe ka detyruar DPPSH-në të rikthejë kërkuesin në detyrën e mëparshme dhe t'i paguajë pagën që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies financiare, deri në ekzekutimin e vendimit. Në vendimin e saj, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se aktet objekt padie janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin.

12. Gjykata e apelit ka arsyetuar se ligji nr. 108/2014 ka parashikuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme rastet kur punonjësi i policisë lirohet nga detyra dhe ato që motivojnë përjashtimin nga Policia e Shtetit, si dhe pasojat për secilin rast, të cilat, gjithashtu, janë të ndryshme. Për të garantuar karrierën policore, por edhe për mirëfunksionimin e Policisë së Shtetit, lrimi ose përjashtimi nga shërbimi publik i punonjësit të policisë duhet të mbështetet në njërin prej rasteve të parashikuar nga ligji, që, pikësepari, duhet të respektohen nga organet e Policisë së Shtetit, sipas procedurave përkatëse. Përjashtimi i kërkuesit nga policia është bërë për motivin “Pavlefshmëri e aktit administrativ të pranimit”, në zbatim të nenit 46, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr.108/2014. Kjo dispozitë rregullon rastet e lirimit dhe jo të përjashtimit nga policia, ndaj aktet objekt padie janë të paligjshme si të marra në interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit.

13. Po kështu, gjykata e apelit ka arsyetuar se referuar të dhënave të hetimit disiplinor, organi publik nuk argumenton dhe provon rrethanat e faktit që e bëjnë të papranueshëm, në kuptim të ligjit, vijimin e marrëdhënies së punësimit për kërkuesin. Lidhur me përmbushjen e detyrimeve sipas ligjit nr. 138/2015, kërkuesi ka plotësuar formularin përkatës, ndërkohë që e dhëna për daktiloskopimin e tij në vitin 1989 nuk përfshihet në asnjë nga situatat që ky ligj ka përcaktuar në mënyrë shteruese, për më tepër që për kërkuesin nuk ka asnjë akt që provon ekzistencën e të dhënave sipas kushteve të ndalimit që ligji parashikon. Lidhur me pranimin e kërkuesit në polici, referuar të dhënave të dosjes së tij personale, për sa i përket ecuresë së marrëdhënies së punës së tij, si dhe legjislacionit që ka rregulluar ndër vite punësimin e tij në Policinë e Shtetit, është i pabazuar përfundimi i organit publik për pavlefshmërinë e aktit administrativ të pranimit të kërkuesit në polici (*shih faqet 16-20 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*).

14. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs DPPSH-ja përmes Avokaturës së Shtetit. Pasi është njohur me rekursin, kërkuesi ka paraqitur kundërrekurs. Më datë 17.12.2021, Avokatura e Shtetit ka paraqitur edhe një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit.

15. Fillimisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të gjykatës së apelit. Në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 69/13, datë 25.2.2022, Kolegji ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 522 (86-2021-636) datë 18.10.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit.

16. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar rekursin e DPPSH-së dhe kundërrekursin e kërkuesit. Në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-1630 (279), datë 14.7.2022, ai Kolegj ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kolegji ka vlerësuar se rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Administrative të Apelit.

17. Sipas Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga gjykata e apelit është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit material e procedural, të një rëndësie themelore për sigurinë dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Nga ana tjetër, ai e ka vlerësuar të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se fakti që kërkuesi nuk mban mend situatën konkrete për të cilën është shoqëruar në polici, nuk e përjashton atë nga përgjegjësia në mosdeklarimin e saktë të të dhënave, pasi për shkak të detyrës së veçantë të ushtruar në shërbim të publikut, ai ka pasur detyrimin t'i deklarojë ato dhe pretendimet e tij nuk e përjashtojnë nga përgjegjësia disiplinore, referuar nenit 205 të rregullores së Policisë së Shtetit.

18. Kolegji Administrativ ka vlerësuar, gjithashtu, se marrëdhënia e punësimit, në rastin objekt gjykimi, ka natyrën e kontratës së shërbimit publik, ndaj integriteti është qenësor për veprimtarinë e mirëfilltë të një punonjësi të Policisë së Shtetit dhe ushtrimi i kësaj detyre duhet të jetë në përputhje me standarde të larta të integritetit dhe etikës, si para shërbimit në këto struktura, ashtu dhe pas pranimit në to.



Pavarësisht se kërkuesi ka deklaruar se shoqërimi i tij në polici ishte një rrethanë që nuk e mbante mend, kjo nuk e shkarkon nga përgjegjësia për mosdeklarimin e saj.

19. Me kërkesën e datës 27.12.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1630 (279), datë 14.7.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Kolegji i Gjykatës, më datë 17.3.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

20. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

20.1 *Të drejtën e aksesit* nëpërmjet njoftimit të parregullt për seancën gjyqësore, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar kërkuesin për zhvillimin e procedurës në adresën elektronike të avokates së tij, në zbatim të nenit 482, pika 3, të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), ndonëse i kishte të dhënat e saj, si për sa i përket shqyrtimit të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, ashtu edhe për shqyrtimin e rekursit dhe të kundërrekursit. Ajo gjykatë ka njoftuar në adresën elektronike vetëm vendimin përfundimtar të datës 14.7.2022 të Kolegjit Administrativ. Në këtë mënyrë, ajo gjykatë i ka mohuar të drejtën për të paraqitur pretendime me shkrim për kërkesën për pezullimin e vendimit të gjykatës së apelit, si dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin e trupit gjykues që ka shqyrtuar themelin e çështjes, e drejtë e lidhur me *parimin e paanshmërisë në gjykim*. Për sa i përket kësaj të fundit, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen me procedurë të përshpejtuar, ndonëse nuk kishte urgjencë për shqyrtim dhe palët nuk e kishin kërkuar, për më tepër që në atë gjykatë janë ende në pritje për t'u shqyrtuar çështje të tjera të regjistruara edhe më parë. Po kështu, dy nga anëtarët e trupit gjykues që kanë shqyrtuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, kanë shprehur mendime që i kanë përsëritur edhe në

arsyetimin e vendimit të themelit, çka përbën argument për paragjykimin e çështjes.

20.2. *Standardin e arsyetimit të vendimit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, duke arsyetuar qëndrimin e tij në vetëm dy paragrafë, të cilët, për më tepër, paraqesin mospërputhje mes faktit të pretenduar dhe pasojës që ka përcaktuar ligji. Konkretisht, për faktin e pavlefshmërisë së aktit të pranimit në polici, neni 46, pika 2, shkronja “d”, i ligjit nr. 108/2014 ka përcaktuar si masë disiplinore lirin nga detyra dhe jo përjashtimin nga policia. Po kështu, Gjykata e Lartë, ndonëse ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, nuk ka arsyetuar në lidhje me argumentet mbi të cilat është bazuar për të rrëzuar arsyetimin dhe qëndrimin e kësaj të fundit, sipas së cilës kërkuesi nuk ishte i detyruar që të deklaronte faktin e shoqërimit të tij në polici dhe marrjen e shenjave daktiloskopike, pa pasur asnjë procedim penal ndaj tij. Për shkak të mangësisë në arsyetim, Gjykata e Lartë nuk ka realizuar as funksionin e saj kushtetues për t'u treguar palëve që ato janë dëgjuar, si dhe për t'u dhënë mundësinë për ta kundërshtuar atë vendim.

21. **Subjekti i interesuar, DPPSH-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

21.1 Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit, për shkak të njoftimit të parregullt për seancën gjyqësore, është i pabazuar, pasi gjykimi i çështjeve administrative nga Gjykata e Lartë, si rregull, bëhet në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve, sipas nenit 61, pika 1, të ligjit nr. 49/2012 dhe, sikurse në rastin konkret, njoftimi është bërë në përputhje me nenin 482 të KPC-së, përmes shpalljes në ambientet e saj, si dhe në faqen e internetit. Ajo gjykatë njoftimin individual e bën në ato raste kur, për një çështje konkrete, ka vendosur shqyrtimin në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Po kështu, pjesëmarrja e gjyqtarëve në të dyja vendimet nuk krijon dyshime për mosrespektimin e parimit të paanshmërisë, pasi vendimi i pezullimit është një vendim i ndërmjetëm, në bazë të të cilit, gjyqtarët vlerësojnë pasojat e rënda që mund të shkaktohen nga ekzekutimi i vendimit të formës së prerë, si dhe pariparueshmërinë e situatës. 21.2 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë përmban pjesën hyrëse, palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatave më të ulëta, faktin se kundër



vendimit të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs, si dhe shkaqet e tij. Në pjesën arsyetuese të vendimit, ajo gjykatë është shprehur se rekursi i DPPSH-së përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së, duke vendosur në përfundim edhe rrëzimin e padisë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

22. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

23. Gjykata vëren se kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në përfundim të të cilit është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen.

24. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, ankuesi duhet të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 56, datë 25.7.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin konkret, kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pas zhvillimit të gjykimit në të tria shkallët e gjyqësorit të

zakonshëm, duke shteruar kështu mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Pretendimet që ai parashtron në substancë në këtë ankim lidhen me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për rrjedhojë ai nuk ka në dispozicion ndonjë mjet tjetër ankimi, përveç ankimit kushtetues individual.

26. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata vëren se procesi gjyqësor ka përfunduar me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 14.7.2022, i cili është komunikuar në mënyrë elektronike nga administrata e asaj gjykate më datë 31.8.2022, në adresën e avokates së kërkuarit, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur më datë 27.12.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

27. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë në aspektet e së drejtës së aksesit në lidhje me parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe standardit të arsyetimit të vendimit, të cilat hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të shqyrtohen në vijim në lidhje me bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit në lidhje me parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme

28. Kërkuari ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për zhvillimin e procedurës në adresën elektronike të avokates së tij, në zbatim të nenit 482, pika 3, të KPC-së, ndonëse i kishte të dhënat e saj, si për sa i përket shqyrtimit të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, ashtu edhe për shqyrtimin e rekursit dhe të kundërrekursit. Ajo gjykatë ka njoftuar në adresën elektronike vetëm vendimin përfundimtar të datës 14.7.2022 të Kolegjit Administrativ. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë i ka mohuar të drejtën për të paraqitur pretendime me shkrim për kërkesën për pezullimin e vendimit të gjykatës së apelit, si dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin e trupit gjykues që ka shqyrtuar themelin e çështjes, si një e drejtë e lidhur me parimin e paanshmërisë në gjykim. Për sa i përket kësaj të fundit, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen me procedurë të përsheptuar, ndonëse nuk kishte urgjencë për shqyrtim dhe palët



nuk e kishin kërkuar, për më tepër që në atë gjykatë janë ende në pritje për t'u shqyrtuar çështje të tjera të regjistruara edhe më parë. Po kështu, dy nga anëtarët e trupit gjykues që kanë shqyrtuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, kanë shprehur mendime që i kanë përsëritur edhe në arsyetimin e vendimit të themelit, çka përbën argument për paragjykimin e çështjes.

29. Subjekti i interesuar, DPPSH-ja, ka prapësuar se gjykimi i çështjeve administrative nga Gjykata e Lartë, si rregull, bëhet në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve, sipas nenit 61, pika 1, të ligjit nr. 49/2012 dhe, sikurse në rastin konkret, njoftimi është bërë në përputhje me nenin 482 të KPC-së përmes shpalljes në ambientet e saj, si dhe në faqen e internetit. Ajo gjykatë njoftimin individual e bën në ato raste kur për një çështje konkrete ka vendosur shqyrtimin në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Po kështu, pjesëmarrja e gjyqtarëve në të dyja vendimet nuk krijon dyshime për mosrespektimin e parimit të paanshmërisë, pasi vendimi i pezullimit është një vendim i ndërmjetëm, në bazë të të cilit gjyqtarët vlerësojnë pasojat e rënda që mund të shkaktohen nga ekzekutimi i vendimit të formës së prerë, si dhe pariparueshmërinë e situatës.

30. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

31. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se nëse mohohet e drejta e aksesit, procesi konsiderohet i parregullt, sepse kjo e drejtë, para së gjithash, është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2023; nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, Gjykata ka evidentuar rëndësinë e së drejtës për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, e cila u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Gjithashtu, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave

vetjakë në raport me palën kundërshtare. Për sa i takon procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë të dokumenteve, duhet t'u garantojë palëve të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe të kenë mundësinë që t'i kundërshtojnë ato ose të paraqesin argumentet e tyre për çështjen (*shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 17, datë 1.3.2017; nr. 29, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Po kështu, Gjykata ka pohuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017; nr. 30, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Duke iu referuar çështjes konkrete, Gjykata vëren se kundër vendimit të gjykatës së apelit, DPPSH-ja, përmes Avokaturës së Shtetit, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë më datë 16.12.2021, që i është njoftuar kërkuarit më datë 9.1.2022, i cili më 14.1.2022 ka paraqitur kundërrkurs. Gjithashtu, rezulton se më datë 17.12.2021 Avokatura e Shtetit ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit që i është komunikuar kërkuarit më datë 8.2.2022 përmes dëftesës së komunikimit nr. 69/13, datë 3.2.2022, të marrë në dorëzim nga një pjesëtar i familjes së tij. Pas shqyrtimit të kërkesës së Avokaturës së Shtetit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 69/13, datë 25.2.2022, ka vendosur pranimin e saj. Vendimi i është komunikuar kërkuarit më datë 5.4.2022, përmes dëftesës së komunikimit nr. 69/13, datë 31.3.2022, të marrë në dorëzim sërish nga një pjesëtar i familjes së tij.

34. Për sa i përket shqyrtimit të rekursit, nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, Gjykata e Lartë më datë 27.6.2022 ka publikuar në faqen zyrtare dhe në ambientet e saj listën e çështjeve të planifikuara për shqyrtim në dhomën e këshillimit nga Kolegji Administrativ më datë 14.7.2022, mes të cilave edhe çështjen e kërkuarit. Në përfundim të shqyrtimit, ky Kolegji, me vendimin nr. 00-2022-1630 (279), datë 14.7.2022, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të



gjykatës së shkallës së parë. Vendimi është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe, po kështu, më datë 31.8.2022 është njoftuar edhe në adresën e postës elektronike të avokates së kërkuesit.

35. Gjykata evidenton se, sipas nenit 482, pika 3, të KPC-së, njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual, kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit.

36. Nga sa më lart, Gjykata konstaton se në rastin në shqyrtim nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë realizuar njoftimin individual të kërkuesit lidhur me seancën për shqyrtimin e rekursit dhe të kundërrekursit, pavarësisht se ai ka lënë të dhënat elektronike të avokates së tij, tek adresa e së cilës, pas shqyrtimit, ka dërguar tekstin e vendimit përfundimtar.

37. Në këtë kontekst faktesh, Gjykata vëren se mungesa e njoftimit në adresën elektronike të avokates së kërkuesit përbën mangësi në mënyrën e njoftimit të palëve, megjithatë një mangësi e tillë nuk rezulton ta ketë vendosur kërkuesin në pozita të pafavorshme lidhur me të drejtën e aksesit në aspektin substancial. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, Gjykata mban në konsideratë faktin se, nga njëra anë, kërkuesi ishte njoftuar rregullisht për rekursin e paraqitur nga pala tjetër, ndaj të cilit ai ka paraqitur kundërrekurs. Po kështu, njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues ka qenë i afishuar nga Gjykata e Lartë si në këndin e njoftimeve në ambientet fizike, ashtu edhe në faqen elektronike të saj. Në rekursin e paraqitur nga DPPSH-ja janë ngritur të njëjtat pretendime që nuk janë pranuar më parë nga gjykata e apelit, ndërkohë që kërkuesi e ka kundërshtuar atë përmes kundërrekursit, duke parashtruar argumente qoftë në drejtim të pabazueshmërisë së rekursit të palës kundërshtare, ashtu dhe për sa i përket bazueshmërisë së vendimit të gjykatës së apelit. Nga ana tjetër, në ankimin kushtetues individual kërkuesi nuk ka evidentuar se ka pasur ndonjë argument thelbësor të ri të parashtruar më parë, i cili potencialisht mund ta kishte bindur Gjykatën e Lartë që të ndryshonte mënyrën e zgjidhjes së çështjes së tij. Për më tepër, kjo e fundit ka shqyrtuar në themel shkaqet e rekursit, që do të thotë se ka analizuar dhe vlerësuar

pozitën dhe të drejtat e kërkuesit në raport me vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta.

38. Gjithashtu, Gjykata vëren se brenda një afati kohor të shkurtër (më pak se 5 muaj), Gjykata e Lartë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, vendim i cili është dërguar në adresën e kërkuesit. Pra, në rastin konkret ekzistonin shkaqe objektive-ligjore për shqyrtimin me përparësi të çështjes, për shkak të specifikës që kanë çështje të kësaj natyre (*shih paragrafin 27 të vendimit nr. 00-2022-1630 (279), datë 14.7.2022 të Gjykatës së Lartë*). Kjo do të thotë se kërkuesi, në rrethana të tilla, duhet të tregonte një kujdes të shtuar për të ndjekur fatin e çështjes dhe se pretendimi se Gjykata e Lartë, duke e shqyrtuar çështjen me procedurë të përsheptuar nuk ka qenë e paanshme, nuk është i bazuar. Për rrjedhojë, mangësia e konstatuar për sa i përket njoftimit të datës së seancës në adresën elektronike të avokates së kërkuesit, në kontekst të rastit konkret, nuk mund të klasifikohet si shkelje thelbësore që e bën të parregullt në kuptimin kushtetues procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

39. Po kështu, për sa i përket faktit se dy gjyqtarë kanë marrë pjesë në trupin gjykues të Kolegjit Administrativ që ka shqyrtuar rekursin, pasi kishin qenë anëtarë edhe të trupit gjykues që ka shqyrtuar kërkesën për pezullimin e vendimit të gjykatës së apelit, Gjykata çmon se pavarësisht se *prima facie* proceset gjyqësore kanë të bëjnë me të njëjtat palë dhe, në thelb, i referohen të njëjtit proces, pretendimet dhe kërkimet në to janë të natyrave të ndryshme dhe me baza ligjore të ndryshme. Në procesin për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit nuk janë shqyrtuar në substancë shkaqet e rekursit, si dhe nuk rezulton që ata gjyqtarë të kenë qenë në situatën që të jenë shprehur më parë në lidhje me të. Po kështu, përmes vendimeve në fjalë, është disponuar për kërkesa që kanë karakteristika të dallueshme dhe që bazohen në konsiderata e vlerësime të ndryshme të gjyqtarëve. Në këto kushte, vetëm mënyra e arsyetimit në vendimin për kërkesën e pezullimit të vendimit të gjykatës së apelit nuk përbën argument të mjaftueshëm, për sa i përket qëndrimit të shprehur nga gjyqtarët në vendimin përfundimtar, për rrjedhojë pjesëmarrja në trupin gjykues të të njëjtëve gjyqtarë në dy vendimet e dhëna, nuk krijon dyshim të justifikuar për paragykimin e çështjes nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.



40. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit, për shkak të njoftimit për ditën e seancës gjyqësore vetëm me shpallje në faqen zyrtare dhe në ambientet e Gjykatës së Lartë, dhe mungesës së këtij njoftimi në adresën elektronike të avokates së tij të vënë në dispozicion, e parë kjo lidhur me cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, është i pabazuar.

B.2 Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

41. Kërkuarisi ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, duke arsyetuar qëndrimin e tij në vetëm dy paragrafë, të cilët, për më tepër, paraqesin mospërputhje mes faktit të pretenduar dhe pasojës që ka përcaktuar ligji. Konkretisht, për faktin e pavlefshmërisë së aktit të pranimit në polici, neni 46, pika 2, shkronja “d”, i ligjit nr. 108/2014, ka përcaktuar si masë disiplinore lirim nga detyra dhe jo përjashtimin nga policia. Po kështu, Gjykata e Lartë, ndonëse ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, nuk ka arsyetuar në lidhje me argumentet mbi të cilat është bazuar për të rrëzuar arsyetimin dhe qëndrimin e kësaj të fundit, sipas së cilës kërkuarisi nuk ishte i detyruar të deklaronte faktin e shoqërimit të tij në polici dhe marrjen e shenjave daktiloskopike, pa pasur asnjë procedim penal ndaj tij. Për shkak të mangësisë në arsyetim, Gjykata e Lartë nuk ka realizuar as funksionin e saj kushtetues për t’u treguar palëve që ato janë dëgjuar, si dhe për t’u dhënë atyre mundësinë për të kundërshtuar atë vendim.

42. Subjekti i interesuar, DPPSH-ja, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është i pabazuar, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë përmban pjesën hyrëse, palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatave më të ulëta, faktin se kundër vendimit të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs dhe shkaqet e tij. Në pjesën arsyetuese të vendimit, ajo gjykatë është shprehur se rekursi i DPPSH-së përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së, duke vendosur rrëzimin e padisë.

43. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë

procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Ai, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 29 datë 1.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur apo të fshehtë (*shih vendimet nr. 19, datë 1.4.2021; nr. 20, datë 13.4.2012; nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Duke iu referuar çështjes konkrete, Gjykata vëren se në rekursin e DPPSH-së është kundërshtuar vendimi i gjykatës së apelit, me pretendimin se nuk ka respektuar dhe ka zbatuar keq ligjin, pasi padia është ngritur përtej afateve ligjore; aktet e kundërshtuara janë të ligjshme dhe të bazuara në faktet e konstatuara gjatë procesit hetimor; pretendimi për rikthimin në punë është i pamundur për shkak të qëndrimit në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 108/2014 dhe të VKM-së nr. 750/2015 (rregullorja e Policisë së Shtetit). Ndërsa kërkuarisi, përmes kundërrekursit të tij, ka pretenduar se padinë e ka paraqitur pas shterimit të ankimit administrativ; për sa i përket çështjes së rikthimit në punë të punonjësit të policisë që është liruar ose përjashtuar nga detyra në bazë të një akti administrativ të paligjshëm ose të pavlefshëm, gjykata e apelit është bazuar në vendime të tjera më të fundme, të vitit 2020, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në të cilat ai Kolegji ka arsyetuar ndryshe nga praktika gjyqësore e deriatëhershme, duke e njohur të drejtën e rikthimit në punë dhe pagimin e pagave, ndërsa rregullimi i pasojave në këtë mënyrë bazohet në nenin 44 të Kushtetutës.

45. Gjykata konstaton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij ka vendosur pranimin e rekursit me arsyetimin se përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, të cilat e bëjnë të cënueshëm vendimin e gjykatës së apelit, i cili, sipas vlerësimit të Gjykatës së Lartë, është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit material dhe procedural, të një rëndësie themelore për sigurinë dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Gjykata e Lartë ka çmuar se



gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejt se fakti që kërkuesi nuk mban mend situatën konkrete për të cilën është shoqëruar në polici nuk e përjashton nga përgjegjësia në mosdeklarimin e saktë të të dhënave, pasi, për shkak të detyrës së veçantë në shërbim të publikut, ka pasur detyrimin të deklarojë të dhënat e mësipërme dhe pretendimet e tij nuk e përjashtojnë nga përgjegjësia disiplinore, sipas nenit 205, pika 3, të rregullores së Policisë së Shtetit. Integriteti është qenësor për veprimtarinë e mirëfilltë të një punonjësi të Policisë së Shtetit. Ushtrimi i kësaj detyre duhet të jetë në përputhje me standarde të larta të integritetit dhe etikës, si para shërbimit në këto struktura, ashtu dhe pas pranimit në to. Gjykata Administrative e Apelit duhet të mbante në konsideratë përmbajtjen dhe qëllimin e vërtetë të dispozitës dhe raportin e proporcionalitetit me masën disiplinore, të caktuar ndaj kërkuesit (*shih paragrafët 28, 29 dhe 30 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

46. Gjykata konstaton se kërkuesi, që nga data 10.3.1994, kur është pranuar për herë të parë në Policinë e Shtetit, në periudha të shkëputura nga njëra-tjetra, ka kryer detyra të ndryshme, duke u liruar dhe riplanuar disa herë në strukturat e saj, deri më datë 24.11.2011, kur ka rifilluar shërbimin në repartin “RENEA”, bazuar në urdhrin nr. 114, datë 1.12.2011 të drejtorit të atij reparti. Hetimi administrativ ndaj tij ka nisur nën dyshimin e mosdeklarimit të saktë dhe të plotë të të dhënave në kuadër të procedurave për verifikimin e integritetit të figurës sipas ligjit nr. 138/2015, ndërsa është verifikuar ekzistenca e një karteje daktiloskopike të kërkuesit në një nga sistemet në përdorim të Policisë së Shtetit. Nga hetimi rreth këtij fakti ka rezultuar se daktiloskopimi i kërkuesit ka ndodhur gjatë shoqërimit të tij në polici (komisariati nr. 2) për “tendenca të ndryshme” në vitin 1989, periudhë në të cilën ai nuk kryente detyrën e punonjësit të policisë dhe, për më tepër, kur ka qenë në moshën 18 vjeç. DPPSH-ja është bërë me dije për këtë fakt përmes informacionit të dhënë nga Sektori i Policisë Shkencore në DVP-në, Tiranë, por edhe përmes intervistimit të kërkuesit. Ndërkohë, gjatë hetimit disiplinor, është marrë informacion edhe nga Drejtoria e Analizës së Informacionit Kriminal të DPPSH-së, sipas të cilit kërkuesi figuron i regjistruar si “person me precedent kriminal”, me dosje të arkivuar nga strukturat e hetimit të krimit të DPV-së, Tiranë. Në vendimin nr. 110/2018 të KQA-së

evidentohen të dyja informacionet e marra gjatë hetimit disiplinor, ndërsa ajo ka arritur në përfundimin për qenien të motivuar të masës disiplinore të dhënë ndaj kërkuesit referuar vetëm informacionit të marrë nga Drejtoria e Analizës së Informacionit Kriminal të DPPSH-së, pra për sa i përket regjistrimit të kërkuesit si “person me precedent kriminal” nga strukturat e hetimit të krimit në DPV-në, Tiranë. Sipas KQA-së, referuar kësaj të dhëne, akti i pranimit të kërkuesit në Policinë e Shtetit është i pavlefshëm dhe përligj përjashtimin e kërkuesit nga policia bazuar në nenin 46, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 108/2014 dhe nenin 182, pika 2, shkronja “d”, të rregullores së Policisë së Shtetit.

47. Gjykata vëren se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se kërkuesi nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për plotësimin e formularit të vetëdeklarimit konform kërkesave të ligjit nr. 138/2015, duke mos pasqyruar të dhënat në rubrikën nr. 4 të këtij formulari. Fakti që kërkuesi nuk mban mend situatën konkrete për të cilën është shoqëruar në polici, nuk e përjashton nga përgjegjësia në deklarimin e saktë të të dhënave. Për shkak të detyrës së veçantë të ushtruar në shërbim të publikut ai ka pasur detyrimin të deklarojë të dhënat e mësipërme dhe pretendimet e tij nuk e përjashtojnë nga përgjegjësia disiplinore. Veprimet e tij janë konsideruar “Sjellje e rëndë diskredituese”, sipas nenit 205, pikat 3 dhe 10, të rregullores së Policisë së Shtetit, që përbëjnë shkelle të rënda disiplinore sipas nenit 46, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 108/2014, që parashikon: “2. Punonjësi i policisë lirohet nga policia në rastet kur: [...] d) konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ të pranimit,” (*shih faqet 8-9 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

48. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar padinë, me arsyetimin se ligji nr. 108/2014 ka parashikuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme rastet kur punonjësi i policisë lirohet nga detyra dhe ato që motivojnë përjashtimin nga policia e Shtetit. Sipas asaj gjykate, përjashtimi i kërkuesit nga policia është bërë për motivin “Pavlefshmëri e aktit administrativ të pranimit”, në zbatim të nenit 46, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 108/2014. Kjo dispozitë rregullon rastet e lirimit dhe jo të përjashtimit nga policia, ndaj aktet objekt padie janë



të paligjshme, pasi janë nxjerrë në interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit. Ndërsa lidhur me përmbushjen e detyrimeve sipas ligjit nr. 138/2015, kërkuesi ka plotësuar formularin përkatës, ndërkohë që e dhëna për daktiloskopimin e tij në vitin 1989 nuk përfshihet në asnjë nga situatat që ky ligj ka përcaktuar në mënyrë shteruese, për më tepër që për atë nuk ka asnjë akt që provon ekzistencën e të dhënave sipas kushteve të ndalimit që ligji parashikon. Për sa i takon pranimin të kërkuesit në polici, referuar të dhënave të dosjes së tij personale, në kuptim të ecures së marrëdhënies së punës së kërkuesit, si dhe legjislacionit që ka rregulluar në vite punësimin e tij në Policinë e Shtetit, është i pabazuar përfundimi i organit publik për pavlefshmërinë e aktit administrativ të pranimin të kërkuesit në polici (*shih faqet 16-20 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*).

49. Gjykata konstaton se pavarësisht se ecuria disiplinore ndaj kërkuesit ka nisur në lidhje me mospërmbushjen prej tij të detyrimeve sipas ligjit të dekriminalizimit (ligji nr. 138/2015) për sa i përket mosdeklarimit të të dhënave, referuar daktiloskopimit të tij në vitin 1989, masa disiplinore duket se është marrë në bazë të informacionit se ai figuron i regjistruar si person me precedent kriminal, me dosje të arkivuar, nga strukturat e hetimit të krimit në DVP-në, Tiranë, mbështetur në ligjin nr. 108/2014 dhe rregulloren e Policisë së Shtetit. Në këtë këndvështrim, Gjykata e Lartë, në përmbushje të funksionit të saj si gjykatë e ligjit, edhe pse e konsideron të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, nuk u ka dhënë përgjigje këtyre aspekteve të rëndësishme për çështjen: (i) cili dhe përse informacioni i konsideruar nga organi publik çon në pavlefshmëri të aktit administrativ të pranimin në polici të kërkuesit; (ii) dhe përse pavlefshmëria e këtij akti përbën shkelje disiplinore dhe çon në zbatimin e masës disiplinore të përjashtimit nga policia dhe jo atë të lirimit nga policia, referuar bazës ligjore të përdorur për nxjerrjen e urdhrit të përjashtimit. Ajo është kufizuar vetëm duke mbajtur të njëjtin qëndrim me atë të gjykatës së shkallës së parë, duke lënë jashtë analizës juridike jo vetëm çështjet e ngritura në rekurs dhe në kundërrkurs, por edhe ato çështje të lidhura me interpretimin e ligjit, të cilat do të shërbenin për të sqaruar çdo paqartësi në të kuptuarin e normës dhe për të cilat palët duhet të merrnin përgjigje të arsyetuar.

50. Për sa më lart, Gjykata çmon se ndonëse gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë pasur këndvështrime të ndryshme, për sa i përket interpretimit dhe zbatimit të ligjit që rregullon marrëdhënien mes palëve, Gjykata e Lartë, si gjykatë e ligjit, që i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të ushtruar rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, nuk ka ndikuar efektivisht në vendimmarrjen e tyre, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve që kanë formuar thelbin e mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Nën dritën e kësaj analize, pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit është i bazuar.

51. Në përfundim, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesit, sipas arsyetimit të mësipërm, është i bazuar, ndaj duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1630 (279), datë 14.7.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 18.9.2023.

Shpallur, më 20.10.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim



MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuessit Dritan Xhixha, me objekt: “*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1630 (279), datë 14.7.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajftueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në të njëjtën gjykatë me tjetër trup gjykues*”, ne, gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja dhe Sandër Beci, bashkohemi me qëndrimin e shumicës për pranimin e kërkesës, por duke vlerësuar se edhe pretendimi tjetër i kërkuessit për cenimin e së drejtës së aksesit është i bazuar.

2. Lidhur me të drejtën e aksesit, kërkuessit ka pretenduar se ndonëse Gjykata e Lartë i administronte të dhënat elektronike të kontaktit të avokates së tij, ajo nuk ka përmbushur detyrimet e parashikuara në nenin 482, pika 3, të KPC-së, pasi nuk e ka njoftuar atë për zhvillimin e procedurës, si për sa i përket shqyrtimit të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, ashtu edhe për shqyrtimin e rekursit dhe të kundërrekursit. Ajo gjykatë ka njoftuar në adresën elektronike vetëm vendimin përfundimtar të datës 14.7.2022. Në këtë mënyrë, ajo gjykatë i ka mohuar të drejtën për të paraqitur pretendime me shkrim për kërkesën për pezullimin e vendimit të gjykatës së apelit, si dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin e trupit gjykues që ka shqyrtuar themelin e çështjes, e drejtë e lidhur me parimin e paanshmërisë në gjykim.

3. Shumica ka vlerësuar se ky pretendim i kërkuessit, i parë në lidhje edhe me cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, është i pabazuar (*shih paragrafin 40 të vendimit*). Sipas saj, mungesa e njoftimit të datës së seancës në adresën elektronike të avokates së kërkuessit, nuk është shkelje thelbësore që e bën të parregullt në kuptimin kushtetues procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, pasi ajo nuk rezulton ta ketë vendosur kërkuessin në pozita të pafavorshme lidhur me të drejtën e aksesit në aspektin substancial. Nga njëra anë, kërkuessi është njoftuar rregullisht për rekursin e paraqitur nga pala tjetër, ndaj të cilit ai ka paraqitur kundërrekurs; njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues ka qenë i afishuar në këndin e njoftimeve në ambientet fizike, si dhe në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë; në rekursin e paraqitur nga DPPSH-ja janë ngritur të njëjtat pretendime që nuk janë pranuar më parë nga gjykata e apelit, ndërkohë që kërkuessi e ka kundërshtuar atë

përmes kundërrekursit, duke parashtruar argumente si në drejtim të pabazueshmërisë së rekursit të palës kundërshtare, ashtu dhe për sa i përket bazueshmërisë së vendimit të gjykatës së apelit. Ndërsa, nga ana tjetër, në ankimin kushtetues kërkuessi nuk ka evidentuar se ka pasur ndonjë argument thelbësor të ri të paparashtruar më parë, i cili potencialisht mund ta kishte bindur Gjykatën e Lartë që të ndryshonte mënyrën e zgjidhjes së çështjes së tij, e cila ka shqyrtuar në themel shkaqet e rekursit, ka analizuar dhe vlerësuar pozitën dhe të drejtat e tij në raport me vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Po sipas shumicës, brenda një afati kohor të shkurtër (më pak se 5 muaj), Gjykata e Lartë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, vendim i cili është dërguar në adresën e kërkuessit. Kjo do të thotë se kërkuessi, në rrethana të tilla, duhet të tregonte një kujdes të shtuar për të ndjekur fatin e çështjes së tij (*shih paragrafët 37 - 38 të vendimit*).

4. Nuk pajtohemi me këtë qëndrim të shumicës, pasi vlerësojmë se mosrespektimi i rregullave ligjore të njoftimit për datën dhe orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues nga Gjykata e Lartë përbën shkelje thelbësore, me pasojë cenimin e së drejtës kushtetuese të aksesit. Ashtu siç ka pohuar Gjykata në jurisprudencë konstante, e drejta për t’u njoftuar rregullisht u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih nr. 14, datë 21.3.2023; nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 13, datë 20.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata ka njohur vlerën kushtetuese të së drejtës së njoftimit të individit, duke theksuar se ajo lidhet me vendimmarrjen e gjykatës dhe ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 37, datë 30.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, njoftimi i datës e orës së gjykimit është një akt i domosdoshëm procedural, që merr rëndësi më tepër në rastin konkret ku Gjykata e Lartë ndryshon dy vendimet e gjykatave më të ulëta dhe rrëzon padinë (*shih vendimin nr. 65, datë 7.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).



5. Në vlerësimin tonë duhej që shumica të mbante në konsideratë se zhvillimet e teknologjisë së informacionit, që kanë lehtësuar komunikimin në jetën e përditshme, pavarësisht distancave gjeografike, janë reflektuar në ndryshimet legjislative, si dhe në praktikën e punës së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke forcuar garancitë për realizimin e njoftimit efektiv. Kështu, fillimisht, në vitin 2012, ligji për organizimin e gjykatave administrative dhe, më tej, ndryshimet në KPC, në vitin 2017, kanë parashikuar përdorimin e mjeteve elektronike gjatë procesit, ku krahas njoftimit me shpallje në ambientet fizike dhe në faqen elektronike të gjykatës, realizohet edhe njoftimi individual i drejtpërdrejtë në rastin kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit. Në të njëjtën linjë, Gjykata e Lartë, me urdhrin e datës 2.7.2021, ka përcaktuar detyrimin e sekretarisë gjyqësore që, përveç afishimit në këndin e njoftimit dhe shpalljes në faqen elektronike, të kryejë edhe njoftimin elektronik në adresat e postës elektronike të palëve. Në këtë situatë edhe vetë Gjykata ka pohuar se të dhënat elektronike të kontaktit përbëjnë mundësi reale në dispozicion të individit, i cili, me vullnetin e tij të lirë, zgjedh që krahas shpalljes publike të njoftohet edhe individualisht, në kushtet e zhvillimit të sotëm shoqëror, ku ai ka qasje të lehtë në internet dhe mjete elektronike (*shih vendimin nr. 34, datë 12.6.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në rastin në shqyrtim, konstatojmë se padia e kërkuarit është rrëzuar nga gjykata administrative e shkallës së parë me vendimin e datës 22.10.2018, ndërsa është pranuar nga gjykata administrative e apelit me vendimin e datës 18.10.2021. Vendimi i kësaj të fundit, më datë 16.12.2021 është kundërshtuar me rekurs nga DPPSH-ja, përmes Avokaturës së Shtetit, i regjistruar më datë 8.2.2022, ndaj të cilit kërkuari ka paraqitur kundërrekurs më datë 14.1.2022. Më datë 17.12.2021 Avokatura e Shtetit ka paraqitur kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar, e cila është pranuar nga Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi me vendimin e datës 25.2.2022. Ndërsa më datë 14.7.2022 Gjykata e Lartë ka disponuar me vendim përfundimtar për rrëzimin e padisë së kërkuarit. Më datë 27.6.2022 ajo gjykatë ka publikuar në faqen zyrtare elektronike listën e çështjeve të planifikuara për

shqyrtim në dhomën e këshillimit më datë 14.7.2022, përfshi edhe çështjen e kërkuarit. Ndërkohë nuk rezulton të jetë kryer njoftimi individual në adresën elektronike të komunikimit të lënë nga kërkuari. Vendimi përfundimtar është publikuar në faqen elektronike të gjykatës dhe më datë 31.8.2022 i është njoftuar kërkuarit në adresën e postës elektronike të avokates së tij.

7. Në kontekst të këtyre rrethanave, evidentojmë se kërkuari ka depozituar të dhënat elektronike të kontaktit të avokates së tij rregullisht, duke zgjedhur kështu një prej garancive ligjore, atë të njoftimit individual. Në këtë mënyrë ai ka pasur pritshmëri të ligjshme se do të njoftohej individualisht në adresën elektronike të avokates për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes së tij, ndaj nuk mund të ngarkohet me barrë të tepruar për të kontrolluar me kujdes në mënyrë sistematike faqen zyrtare elektronike apo për të kaluar fizikisht pranë ambienteve të Gjykatës së Lartë. Për më tepër, duke pasur në konsideratë faktin se shqyrtimi i çështjes së tij nuk ka ndjekur radhën kronologjike të regjistrimit të saj, pasi çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë më datë 8.2.2022, ndërsa vendimi është marrë më datë 14.7.2022 – pra vetëm pas 5 muajve, në një situatë të njohur publikisht për ngarkesën e jashtëzakonshme të çështjeve në Gjykatën e Lartë si pasojë e zbatimit të reformës në drejtësi, kjo barrë në ngarkim të kërkuarit rëndohet edhe më shumë. Nga ana tjetër, duke konsideruar faktet, se: (i) kërkuari nuk ka paraqitur në seancën e shqyrtimit të rekursit shpjegime apo prapësime; (ii) kërkuari ka parashtruar argumente konkrete mbi rezervat që ai ka pasur në drejtim të Gjykatës së Lartë për respektimin e parimit të paanshmërisë; (iii) dy gjykatat më të ulëta kanë dhënë vendime diametralisht të kundërta dhe Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në themel, vlerësojmë se mosrespektimi i rregullave të njoftimit elektronik nga Gjykata e Lartë përbën shkelje thelbësore, që ka ndikuar realisht në mundësinë e kërkuarit për akses substancial në Gjykatën e Lartë dhe ndoshta edhe për të marrë një vendim në favorin e tij.

8. Nën këtë analizë, ne vlerësojmë se shumica i ka vendosur kërkuarit një barrë të tepruar, pasi mungesa e njoftimit individual në adresën elektronike e ka shndërruar kufizimin e së drejtës së aksesit të lidhur me atë të mbrojtjes efektive në



arbitrar, në kushtet kur është cenuar thelbi i saj. Në këtë këndvështrim, pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit është i bazuar dhe kërkesa duhet të ishte pranuar edhe për këtë shkak.

Anëtarë: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari

VENDIM

Nr. 42, datë 19.9.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare
Marsida Xhaferllari	anëtare
Fiona Papajorgji	anëtare
Elsa Toska	anëtare
Sonila Bejtja	anëtare
Sandër Beci	anëtar
Genti Ibrahim	anëtar
Marjana Semini	anëtare
Ilir Toska	anëtar

me sekretare Belma Lleshi, në datën 19.9.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 12 (A) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Aleks Lici, Lefteria Lici

SUBJEKT I INTERESUAR: Telemah Rajdho

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-959, datë 6.6.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 7, 15, 17, 33, 42, 43, 116, 122, 124, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pikat 1, shkronja “I” e 2, 135, 142 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 49, pika 3, shkronja “e”, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Telemah Rajdho, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuarit Aleks Lici dhe Lefteria Lici janë bashkëshortë. Kjo e fundit është motra e subjektit të interesuar, Telemah Rajdho. Sipas kontratës së shitjes nr. 2035 rep., dhe nr. 881 kol., datë 9.10.2000 (*kontrata e shitjes së truallit*), kërkuarit dhe subjekti i interesuar kanë blerë nga këshilli i qarkut Gjirokastrë (seksioni i financës) truallin me sipërfaqe 1380 m², të ndodhur në Gjirokastrë. Më herët, Këshilli i Rregullimit të Territorit pranë këshillit të qarkut Gjirokastrë (*KRRT-ja, Gjirokastrë*), me vendimin nr. 15, datë 13.4.1993, ka miratuar sheshin e ndërtimit për këtë truall dhe, më pas, me vendimin nr. 14, datë 8.4.1998, ka miratuar dhënien e lejes së ndërtimit për objektin “lokal dhe banesë”. Në vijim, me vendimin nr. 1, datë 24.7.2003, KRRT-ja, Gjirokastrë ka miratuar sheshin dhe lejen e ndërtimit për objektin “shtesë anësore lokale e banese në të dyja krahët në pronë të vet”. Pas ndërtimit të objektit dhe shtesave anësore mes kërkuarve dhe subjektit të interesuar kanë lindur mosmarrëveshje për pronësinë e truallit dhe të objektit të ndërtuar mbi të, që posedoheshin nga kërkuarit, të cilët pretendonin se ishin pronarë të vetëm të kësaj pasurie.

2. Në lidhje me këtë mosmarrëveshje, subjekti i interesuar, Telemah Rajdho, ka vënë në lëvizje një proces gjyqësor civil, ku me padinë e paraqitur ka kërkuar detyrimin e kërkuarve për ta njohur bashkëpronar të pasurisë (truall dhe ndërtesë) për 1/2-ën pjesë (*procesi i themelimit të bashkëpronësisë*). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 2209, datë 15.12.2008, ka vendosur pranimin e padisë dhe njohur të drejtën e bashkëpronësisë subjektit të interesuar dhe kërkuarve për një objekt 4-katësh dhe të truallit prej 1380 m² ku ai është ndërtuar, me nga 1/3-ën pjesë secili. Gjykata ka pranuar se në vitin 1993 palët kanë



rënë dakord të ndërtonin një objekt 4-katësh, ku mbi këtë bazë, me kërkesën e tyre është miratuar sheshi i ndërtimit dhe më pas edhe leja e ndërtimit, ku përcaktohet se investitorë janë palët në proces, ndërkohë që në vitin 2000 ata kanë blerë nga shteti edhe truallin me sipërfaqe dhe kufij të përcaktuar. Objekti është ndërtuar me investimin e përbashkët të palëve dhe ai ka përfunduar. Referuar neneve 163 dhe 705 të Kodit Civil (KC), palët janë bërë pronarë të ligjshëm të pasurisë. Ndër të tjera, gjykata ka arsyetuar edhe lidhur me vendimin e ndërmjetëm për rrëzimin e kërkesës së kërkuësve për riçeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe administrimin si prova të një akti ekspertimi grafik, për sa i përket nënshkrimit të subjektit të interesuar në kontratën e shitjes së truallit, si dhe të vendimit për lejen e ndërtimit të shtesës anësore. Sipas gjykatës, këto dokumente nuk plotësonin kriteret për t'u marrë në shqyrtim si prova dhe nuk kishin lidhje me objektin e padisë, ndërkohë që palët i kishin pasur të gjitha mundësitë për të vërtetuar falsitetin e shkresave. Gjykata ka vërejtur se falsiteti i kontratës së shitjes së truallit nuk ishte pretenduar asnjëherë më parë nga kërkuësit, ndërkohë që ekspertimi privat shërbente si dyshim i arsyeshëm, por nuk mund të merrej si provë nga gjykata. Sipas saj, konkluzioni i ekspertit nuk tregonte se dokumenti ishte i falsifikuar, pasi varej nga dokumenti me të cilin ai kishte bërë krahasimin.

3. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë, pas ankimit të tij nga të dyja palët ndërgjyqëse, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vendimin nr. 113, datë 18.3.2009. Sipas asaj gjykatë, nga tërësia e provave të administruara provohet se mes palëve, që janë në marrëdhënie të posaçme, ka ekzistuar qëllimi i përbashkët për krijimin e një sendi në bashkëpronësi me kontributin e tyre të përbashkët, i cili dhe u realizua. Dokumentacioni ligjor për ndërtimin e objektit dhe kontrata e shitjes së truallit rezultonte në emër të të tre ndërgjyqësve, por edhe ndërtimi i shtesës, pavarësisht se ishte vetëm në emër të kërkuësit Aleks Lici, përveç marrëdhënies së posaçme mes palëve, duke qenë një ndërtim në funksion të të parit dhe në truallin në bashkëpronësi të të tre ndërgjyqësve, bazuar në nenet 173 e 175 të KC-së, i përkasin pronarit të truallit, pra të të tre ndërgjyqësve në bashkëpronësi. Ndër të tjera, gjykata e apelit e ka gjetur të pabazuar pretendimin e ngritur në ankimin e kërkuësit për falsitetin dhe pavlefshmërinë e pjeshme të kontratës së shitjes së truallit, për sa i përket

subjektit të interesuar, duke arsyetuar se një gjë e tillë nuk ishte kundërshtuar gjyqësisht sipas rregullave procedurale.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2011-2, datë 14.1.2011, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura nga kërkuësit dhe subjekti i interesuar.

5. Në datën 15.12.2011, bazuar në nenet 494 e vijuese të KPC-së, kërkuësit kanë paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë, me objekt: *“Rishikim i vendimit civil nr. 2209, datë 15.12.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, lënë në fuqi me vendimin nr. 113, datë 18.3.2009, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, vendosur mospranimi i rekursit në dhomën e këshillimit me vendimin nr. 00-2011-2, datë 14.1.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë” (kërkesa fillestare për rishikim)*. Si shkak për rishikimin e vendimit të procesit të themelit të bashkëpronësisë, kërkuësit kanë parashtruar: i. zbulimin e rrethanave të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të diheshin nga pala gjatë shqyrtimit të saj (neni 494, shkronja “a”, i KPC-së), ku për këtë shkak rishikimi ata kanë paraqitur si provë shkresën nr. 2598 prot., datë 30.11.2011 të Bashkisë Gjirokastrë (*shkresa e Bashkisë Gjirokastrë, nëntor 2011*), sipas së cilës “Objekti aktualisht është ndërtuar me tre kate, nga katër kate të miratuara sipas projektit”, çka, sipas kërkuësve, tregonte se vendimi objekt kërkesë për rishikim ishte i gabuar pasi ata janë detyruar të njohin subjektin e interesuar si bashkëpronar për një objekt 4-katësh; ii. vendimi ishte bazuar në dokumente të falsifikuara (neni 494, shkronja “ç”, i KPC-së), ku për këtë shkak rishikimi ata kanë paraqitur si prova dy akte ekspertimi grafik nënshkrimi të datave 16 dhe 18 nëntor 2011 (*akte ekspertimi grafik nënshkrimi, nëntor 2011*), bërë me kërkesën e tyre, akte sipas të cilëve nënshkrimi i subjektit të interesuar Telemah Rajdho në kontratën e shitjes së truallit dhe në dokumentin akt vlerësimi datë 29.9.2000, nuk ishte nënshkrimi origjinal i tij, çka, sipas kërkuësve, ishte një rrethanë e re që kishte rëndësi për çështjen dhe që nuk dihej prej tyre kur ajo ishte gjykuar, ndërsa tregonte se vendimi objekt kërkesë për rishikim ishte i gabuar.

6. Nga ana tjetër, kërkuësi Aleks Lici ka vënë në lëvizje disa procese gjyqësore, përmes të cilëve ka goditur vërtetësinë e dokumenteve të administruara si prova shkresore në procesin e themelit të bashkëpronësisë apo vlefshmërinë e veprimtimit juridik (*kontratës së shitjes së truallit*). Ndër to është dhe procesi



i vënë në lëvizje nga ai në datën 7.1.2012, me të paditur subjektin e interesuar Telemah Rajdho, kërkuesen Lefteria Lici dhe këshillin e qarkut Gjirokastrë, në të cilin ka kërkuar njohjen e pavërtetësisë së pjesshme për shkak falsiteti të kontratës së shitjes së truallit, për pjesën që paraqitet blerës subjekti i interesuar dhe të aktit të vlerësimit të datës 29.9.2000 (*akti i vlerësimit*), pjesë e dokumentacionit shoqërues të kontratës së shitjes së truallit, për pjesën e shkrimit dhe nënshkrimit të subjektit të interesuar, si dhe papërdorshmërinë e atij dokumenti (*procesi i lidhur*).

7. Në përfundim të procesit të lidhur, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 21-2012-1976/978, datë 5.11.2012, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë së kërkuesit, duke shpallur si të falsifikuar kontratën e shitjes së truallit dhe aktin e vlerësimit. Ndërkohë ajo ka rrëzuar kërkimin e padisë për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të kontratës së shitjes së truallit, si kërkim i gjykuar më parë me vendim përfundimtar, midis të njëjtave palë dhe për të njëjtin shkak ligjor. Mbi ankimin e kërkuesit dhe të subjektit të interesuar, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 230, datë 19.4.2013, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë për pjesën e pranuar, duke shpallur pjesërisht të falsifikuar kontratën e shitjes së truallit dhe aktin e vlerësimit, datë 29.9.2000, në rekuizitën “blerësi” për pjesën që pasqyron emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e subjektit të interesuar Telemah Rajdho, si dhe duke urdhëruar mospërdorimin e këtyre dokumenteve për pasojat që rrjedhin nga kjo pjesë e falsifikuar e tyre. Nga ana tjetër, vendimi i gjykatës së shkallës së parë për pjesën e rrëzuar të padisë, është prishur dhe gjykimi i çështjes për këtë pjesë është pushuar. Vendimi i gjykatës së apelit është prishur më pas dhe çështja i është kthyer asaj për rishqyrtim nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2016-2895 (261), datë 9.11.2016.

8. Pas rigjykimit të çështjes në procesin e lidhur, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 20-2017-701/378, datë 15.9.2017, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për të gjitha disponimet e tij, përveç atij për kërkimin e falsitetit të aktit të vlerësimit dhe pasojave të këtij falsiteti, për të cilin ka vendosur rrëzimin e tij. Mbi rekursen e kërkuesve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, ka ndryshuar vendimet e dy gjykatave më të ulëta për

pjesën e pranuar të padisë, duke vendosur rrëzimin e saj. Ndërkohë vendimi i gjykatës së apelit për pjesën e rrëzuar të padisë është lënë në fuqi. Me këtë vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, praktikisht padia e kërkuesit Aleks Lici është rrëzuar në tërësi.

9. Ndërkohë që kërkesa për rishikim ndodhej në pritje për t’u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, në datën 29.4.2013 kërkuesit kanë parashtruar një shtesë kërkesë për rishikim, me të cilën në funksion të shkakut të pretenduar të rishikimit, sipas nenit 494, shkronja “ç”, të KPC-së, ata kanë referuar tashmë se vendimi i procesit të themelit të bashkëpronësisë ishte bazuar në dokumente të falsifikuara, e vërtetuar kjo me vendim civil të formës së prerë, konkretisht me vendimin e gjykatës së apelit të marrë në gjykimin për herë të parë në procesin e lidhur (vendimin nr. 230, datë 19.4.2013, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë), sikurse kërkonte neni 495 i KPC-së (*shtesë kërkesë për rishikim*).

10. Kërkesa për rishikim dhe shtesa e saj është shqyrtuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit dhe me vendimin nr. 00-2022-959, datë 6.6.2022, ka vendosur mospranimin e kërkesës me arsyetimin se ajo nuk është e bazuar në ligj.

11. Në datën 7.7.2022 kërkuesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual (*ankimi i parë kushtetues*), për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (*vendimit në procesin e lidhur*). Me vendimin nr. 28, datë 18.5.2023, Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) e ka shfuqizuar atë vendim, si të papajtueshëm me Kushtetutën, duke e dërguar çështjen për rishqyrtim.

12. Ndërkohë, në datën 9.2.2023, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual (*ankimi i dytë kushtetues*), për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2022-959, datë 6.6.2022 (*vendimit për mospranimin e kërkesës për rishikim*).

13. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 26.4.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 28.4.2023, ka vendosur pezullimin e afatit të shqyrtimit paraprak të ankimit të dytë kushtetues dhe zgjatjen e tij deri në përfundim të shqyrtimit të ankimit të parë kushtetues të kërkuesve për procesin e lidhur, pasi ka vlerësuar se përfundimi më parë i shqyrtimit



paraparak të ankimit të dytë kushtetues do të komplikonte dhe mund të paragjykonte shqyrtimin e ankimit të parë kushtetues të tyre.

14. Pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit të parë kushtetues dhe rënies në këtë mënyrë të shkakut të pezullimit të afatit, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vijuar me shqyrtimin paraparak të ankimit të dytë kushtetues të kërkuësve dhe me vendimin e datës 5.6.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

15. Në datën 6.9.2023 avokatja e subjektit të interesuar ka paraqitur kërkesë për shtyrjen e seancës gjyqësore të datës 19.9.2023 dhe caktimin e një afati të arsyeshëm kohor për përgatitjen dhe paraqitjen e parashtrimeve dhe provave. Pavarësisht kësaj kërkesë, në datën 13.9.2023 avokatja e subjektit të interesuar ka depozituar parashtrimet e saj. Në këto kushte, në datën 14.9.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur të mos e pranojë kërkesën.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

16. **Kërkuësit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

16.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj*, pasi deri në datën 1.4.2022 kërkesa për rishikim dhe procesi i lidhur kanë qenë për shqyrtim përpara të njëjtit trup gjykues në Gjykatën e Lartë, i cili ka dhënë dorëheqjen nga shqyrtimi i kërkesës për rishikim vetëm pas marrjes së vendimit përfundimtar në procesin e lidhur, ndërkohë që duhet të kishte hequr dorë nga shqyrtimi i këtij të fundit. Trupi gjykues i dorëhequr ka lejuar një sërë parregullsish dhe shkeljesh, qoftë në procesin e lidhur, ashtu edhe në shqyrtimin e kërkesës për rishikim. Në të dyja çështjet ndihmësja ligjore ka qenë e njëjta, ndërkohë që ajo duhej të kishte hequr dorë nga kërkesa për rishikim në zbatim të të njëjtave rregulla që KPC-ja parashikon për gjyqtarin. Vendimi për kërkesën për rishikim ka qenë i parapërgatitur nga trupi gjykues që dha dorëheqjen dhe përmbajtja e tij është e njëjtë me atë të relacionit të përgatitur nga ndihmësja ligjore.

16.2. *Së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi kërkuësit nuk janë njoftuar nga Gjykata e Lartë për shqyrtimin e

kërkesës për rishikim në dhomën e këshillimit. Ata nuk janë njoftuar për seancat e datave 7.3.2022 dhe 6.6.2022 dhe as për ndryshimin e trupës gjyqësore si pasojë e dorëheqjes së trupës së mëparshme për t'u dhënë mundësinë të ushtronin, sipas rastit, të drejtën për të kërkuar përjashtimin, ashtu edhe të drejtën për të parashtruar argumente të tjera mbrojtëse ose kërkesa procedurale. Kërkuësit nuk u njoftuan asnjëherë as për ndihmësen ligjore. Kërkesa për rishikim duhej të vijonte të shqyrtohej në seancë gjyqësore me praninë e palëve, përveçse në rastin konkret plotësoheshin kriteret e nenit 482/a të KPC-së për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, pasi nuk ka një praktikë të konsoliduar për sa i përket zbatimit të nenit 497 të këtij kodi lidhur me shqyrtimin e çështjes në themel, si dhe për sa i përket vlerësimit të faktit të një dokumenti të falsifikuar nga një vendim civil dhe jo penal, në kuptim të nenit 495 të KPC-së. Zbatimi i dispozitës kalimtare që i jep të drejtë gjykatës të revokojë vendimet për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve dhe t'i shqyrtojë ato në dhomën e këshillimit, përbën kufizim joproporcional dhe të palejuar nga Kushtetuta të aksesit efektiv në gjykatë. Edhe nëse ky kufizim do të ishte kushtetues, përsëri nuk ka kuptim të zbatohet për çështjet që janë tashmë në gjykim.

16.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar shkaqet për revokimin e vendimit të shqyrtimit të kërkesës në seancë gjyqësore me praninë e palëve, si dhe shkaqet për shqyrtimin e saj në dhomën e këshillimit. Në vendimin përfundimtar për kërkesën për rishikim, ajo gjykatë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuësve, duke ngatërruar faktin juridik me provën shkresore që e vërteton ekzistencën e tij. Gjykata e Lartë nuk ka arritur të kuptojë qartë shkaqet e kërkesës për rishikim dhe ka keqçituar e keqlexuar provat shkresore në raport me faktet e tjera me rëndësi për zgjidhjen e çështjes. Nga vendimet e gjykatës së shkallës së parë, të gjykatës së apelit për herë të parë dhe në rigjykimin e procesit të lidhur, ka rezultuar se vendimi në procesin e themelit të bashkëpronësisë është mbështetur në dokumente të falsifikuara, si kontrata e shitjes së truallit dhe akti i vlerësimit, falsiteti i të cilëve është vërtetuar nga disa akte ekspertimi grafik të urdhëruara nga gjykata.

16.4. *Së drejtës për një gjykim të drejtë dhe publik* në lidhje me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë që



zbaton ligjin dhe Kushtetutën dhe jep vendim të bazuar në prova dhe fakte pas një hetimi të plotë e të gjithanshëm, në respektim të parimit të disponibilitetit dhe së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur në kundërshtim me faktet dhe provat e reja që mbështesin pretendimet e kërkuësve, në veçanti provat që vërtetojnë falsifikimin e kontratës së shitjes së truallit dhe të aktit të vlerësimit, prova këto që tregojnë se përfundimi i gjykatave në procesin e themelimit të bashkëpronësisë është i gabuar, ku e vetmja mënyrë për të rivendosur zbatimin e saktë të ligjit dhe për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor është pranimi i kërkesës për rishikim. Vendimi i Gjykatës së Lartë për revokimin e vendimit të kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore me praninë e palëve ka parregullsi në data. Ajo gjykatë nuk e ka regjistruar audio seancën që ka zhvilluar për çështjen e kërkuësve, në shkellje të udhëzimit nr. 353/2013, përveçse edhe procesverbali me shkrim nuk plotëson kërkesat e nenit 118 të KPC-së.

17. **Subjekti i interesuar, Telemah Rajdho**, ka prapësuar si vijon:

17.1. Pretendimi për *cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi kërkuësit nuk kanë paraqitur asnjë argument ose provë në mbështetje të tij. Anëtarët e trupit gjykues janë emëruar në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin e posaçëm dhe nuk tregohet asnjë fakt që të përbëjë shkak për përjashtimin e gjyqtarit sipas nenit 72 të KPC-së ose që të provojë se ata nuk gëzojnë garancitë e nevojshme për paanshmëri, të kërkuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Këshilltarja ligjore i nënshtrohet rregullave të papajtueshmërisë, kufizimeve në detyrë dhe konfliktit të interesit sipas nenit 34 të ligjit nr. 98/2016 dhe për të nuk jepet asnjë argument ose provë që vërteton për qenien e saj në ndonjë nga këto situata. Këshilltari ligjor është nëpunës gjyqësor pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor dhe nuk është i atashuar pranë një gjyqtari. Pretendimet e kërkuësve për cenimin e parimit të paanshmërisë ose të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj në rastin e procesit të lidhur, nuk mund të jenë pjesë e këtij gjykimi, përveçse ato janë gjetur të pabazuara nga Gjykata me vendimin nr. 28/2023.

17.2. Pretendimi për *cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur* është

i pabazuar, pasi përgjatë 10 vjetëve që procesi i rishikimit ka vazhduar, kërkuësit janë njoftuar rregullisht për ecurinë e tij, kanë marrë pjesë kur shqyrtimi është zhvilluar në prani të palëve, kanë paraqitur pa asnjë kufizim kërkesa dhe pretendime, duke pasur qasje të pakufizuar dhe njohje të plotë të të gjithë veprimtarisë procedurale të kryer nga Gjykata e Lartë. Vetëm fakti se çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit, nuk është i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt, për sa kohë që Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj dhe me rregullat procedurale që gjejnë zbatim gjatë kësaj faze të shqyrtimit të çështjes. Kërkuësit janë njohur me vendimin për revokimin e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve dhe shqyrtimin e saj në dhomën e këshillimit, duke paraqitur mbrojtjen me shkrim në datën 15.11.2021. Ata nuk provojnë se si kjo vendimmarrje e Gjykatës së Lartë ka ndikuar në të drejtat e tyre procedurale, për më tepër kur gjykata e ka shqyrtuar në themel çështjen duke dalë me vendim përfundimtar.

17.3. Pretendimi për *cenimin e standardit të arsytimit të vendimit* është i pabazuar, pasi vendimi i revokimit është i arsyetuar dhe në të tregohen arsyet ligjore për shqyrtimin e kërkesës në seancë gjyqësore mbi bazë të dokumenteve (dhomë këshillimi) referuar ndryshimeve të bëra në KPC. Për sa i përket vendimit përfundimtar të Gjykatës së Lartë, pretendimet e kërkuësve kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, si dhe me vlerësimin e provave prej saj, të cilat nuk janë pjesë e juridiksionit kushtetues. Ajo gjykatë i ka kthyer përgjigje në mënyrë të hollësishme dhe shteruese çdo pretendim të parashtruar në kërkesën për rishikim, shtesën e kësaj kërkesë dhe aktin e mbrojtjes së datës 15.11.2021.

17.4. Pretendimi për *cenimin e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe publik* në lidhje me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë që zbaton ligjin dhe Kushtetutën dhe jep vendim të bazuar në prova dhe fakte pas një hetimi të plotë e të gjithanshëm, në respektim të parimit të disponibilitetit dhe të së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim, është i pabazuar, pasi argumentet në mbështetje të këtij pretendimi lidhen me shqyrtimin dhe vlerësimin e provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk janë të natyrës kushtetuese. Në procesin gjyqësor që kundërshtohet nuk konstatohen shkellje të natyrës kushtetuese si



dhe as që zbatimi i ligjit nga Gjykata e Lartë të ketë qenë arbitrar.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

18. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

19. Gjykata çmon se kërkuësit legjitimohen *ratione personae*, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

20. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, ankuesi duhet të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 56, datë 25.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuësit kanë kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-959, datë 6.6.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për mospranimin e kërkesës për rishikim, duke ngritur pretendime për disa aspekte të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Për këto pretendime ata nuk kanë mjete të tjera ankimi, ndaj Gjykata çmon se plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

22. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata e ka llogaritur afatin 4-mujor duke filluar nga data e shpalljes së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, pra nga organi gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor, nëse kërkuësi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme. Gjithashtu, në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe qëndrimin të saj në çështjen “*Supergrav Albania*” sh.p.k. kundër Shqipërisë (aplikimi nr. 20702/18, datë 9.5.2023), në drejtim të përcaktimit të momentit nga i cili fillon të llogaritet afati ligjor 4-mujor, Gjykata vlerëson se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, ndërsa atëherë kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit.

23. Duke zbatuar këtë qasje në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuësit, i marrë në dhomën e këshillimit (pa praninë e palëve), i është njoftuar elektronikisht avokatit të kërkuësve në datën 12.10.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 9.2.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja



“b”, i ligjit nr. 8577/2000. Për rrjedhojë, kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*.

24. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Gjykata thekson se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur. Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm, por Gjykata mund t’i marrë në konsideratë vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta kushtetuese themelore, duke bërë vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj, Gjykata konstaton se kërkuesit i kanë mbështetur argumentet e tyre në faktet se përgjatë një periudhe kohore kërkesa për rishikim dhe procesi i lidhur kanë qenë për shqyrtim përpara të njëjtit trup gjykues në Gjykatën e Lartë; se trupi gjykues që u dorëhoq nga shqyrtimi i kërkesës për rishikim duhej të dorëhiqej nga shqyrtimi i procesit të lidhur; se trupi gjykues i dorëhequr ka lejuar një sërë parregullsish dhe shkeljesh qoftë në procesin e lidhur, ashtu edhe në shqyrtimin e kërkesës për rishikim; se në të dyja çështjet ndihmësja ligjore ka qenë e njëjta, ndërkohë që ajo duhej të kishte hequr dorë nga kërkesa për rishikim; se vendimi për kërkesën për rishikim ka qenë i parapërgatitur nga trupi gjykues që u dorëhoq dhe përmbajtja e tij është e njëjtë me atë të relacionit të përgatitur nga ndihmësja ligjore.

26. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit, për nga mënyra se si janë parashtruar ato, kanë të bëjnë, në thelb, me parimin e paanshmërisë në gjykim, në kuptim të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e

pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj. Referuar këtyre pretendimeve, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesit nuk kanë arritur të argumentojnë dhe të provojnë në nivel kushtetues pretendimin në lidhje me mungesën e elementeve subjektive dhe objektive, të cilat qëndrojnë në themel të parimit të paanshmërisë së gjykatës, në funksion të krijimit të besimit në dhënien e drejtësisë. Për më tepër, kërkuesit i kanë adresuar pretendimet e tyre në drejtim të gjyqtarëve (trupit gjykues) që ka dhënë dorëheqjen, të cilët nuk kanë qenë pjesë e vendimmarrjes, dhe jo ndaj atyre që kanë shqyrtuar çështjen dhe kanë dhënë vendimin e kundërshtuar për kërkesën për rishikim. Argumenti se vendimi për kërkesën për rishikim ka qenë i parapërgatitur nga trupi gjykues i dorëhequr apo se përmbajtja e tij është e njëjtë me atë të relacionit të përgatitur nga këshilltarja ligjore, nuk ka asnjë bazë faktike dhe ligjore. Gjykata çmon se vetëm fakti se të njëjtët gjyqtarë ishin caktuar fillimisht si anëtarë të trupit gjykues që do të shqyrtonte çështjet e kërkuesit nuk mjafton për konstatimin e cenimit të parimit të paanshmërisë, përderisa nuk ka një vendimmarrje ose vlerësim prej tyre për të dyja këto çështje.

27. Nga ana tjetër, edhe përjekja për të barazuar veprimtarinë këshilluese dhe ndihmëse të këshilltarit ligjor me atë vendimmarrëse të gjyqtarit të çështjes nuk gjen bazë ligjore dhe kërkuesi nuk ka arritur ta ngrejë këtë pretendim në nivel kushtetues, duke mos arritur të provojë se në çfarë mënyre ka ndikuar kjo veprimtari në atë vendimmarrëse të gjykatës, në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Rregullat procedurale që normojnë veprimtarinë e Gjykatës së Lartë kanë përcaktuar në mënyrë të qartë rolin dhe pozicionin, si dhe kompetencat e këshilltarit ligjor gjatë procesit të vendimmarrjes, ndërkohë që nuk përcaktojnë asnjë detyrim të asaj gjykate apo edhe të drejtë të palëve për t’u njohur me të apo për t’iu komunikuar aktet që ai prodhon në ushtrim të kësaj veprimtarie ndihmëse dhe këshilluese.

28. Kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e standardit të arsytimit të vendimit, duke argumentuar, mes të tjerash, se Gjykata e Lartë ka gabuar lidhur me vlerësimin e provave të rishikimit dhe zbatimin e ligjit, ndërsa kërkesa për rishikim nuk duhej refuzuar, pasi nga vendimet e gjykatës së shkallës së parë, të gjykatës së apelit për herë të parë dhe në rigjykimin e procesit të lidhur, ka rezultuar se vendimi në procesin e themelit të bashkëpronësisë



është mbështetur në dokumente të falsifikuara, si kontrata e shitjes së truallit dhe akti i vlerësimit, falsiteti i të cilave është vërtetuar nga disa akte ekspertimi grafik të urdhëruara nga gjykata.

29. Po kështu, sipas kërkesve, është cenuar e drejta për gjykim të drejtë dhe publik, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur në kundërshtim me faktet dhe provat e reja që mbështesin pretendimet e kërkesve, në veçanti provat që vërtetojnë falsifikimin e kontratës së shitjes së truallit dhe të aktit të vlerësimit, të cilat tregonin se përfundimi i gjykatave në procesin e themelit të bashkëpronësisë ishte i gabuar. Ndaj e vetmja mënyrë për të rivendosur zbatimin e saktë të ligjit dhe për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor është pranimi i kërkesës për rishikim. Ata kanë pretenduar, gjithashtu, se vendimi i Gjykatës së Lartë për revokimin e vendimit të kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore me praninë e palëve ka parregullsi në data dhe se Gjykata e Lartë nuk e ka regjistruar audio seancën në dhomë këshillimi, në shkelje të udhëzimit nr. 353/2013, si dhe procesverbali me shkrim nuk plotëson kërkesat e nenit 118 të KPC-së.

30. Gjykata vëren se pretendimet e kërkesve, si më sipër, kanë të bëjnë, në thelb, me çështje të vlerësimit të provave dhe të interpretimit të zbatimit të ligjit, ndërkohë që ata nuk kanë arritur t'i ngrenë ato në nivel kushtetues, pra të provojnë cenimin e ardhur në të drejtat e tyre kushtetuese nga kjo veprimtari. Gjykata rritet se qendrimin e saj të konsoliduar se interpretimi dhe zbatimi i ligjit, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Gjykata ndërhyr kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, kërkesit nuk e plotësojnë kriterin e legjitimitetit *ratione materiae* në lidhje me pretendimet si më sipër.

31. Për sa u përket pretendimeve të kërkesve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe standardit të arsytimit të vendimit, ato janë me natyrë kushtetuese dhe hyjnë në juridiksionin e

Gjykatës, ndaj bazueshmëria e tyre në themel do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur

32. Kërkesit kanë pretenduar se nuk janë njoftuar për shqyrtimin e kërkesës për rishikim në dhomën e këshillimit për seancat e datave 7.3.2022 dhe 6.6.2022 dhe as për ndryshimin e trupës gjyqësore si pasojë e dorëheqjes së trupës së mëparshme, për t'u dhënë mundësinë të ushtronin, sipas rastit, të drejtën për të kërkuar përjashtimin, ashtu edhe të drejtën për të parashtruar argumente të tjera mbrojtëse ose kërkesa procedurale. Kërkesa për rishikim duhet të vijonte të shqyrtohej në seancë gjyqësore me praninë e palëve, përveçse në rastin konkret plotësoheshin kriteret e nenit 482/a të KPC-së për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, pasi nuk ka një praktikë të konsoliduar për sa i përket zbatimit të nenit 497 të këtij kodi lidhur me shqyrtimin e çështjes në themel, si dhe për sa i përket vlerësimit të faktit të një dokumenti të falsifikuar nga një vendim civil dhe jo penal në kuptim të nenit 495 të KPC-së. Zbatimi i dispozitës kalimtare që i jep të drejtë gjykatës të revokojë vendimet për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore përbën kufizim jo proporcional dhe të palejuar nga Kushtetuta të aksesit efektiv në gjykatë. Edhe nëse ky kufizim do të ishte kushtetues, nuk ka kuptim që ai të zbatohet për çështjet tashmë në gjykim.

33. Subjekti i interesuar, Telemah Rajdho, ka prapësuar se përgjatë 10 vjetëve që ka vijuar procesi i rishikimit, kërkesit janë njoftuar rregullisht për ecurinë e tij, kanë marrë pjesë kur shqyrtimi është zhvilluar në prani të palëve, si dhe kanë paraqitur kërkesa dhe pretendime, duke pasur qasje të pakufizuar dhe njohje të plotë të të gjithë veprimtarisë procedurale të kryer nga Gjykata e Lartë. Vetëm fakti i shqyrtimit të kërkesës për rishikim në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, nuk është i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt, për sa kohë që Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj dhe me rregullat e reja procedurale që gjejnë zbatim gjatë kësaj faze të shqyrtimit të çështjes. Kërkesit janë njohur me vendimin për revokimin e vendimit për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve dhe kanë paraqitur mbrojtje me shkrim në datën



15.11.2021, dhe ata nuk provojnë se si kjo vendimmarrje e Gjykatës së Lartë ka ndikuar në të drejtat e tyre procedurale, për më tepër kur gjykata e ka shqyrtuar në themel çështjen, duke dalë me vendim përfundimtar.

34. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuësve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur ngrihen në dy drejtime: së pari, për mosnjohimin nga Gjykata e Lartë për shqyrtimin e kërkesës për rishikim në dhomë këshillimi dhe për përbërjen e trupit gjykues; së dyti, për formën e gjykimit të ndjekur nga Gjykata e Lartë për shqyrtimin e kërkesës për rishikim, pra për shqyrtimin e saj në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh dhe jo në seancë dëgjimore.

35. Në kuptim të nenit 42, pika 1, të Kushtetutës e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Ajo nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Ajo ka theksuar se e drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 29, datë 26.5.2023; nr. 37, datë 30.6.2016; nr. 31, datë 26.5.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt ligjor nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes

procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuësin dhe për interesat që ai përfaqëson. Në çdo çështje të veçantë, duke pasur parasysh edhe të gjithë procedurën që mund të jetë ndjekur, Gjykata vlerëson nëse një kufizim ose shkelje gjatë kësaj procedure ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes dhe ia ka bërë palës të pamundur mbrojtjen dhe zhvillimin e procesit gjyqësor në mënyrë të drejtë. Ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 29, datë 26.5.2023; nr. 71, datë 13.11.2017; nr. 7, datë 28.2.2000, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Lidhur me njoftimin për shqyrtimin e kërkesës për rishikim në Gjykatën e Lartë, Gjykata vëren se në nenin 497, pika 1, që i përket titullit të tretë të pjesës së tretë të KPC-së, që rregullon institutin e rishikimit, pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, parashikohet se gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rishikim gjykon sipas rregullave të zbatueshme për atë shkallë gjykimi. Ndërkohë, në titullin e dytë të kësaj pjesë, KPC-ja rregullon rekursin në Gjykatën e Lartë, ku në nenin 482, pika 3, parashikohet se sekretaria shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit. Njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit.

38. Për sa i përket procedurës së shqyrtimit të çështjes (rekursit) në Gjykatën e Lartë, në pjesën e tretë, titullin e dytë, kreu II, KPC-ja parashikon dy forma gjykimi, atë në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh/seancë mbi dokumente (neni 482) dhe atë në seancë gjyqësore me praninë e palëve/seancë dëgjimore (neni 482/a). Dhoma e këshillimit/seanca mbi dokumente si formë gjykimi nga Gjykata e Lartë është e ndryshme nga dhoma e këshillimit që bën fjalë neni 480 i KPC-së, që rregullon fazën seleksionuese, pra verifikimin e kriterëve të pranueshmërisë për shqyrtim të rekursit, dy forma gjykimi këto të përcaktuara me ndryshimet e bëra KPC-së me ligjin nr. 44/2021.

39. Forma e gjykimit të kërkesës për rishikim nga Gjykata e Lartë, përpara ndryshimeve të KPC-së në vitin 2017, është bërë objekt kontrolli kushtetues



dhe, më tej, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë ndryshuar praktikën gjyqësore përmes vendimit unifikues nr. 1, datë 31.1.2006. Në këtë vendim, ato kanë vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës, neni 6 i KEDNJ-së, precedentët e GJEDNJ-së dhe neni 447 i KPC-së (që rregullon njoftimin e ankimit për palët e tjera) i kanë garantuar kujtdo të drejtën për proces të rregullt gjyqësor, në themel të të cilit qëndron dhënia e mundësive të barabarta secilës palë për ndjekjen dhe mbrojtjen e çështjes në gjykatë, duke i siguruar mundësitë për të parashtruar pretendimet e saj, në kushtet që nuk e vënë në gjendje më pak të favorshme se sa pala kundërshtare. Në raste të tilla standardi minimal që duhet t'i garantohet palës respektive është shansi i barabartë për të qenë në një proces gjyqësor për të cilin gjyqfituesi është akoma nën përfytyrimin e një të drejte të ftuar me vendim të formës së prerë. Mbi këtë bazë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arritur në përfundimet unifikuese se: a) shqyrtimi në dhomë këshillimi i kërkesës për rishikim konsiderohet shqyrtim paraprak i çështjes dhe jo seancë dëgjimore. Në këtë shqyrtim vendoset mospranimi i kërkesës për rishikim nëse nuk përmbushen kriteret ligjore për t'i "hapur rrugën" rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, pa cenuar kështu vendimin që ka zgjidhur përfundimisht çështjen; b) në të kundërt, kur në dhomën e këshillimit konstatohet se faktet e paraqitura nga pala kërkuese mund të jenë shkaqe nga ato që ligji lejon rishikimin e një vendimi të formës së prerë, çështja duhet të kalojë në seancë të hapur gjyqësore për vlerësimin e shkaqeve të rishikimit. Gjykimi në seancë gjyqësore nuk është gjykim themeli, por një seancë dëgjimore ku secila nga palët pjesëmarrëse në gjykim, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, paraqet argumentet e veta.

40. Duke iu kthyer çështjes në gjykim, Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, konstaton se procesi i rishikimit është vënë në lëvizje me kërkesën e kërkuësve të datës 15.12.2011, si pala gjyqhumbe në procesin gjyqësor të themelit. Gjatë kohës kur kërkesa për rishikim ka qenë në pritje për t'u shqyrtuar, kërkuësit kanë parashtruar një shtesë kërkesë për rishikim në datën 29.4.2013. Kërkesa për rishikim dhe shtesa e saj janë marrë në shqyrtim paraprak nga Gjykata e Lartë, kolegji seleksionues i saj, i cili, pasi ka vlerësuar se ajo plotësonte kriteret e pranueshmërisë për shqyrtim, me vendimin e datës

26.2.2014, ka vendosur kalimin për shqyrtim në seancë gjyqësore (*vendimi i kolegjit seleksionues*).

41. Në vijim, Gjykata konstaton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën për rishikim dhe në seancën e datës 17.6.2015, përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, pasi ka konstatuar se në Gjykatën e Lartë ndodhej për shqyrtim edhe procesi i lidhur (pas rigjykimit të çështjes nga Gjykata e Apelit Gjirokastër), ai ka vënë në diskutim kryesisht lidhjen dhe ndërvlerësinë e këtij procesi (procesit të lidhur) me atë të kërkesës për rishikim dhe bazuar në nenin 297, shkronja "a", të KPC-së, ka vendosur pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për rishikim deri në zgjidhjen nga ajo gjykatë të çështjes që i përkiste procesit të lidhur. Pas rënies së shkakut të pezullimit, në datën 25.5.2017 ka rifilluar shqyrtimi i kërkesës, por ai nuk është bërë për arsye objektive (mosformimin e trupit gjykues). Vetëm pas fillimit të funksionimit të Gjykatës së Lartë është bërë i mundur shqyrtimi i kësaj çështjeje. Me vendimin e datës 27.10.2021, trupi gjykues i caktuar për shqyrtimin e saj ka vendosur revokimin e vendimit të kolegjit seleksionues dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh (*vendimi i revokimit*). Me këtë vendim është caktuar edhe data e shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi më 20.12.2021, si dhe është urdhëruar sekretaria gjyqësore për të bërë njoftimin e palëve, duke i ftuar ato për të paraqitur parashtrime me shkrim brenda 15 ditëve nga njoftimi. Ky vendim u është njoftuar rregullisht kërkuësve.

42. Në datën 15.11.2021 avokati i kërkuësve ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për rishikim vendimi deri në përfundim të zgjidhjes nga Gjykata e Lartë të çështjes që i përket procesit të lidhur, duke i bashkëlidhur vendimin nr. 20-2017-701/378, datë 15.9.2017, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe rekursin e paraqitur nga kërkuësit kundër atij vendimi. Po në të njëjtën datë, me një akt të veçantë, ai ka paraqitur para Gjykatës së Lartë edhe mbrojtjen e kërkuësve në lidhje me kërkesën për rishikim. Në aktin e mbrojtjes, avokati i kërkuësve ka parashtruar se në hipotezën e mospranimit të kërkesës për pezullimin e gjykimit, kërkohej revokimi i vendimit të revokimit dhe shqyrtimi i kërkesës për rishikim në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Krahës kësaj, në hipotezën e mospranimit edhe të kësaj kërkesë, avokati i kërkuësve ka parashtruar argumentet për



bazueshmërinë e kërkesës për rishikimin, duke i kërkuar gjykatës që në përfundim të shqyrtimit të vendoste pranimin e saj.

43. Ndërkohë, Gjykata konstaton se trupi gjykues përkatës nuk ka disponuar me vendim për pranimin ose jo të kërkesave të avokatit të kërkuarve. Pavarësisht kësaj, kërkesa për rishikim nuk është shqyrtuar në datën e planifikuar. Gjykata e Lartë, përmes njoftimit të datës 20.12.2021, të publikuar në faqen zyrtare të saj, ka bërë të ditur se çështjet civile të shpallura për shqyrtim në dhomën e këshillimit në atë datë shtyhen dhe do të shqyrtohen në një datë tjetër, ku në listën e çështjeve bashkëlidhur atij njoftimi, është pasqyruar edhe kërkesa për rishikim e kërkuarve. Në dhomën e këshillimit të datës 7.3.2022, anëtarët e trupit gjykues kanë deklaruar heqjen dorë nga shqyrtimi i kërkesës për rishikim, mbi shkakun se kishin dhënë vendim në një çështje tjetër, pikërisht vendimin e datës 7.3.2022 në procesin e lidhur. Dorëheqja e tyre është pranuar me vendimin nr. 102 prot., datë 1.4.2022, të zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë.

44. Kërkesa për rishikim është rindarë me short, përmes të cilit është caktuar relatori i çështjes dhe sipas procesverbalit të datës 4.4.2022, trupi gjykues është plotësuar me 2 anëtarë të tjerë, të cilët, referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezultojnë të jenë përfshirë në përbërjen e 2 trupave gjykues të përhershëm të Kolegjit Civil me vendimin nr. 8, datë 25.3.2022 të Këshillit të kësaj gjykate. Në datën 13.5.2022, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë është publikuar njoftimi i trupit të ri gjykues për shqyrtimin e kërkesës për rishikim të kërkuarve në dhomën e këshillimit të datës 6.6.2022. Në këtë datë kërkesa për rishikim është shqyrtuar në dhomën e këshillimit, ku është verifikuar njoftimi publik i palëve dhe është konstatuar mosparaqitja prej tyre e ndonjë kërkesë procedurale. Në përfundim të shqyrtimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim. Po në datën 6.6.2022, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë është publikuar njoftimi për përfundimin e shqyrtimit të kërkesës për rishikim të kërkuarve në dhomën e këshillimit të asaj date, krahas pjesës urdhëruese të vendimit të marrë.

45. Për sa më sipër, referuar këtyre fakteve me natyrë kushtetuese, Gjykata vëren se kërkuarët janë njoftuar rregullisht për shqyrtimin e kërkesës për rishikim në dhomën e këshillimit, përmes njoftimit

të vendimit të revokimit, fakt që pranohet edhe nga vetë ata. Pas këtij njoftimi ata kanë paraqitur kërkesa procedurale, sikundër kanë parashtruar edhe argumente të tjera mbrojtëse në vijim të atyre të parashtruara në kërkesën për rishikim dhe shtesën e saj. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se shqyrtimi i kërkesës për rishikim jo në datën e planifikuar, për të cilën ata janë njoftuar, por në një datë tjetër të mëvonshme, nuk duket t'u ketë cenuar kërkuarët të drejtën e aksesit në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, për sa kohë atyre u janë garantuar këto të drejta, duke iu mundësuar të paraqesin kërkesa procedurale, sikundër edhe argumente të tjera në funksion të kërkesës së tyre për rishikim. Nga ana tjetër, ata jo vetëm kanë ushtruar të drejtën për të kërkuar rishikimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar, por edhe kanë marrë nga gjykata një zgjidhje përfundimtare për këtë kërkim të tyre. Nga kërkuarët nuk parashtrohet ndonjë argument konkret në këtë drejtim.

46. Megjithatë, Gjykata vëren se shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit nuk është bërë nga ai trup gjykues për të cilin kërkuarët janë njoftuar fillimisht. Një rrethanë e tillë bënte të nevojshëm njoftimin e palëve për shqyrtimin e kërkesës për rishikim në dhomën e këshillimit të datës 6.6.2022 në funksion të bërjes të njohur edhe të përbërjes së trupit gjykues, për sa kohë ata gëzonin të drejtën procedurale për të kërkuar përjashtimin e ndonjë gjyqtari të veçantë ose të të gjithë trupit gjykues. Për këtë seancë në dhomën e këshillimit palët janë njoftuar me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj zyrtare. Megjithatë, avokati i kërkuarve nuk është njoftuar elektronikisht, pavarësisht se ka lënë të dhënat elektronike të kontaktit. Gjithsesi, vetëm kjo mangësi në njoftim nuk duket t'i ketë vendosur kërkuarët në pozita të pafavorshme ose të ketë ndikuar në mohimin e së drejtës së aksesit, në kuptimin substancial të saj, ndaj nuk është e mjaftueshme që ta bëjë të parregullt, në kuptimin kushtetues, procesin gjyqësor të kundërshtuar.

47. Në funksion të pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit, kërkuarët nuk kanë parashtruar ndonjë argument konkret për ekzistencën e ndonjë rrethane ose fakti që u jepte shkas të kërkonin përjashtimin e ndonjë prej anëtarëve të trupit gjykues, ndaj ky pretendim mbetet me natyrë të përgjithshme dhe abstrakte.



48. Për sa i përket pretendimit të kërkuësve se kërkesa për rishikim duhet të shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve me argumentet se kështu gjykata kishte vendosur më herët apo se në rastin konkret plotësoheshin kriteret e nenit 482/a të KPC-së për zhvillimin e gjykimit në këtë formë, Gjykata vëren se argumentet për këtë pretendim kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit procedural nga Gjykata e Lartë, çka është një çështje që i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme dhe jo juridiksionit kushtetues. Ndërkohë, kërkuësit nuk argumentojnë se si kjo mënyrë e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë u ka cenuar atyre të drejtën e aksesit. Gjykata vlerëson të theksojë se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Në kontekst të rrethanave të rastit, Gjykata vlerëson se nuk ka bazë të mjaftueshme për të konsideruar si arbitrar ose haptazi të paarsyeshëm interpretimin dhe zbatimin e ligjit procedural nga Gjykata e Lartë për sa i përket formës së gjykimit të ndjekur ose si të padrejtë gjykimin e zhvilluar prej saj, për më tepër kur për kërkuësit nuk evidentohet ardhja e ndonjë pasoje për të drejtën kushtetuese të pretenduar si të cenuar.

49. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë me të drejtë ka konsideruar se vendimi i saj nr. 79, datë 7.3.2022 përbën vendim gjyqësor të formës së prerë, në kuptim të neneve 494, shkronja “ç” dhe 495 të KPC-së, për qëllimet e procedurës së rishikimit në rastin konkret. Duket se një mënyrë e tillë interpretimi afekton edhe rregullin në nenin 496 të KPC-së, sipas të cilit në rastet e parashikuara nga neni 495, afati i paraqitjes së kërkesës për rishikim fillon ditën që vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në çështjen konkrete, kërkuësit kanë paraqitur kërkesën për rishikim (shitesën), duke konsideruar si vendim të formës së prerë atë të gjykatës së apelit për herë të parë në procesin e lidhur (vendimin nr. 230, datë 19.4.2013, të Gjykatës së Apelit Gjjirokastrë), kërkesë e cila mbeti e pashqyrtuar nga Gjykata e Lartë për disa vjet, derisa kjo e fundit u

shpreh në atë proces me vendimin përfundimtar nr. 79, datë 7.3.2022. Në këtë situatë dhe në këndvështrim të së drejtës kushtetuese për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, edhe pse në gjykimin kushtetues nuk janë ngritur pretendime në këtë drejtim, Gjykata evidenton se Gjykatës së Lartë, në ushtrim të kompetencës si gjykatë e ligjit, i përket detyra për të vlerësuar nëse ka vend për njësimin e praktikës gjyqësore lidhur me konceptin “vendim i formës së prerë” në dispozitat ligjore që rregullojnë institutin e rishikimit.

50. Në përmbledhje të të gjitha argumenteve të mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuësve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, për shkak të mosnjohimit të seancës në dhomën e këshillimit, është i pabazuar. Kërkuësit nuk rezultojnë të jenë vendosur në pozita të pafavorshme lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive ose me gjykimin e çështjes në tërësi, por ata e kanë ushtruar efektivisht të drejtën për të kërkuar rishikimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar, duke marrë nga gjykata një zgjidhje përfundimtare për këtë kërkim të tyre.

51. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në tërësi argumentet e kërkuësve për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, janë të pabazuara, ndaj i tillë gjendet edhe ky pretendim.

B.2. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit

52. Kërkuësit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar shkaqet për revokimin e vendimit të shqyrtimit të kërkesës në seancë gjyqësore me praninë e palëve, si dhe shkaqet për shqyrtimin e saj në dhomën e këshillimit dhe se në vendimin përfundimtar për kërkesën për rishikim kjo gjykatë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tyre.

53. Subjekti i interesuar, Telemah Rajdho, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është i pabazuar, pasi vendimi i revokimit është i arsyetuar dhe në të tregohen arsyet ligjore për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore pa praninë e palëve, mbi bazë dokumentesh, referuar ndryshimeve të bëra së fundi në KPC. Kurse për sa i përket vendimit përfundimtar të Gjykatës së Lartë për kërkesën për rishikim, kërkuësit nuk parashtrojnë asnjë pretendim ose shpjegim ku të argumentohet mungesa nga ana ligjore e arsyetimit të vendimit në drejtim të mosdhënies përgjigje nga gjykata për të gjitha pretendimet e paraqitura nga ata. Ajo gjykatë i ka



kthyer përgjigje në mënyrë të hollësishme dhe shteruese çdo pretendimi të parashtruar në kërkesën për rishikim, shtesën e kësaj kërkesë dhe aktin e mbrojtjes të datës 15.11.2021.

54. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili përkon edhe me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142/1 të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 18, datë 15.3.2016; nr. 8, datë 16.3.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Me arsyetimin, gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit, çka mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

56. Gjykata vlerëson të theksojë, fillimisht, se ajo i shqyrton pretendimet për vendimin e revokimit të vendimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore në këndvështrim të pretendimeve për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë në tërësinë

e tij, duke vlerësuar nëse ai ka qenë i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt.

57. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 27.10.2021, ka vendosur revokimin e vendimit të kolegjit seleksionues për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe ka kthyer çështjen për shqyrtim në dhomën e këshillimit, mbi bazë dokumentesh. Kolegji Civil ka arsyetuar se pas ndryshimeve të legjislacionit procedural civil, të cilat kanë hyrë në fuqi në vitin 2021, neni 482, pika 1, i KPC-së ka përcaktuar se shqyrtimi i çështjeve në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet në dhomën e këshillimit, mbi bazë dokumentesh, përveç rasteve të parashikuara në nenin 482/a të KPC-së. Po kështu, dispozitat tranzitore sipas ligjeve nr. 44/2021, nr. 49/2021 dhe nr. 41/2021 detyrojnë Gjykatën e Lartë të zbatojë rregullat e reja të gjykimit dhe, në veçanti, ato që kanë të bëjnë me ritin e gjykimit të çështjeve në dhomën e këshillimit dhe me formimin e trupit gjykues. Në këto kushte, për çështjet për të cilat më parë është vendosur kalimi për shqyrtim në seancë gjyqësore, do të vlerësohet nëse shkaku i një vendimmarrjeje të tillë ka qenë nevoja për dëgjimin e palëve apo ato mund të shqyrtohen mbi bazë dokumentesh. Në rastin konkret, çështja është e tillë që mund të shqyrtohet në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, mbi bazën e akteve, duke iu dhënë mundësia atyre të realizojnë mbrojtjen e interesave të veta, në respektim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, përmes paraqitjes së parashkrimeve me shkrim. Trupi i ri gjykues, i formuar pas dorëheqjes të trupit të mëparshëm, ka vlerësuar se kërkesa për rishikim duhet të vijonte të shqyrtohej në dhomën e këshillimit, duke bërë njoftimin përkatës.

58. Lidhur me vendimin përfundimtar për kërkesën për rishikim, Gjykata vëren se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka përshkruar pretendimet e kërkuarve të parashtruara në kërkesën fillestare dhe në atë shtesë, sikundër edhe provat e paraqitura nga ata. Po kështu, ai ka përshkruar faktet në lidhje me procesin e themelit të bashkëpronësisë dhe atë të procesit të lidhur dhe, më tej, ka përshkruar edhe vlerësimin e tij lidhur me bazueshmërinë në themel të kërkesës për rishikim për secilin nga shkaqet e ngritura nga kërkuarët, duke arritur në përfundimin se ajo nuk është e bazuar në ligj.



59. Lidhur me kërkesën fillestare për rishikimin e vendimit (datë 15.12.2011), për sa i përket shkakut të parë të pretenduar të rishikimit, Kolegji Civil ka arsyetuar se dokumentacioni i paraqitur nga kërkuessit, shkresa e Bashkisë Gjrokastër, nëntor 2011 dhe aktet e ekspertimit grafik, nënshkrimi nëntor 2011, ka vlerën e provës shkresore, në kuptim të nenit 494, shkronja “a”, të KPC-së, por se në këtë rast nuk plotësohen të gjitha kriteret ligjore që kjo dispozitë kërkon për rrethanat apo provat e reja me shkresë. Sipas tij, provat me shkresë të paraqitura tregonin për fakte dhe rrethana të njohura dhe të bëra të ditura gjykatës gjatë gjykimit të çështjes në themel, përveç se këto prova kërkuessit kanë pasur mundësi t’i siguronin gjatë gjykimit të çështjes dhe se ato nuk kanë rëndësi për zgjidhjen e saj (*shih paragrafët 24–27 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

60. Kurse lidhur me shtesën e kërkesës për rishikim (datë 29.4.2013), për sa i përket shkakut të dytë të pretenduar të rishikimit, Kolegji Civil ka arsyetuar se nuk qëndron pretendimi se vendimi objekt kërkesë për rishikim është bazuar në dokumente të falsifikuara, konkretisht në kontratën e shitjes së truallit dhe në aktvlerësimin, falsitet ky i vërtetuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, vendimin nr. 230, datë 19.4.2013, të Gjykatës së Apelit Gjrokastër. Sipas tij, ky i fundit rezulton të jetë prishur dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 79, datë 7.3.2022, ka vendosur rrëzimin e padisë, duke mos u provuar kështu pretendimi për falsitet të dokumenteve të vërtetuar me një vendim gjyqësor sipas nenit 495 të KPC-së (*shih paragrafin 28 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

61. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson të theksojë se vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë plotëson kriteret e vendosura më sipër nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit. Ai përmban të dhënat e palëve, objektin e kërkesës dhe shkaqet e saj, provat e paraqitura në funksion të vërtetimit të shkaqeve të rishikimit dhe faktet e rëndësishme për zgjidhjen e çështjes, si dhe analizën e tyre në raport me ligjin e zbatueshëm, që mbështet qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Vendimi nuk rezulton të jetë alogjik, kontradiktor ose i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e bërë. Për rrjedhojë, vendimi i kundërshtuar i përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tij.

62. Për sa më lart, në analizë të argumenteve të kërkuessve për pretendimin për cenimin e standardit

të arsyetimit të vendimit, Gjykata çmon se ai është i pabazuar.

63. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuessve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, për rrjedhojë kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 e 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 19.9.2023.

Shpallur më 19.10.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuessve Aleks Lici dhe Lefteria Lici, me objekt: “*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-959, datë 6.6.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjyqësor*”, unë, gjyqtarja Marsida Xhaferllari bashkohem me shumicën për rrëzimin e kërkesës, por për shkak të ndryshëm që lidhet me mungesën e juridiksionit të Gjykatës për shqyrtimin e rastit konkret, arsye për të cilën edhe kam votuar në Mbledhjen e Gjyqtarëve kundër kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

2. Nga rrethanat e çështjes, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se kërkuessit kanë



kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë që ka rrëzuar kërkesën e tyre për rishikimin e vendimeve gjyqësore përfundimtare të datave 15.12.2008, 18.3.2009 dhe 14.1.2011 të dhëna përkatësisht nga gjykata e shkallës së parë Gjykata e Apelit Gjirokastër dhe Gjykata e Lartë, me objekt njohjen e së drejtës së bashkëpronësisë mbi një pasuri të paluajtshme (truall dhe ndërtesë) në Gjirokastër. Ata kanë paraqitur si shkak për rishikim ekzistencën e provave të reja, që lidheshin me numrin e kateve të ndërtesës, si dhe falsitetin e kontratës së shitjes së truallit dhe aktit të vlerësimit. Çështja e falsitetit të akteve ka qenë objekt shqyrtimi gjyqësor, në gjykatat e të tria shkallëve, përfshirë edhe Gjykatën dhe aktualisht është për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

3. Mbi këto rrethana faktesh, kërkuessit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj, së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, standardit të arsytimit të vendimit dhe së drejtës për një gjykim të drejtë dhe publik, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës.

4. Neni 131, pika 1, shkronja "P", i Kushtetutës, i kombinuar me nenin 42 të saj, i jep drejtën individit të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues me ankesë kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtën kushtetuese individuale të procesit të rregullt ligjor. Megjithatë, kjo e fundit, shprehimisht, sipas nenit 42 të Kushtetutës, duhet që nga pikëpamja materiale të jetë gjykim për: i. mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues ose ligjorë të individit; ii. ose për akuzat e ngritura kundër individit. Kjo do të thotë se individ i gëzon mbrojtje kushtetuese për procesin gjyqësor kur ai, cilado qoftë natyra e tij (civile, penale ose administrative), zhvillohet për të vendosur materialisht për një të drejtë/liri/interes kushtetues ose të drejtë/liri/interes ligjor. Në këto raste, në zbatim të nenit 15 të Kushtetutës (sipas të cilit të drejtat themelore qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik dhe organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet t'i respektojnë ato dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre), gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në ushtrimin e pushtetit të tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve konkrete mbi të drejtat dhe interesat e ligjshëm të individëve, kanë detyrimin të respektojnë të drejtën kushtetuese për proces të rregullt ligjor dhe të kontribuojnë në realizimin e saj dhe, në rast se ato dështojnë, atëherë është detyrë e

Gjykatës, bazuar në parimin e subsidiaritetit, të gjykojë përfundimisht ankesën e individit për cenimin eventual të së drejtës kushtetuese të procesit të rregullt ligjor.

5. Në këtë pikëpamje, gëzimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor kushtëzohet nga identifikimi paraprak nëse individ i ka materialisht një të drejtë, liri, interes kushtetues ose ligjor në hapjen e procesit gjyqësor ose jo. Ky element merr rëndësi në rrafshin kushtetues, sepse përcakton, ndër të tjera, juridiksionin material të Gjykatës, që ka të bëjë me legjitimitimin *ratione materiae* të kërkuessit në rastin e ankimit kushtetues individual.

6. Që një kërkuess të legjitimohet *ratione materiae* për të vënë në lëvizje kontrollin kushtetues, duhet që e drejta e pretenduar të parashikohet dhe të mbrohet shprehimisht nga Kushtetuta, sepse çdo çështje që lidhet me juridiksionin e Gjykatës përcaktohet nga vetë Kushtetuta. Pra, si përfundim, në radhë të parë, përmbajtja e nenit 42 të Kushtetutës i përgjigjet interesit thelbësor, për të cilin zhvillohet procesi gjyqësor, në kuptimin që ai nuk ngrihet vetvetiu, por është një mjet në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të kushtetues ose të ligjshëm, në radhë të dytë, ky nen nuk mund dhe nuk duhet të marrë në mbrojtje proceset gjyqësore ku abuzohet me të drejtën.

7. Ky përfundim përputhet edhe me konceptin e gjykimit përfundimtar të ankesave të individëve që zhvillon Gjykata sipas nenit 131, pika 1, shkronja "P", të Kushtetutës. Kështu, mund të ndodhë që individ, krahas procesit kryesor për mbrojtjen e së drejtës/interesit të ligjshëm dhe në funksion të tij, mund t'i drejtohet gjykatës së zakonshme disa herë me kërkesa të veçanta procedurale, të cilat vënë në lëvizje procese të ndryshme gjyqësore, që formalisht janë të kontrollueshme me ankim deri në Gjykatën e Lartë. Në këto raste, Gjykata nuk ka pranuar ankimet, me arsyetimin se në këto raste vendimet gjyqësore nuk kanë natyrë përfundimtare në drejtim të përcaktimit të së drejtës/interesit të individit, duke e orientuar ankuesin të paraqesë ankim kur procesi kryesor, që vendos mbi të drejtën thelbësore të individit, të bëhet përfundimtar (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 29, datë 30.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Duke i zbatuar këta parametra kushtetues në procesin gjyqësor ku shqyrtohet kërkesa për rishikimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar, është e qartë se, në parim, ky lloj procesi gjyqësor,



kur përfundon me vendim mospranimi ose rrëzimi, në thelb, nuk përcakton të drejtën ose interesin e ligjshëm të individit, siç kërkohet nga neni 42 i Kushtetutës, pasi kjo e drejtë/interesi është vlerësuar përfundimisht nga vendimi gjyqësor që kërkohet të rishikohet. Siç ka pohuar edhe jurisprudenca kushtetuese, kërkesa për rishikim, përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse (*shih vendimet nr. 5, datë 1.3.2018; nr. 36, datë 26.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Me fjalë të tjera, pavarësisht pretendimeve që qëndrojnë në themel të saj, në thelb, nuk vihet në diskutim ekzistenca e së drejtës, pasi kjo e fundit ka qenë njëherë objekt i një procesi gjyqësor, në të cilin gjykata e juridiksionit të zakonshëm janë shprehur me vendim përfundimtar.

9. Kjo nuk përjashton mundësinë që, në raste të veçanta, për shkak të rrethanave konkrete, individit arrin të identifikojë dhe provojë se mohimi i kërkesës për rishikim i ka cenuar atij drejtpërdrejt dhe në mënyrë reale një të drejtë kushtetuese dhe në këtë mënyrë pretendimi i tij të përbëjë lëndë për shqyrtim brenda juridiksionit të Gjykatës. Po kështu, tërësisht e kundërt paraqitet situata kur objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi gjyqësor që ka pranuar kërkesën për rishikim. Në këto raste, e drejta kushtetuese ose ligjore e humbet cilësinë “*e përcaktuar përfundimisht në rrugë gjyqësore*”, për shkak se procesi gjyqësor i zakonshëm për të drejtën rifillon sërish dhe krijohet premisa për cenimin e parimit të sigurisë juridike, ndaj Gjykata ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e pretendimeve të tilla.

10. Duke iu kthyer çështjes konkrete, nën dritën e analizës së mësipërme, vlerësoj se procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë, në përfundim të të cilit është dhënë vendimi për rrëzimin e kërkesës për rishikim, nuk ka në objektin e tij, nga pikëpamja materiale, ndonjë të drejtë kushtetuese themelore, sikurse e drejta e pronës, e cila, në thelb, ka qenë objekt

mosmarrëveshjeje që i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe është zgjidhur me vendimin përfundimtar të Gjykatës së Lartë nr. 00-2011-2, datë 14.1.2011. Për më tepër, kërkesit nuk kanë identifikuar dhe provuar ekzistencën e ndonjë rrethane të veçantë, e cila, për shkak të mohimit të kërkesës për rishikim, u ka cenuar atyre drejtpërdrejt dhe në mënyrë reale një të drejtë kushtetuese substanciale, gjë e cila do të passillte nevojën për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues. Për këtë arsye, procesi gjyqësor që ka vendosur rrëzimin e kërkesës për rishikim nuk gëzon mbrojtje nga neni 42 i Kushtetutës.

11. Në përfundim, vlerësoj se ankimi kushtetues individual duhej rrëzuar për shkak të mungesës së juridiksionit të Gjykatës.

Anëtare: Marsida Xhaferllari

VENDIM Nr. 43, datë 19.9.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Genti Ibrahim	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 19.9.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 26 (Sh) 2022, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Ndrekaj” sh.p.k.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Autoriteti Rrugor Shqiptar, Avokatura e Shtetit, Bashkimi i Shoqërive “Ing. Claudio Salini Grandi Lavori S.P.A.” & “Salvatore Matarrese S.P.A.”

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1201 (246), datë 16.6.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.



BAZA LIGJORE: Nenet 4, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 1, Protokolli nr. 1 dhe neni 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësës, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, bashkimi i shoqërive “Ing. Claudio Salini Grandi Lavori S.p.A” & “Salvatore Matarrese S.p.A.”, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja, shoqëria “Ndrekaj” sh.p.k., është person juridik dhe ka si objekt të aktivitetit tregtar: *“Ndërtim dhe meremetim objekteve. Prerje, transport, shfrytëzim, shitje me shumicë dhe pakicë të lëndëve drusore. ... Ndërtim i linjave elektrike të tensionit të lartë 110 kV, 220 kV dhe 400 kV... etj.”*

2. Më datë 22.11.2012 midis kërkuësës dhe bashkimit të shoqërive “Ing. Claudio Salini Grandi Lavori S.p.A” & “Salvatore Matarrese S.p.A” është nënshkruar kontrata e nënkontraktimit nr. 2621 rep., nr. 1483/1 kol., me objekt realizimin e punimeve dhe shërbimeve për spostimin e linjave elektrike 110 kv për nënstacionet Shkodra 1 dhe Shkodra 2. Më datë 27.4.2013 midis po këtyre palëve është lidhur një shtojcë kontrate nr. 1 për kryerjen e punimeve të mëtejshme. Kontrata e nënkontraktimit bazohej në kontratën e datës 17.6.2009 midis ARRSH-së (autoriteti kontraktor) dhe bashkimit të shoqërive “Ing. Claudio Salini Grandi Lavori S.p.A” & “Salvatore Matarrese S.p.A” (kontraktori), për projektimin ekzekutues dhe përfundimin e rrugës Shkodër-Hani i Hotit. Përfundimi i punimeve i është dorëzuar kontraktorit

(bashkimi i shoqërive italiane) nga kërkuësja sipas akteve të marrjes në dorëzim të datave 25.5.2013 dhe 27.6.2013.

3. Me pretendimin se kontraktori nuk kishte përmbushur detyrimet financiare sipas nënkontratës bazuar në faturat nr. 45, datë 31.1.2013, nr. 18, datë 28.5.2013 dhe nr. 29, datë 28.6.2013, kërkuësja, më datë 15.12.2015, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes të rrjedhur nga marrëdhënia juridike civile (nënkontrata) me të paditur autoritetin kontraktor dhe person të tretë kontraktorin, me objekt përmbushjen e detyrimit kontraktor dhe detyrimin e palës së paditur t’i kthejë shumën prej 244,182 eurosh, si dhe interesat.

4. Me vendimin nr. 369, datë 26.1.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur konstatimin e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me arsyetimin se në kushtet kur palë e paditur në gjykim është një organ administrativ, kompetenca për shqyrtimin e mosmarrëveshjes objekt gjykimi i përket gjykatës administrative.

5. Me vendimin nr. 2990 (80-2016-2980), datë 13.6.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e palës së paditur, (ARRSH-së), që t’i shlyejë paditëses (kërkuësës) detyrimin kontraktor që rrjedh nga kontrata nr. 2621 rep., nr. 1483/1 kol., datë 22.11.2012, në vlerën 244,182 euro, si dhe kamatëvonesat në shumën 10,874 euro. Në vlerësimin e gjykatës, nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se pala e paditur nuk ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kontrata duke qenë vetë ajo që ka miratuar kërkuësen si nënkontraktore të ligjshme për realizimin e punimeve të paparashikuara. Sipas saj, ky detyrim, përveçse në kontratë, rrjedh edhe nga neni 875 i Kodit Civil (KC), që parashikon se personat të cilët, duke qenë në varësi të sipërmarrësit, kanë ushtruar veprimtarinë e tyre për zbatimin e veprës ose kryerjen e shërbimit, mund të ngrenë padi drejtpërdrejt kundër porositësit për të marrë atë çka u takon deri në plotësimin e detyrës që porositësi ka ndaj sipërmarrësit në kohën kur ata ngrenë padinë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit ARRSH-ja dhe Avokatura e Shtetit.

6. Me vendimin nr. 5136 (86-2017-5460), datë 7.12.2017, Gjykata Administrative e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke



arsyetuar se detyrimi ka lindur nga kontrata e lidhur midis kërkuases dhe kontraktorit për realizimin e punimeve të spostimit të linjës kablllore, të cilat ishin të paparashikuara. Ky detyrim buron nga përmbajtja e kontratës dhe parashikimet e nenit 875 të KC-së. Po kështu, përfundimi i punimeve nga kërkuësja është pasqyruar në aktet e marrjes në dorëzim të datave 25.5.2013 dhe 27.6.2013 dhe ato janë kryer në përputhje me kushtet teknike të kontratës dhe kërkesat e OST sh.a. dhe OSHEE sh.a., të cilat janë pronaret e linjave të spostuara. Sipas gjykatës, ARRSH-ja nuk ka arritur të provojë, gjithashtu, që këtë shumë t'ia ketë shlyer kërkuases ose kontraktorit, ndonëse ka pranuar punimet dhe dorëzimin e projektit. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs Avokatura e Shtetit më datë 9.1.2018 dhe ARRSH-ja më datë 10.1.2018. Me kërkesën e datës 1.2.2018, ARRSH-ja ka kërkuar nga Gjykata e Lartë edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

7. Me vendimin nr. 107, datë 15.2.2018, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur pezullimin e vendimit nr. 5136 (86-2017-5460), datë 7.12.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit.

8. Me kërkesën nr. 1712 prot., datë 27.4.2018, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës së Lartë për revokimin e vendimit të pezullimit, për të cilën Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 107/1, datë 5.6.2018, ka vendosur mospranimin.

9. Me shkresën nr. 3586/4 prot., datë 16.6.2020, ARRSH-ja i ka kthyer përgjigje kërkuases se garancia e punimeve për objektin “Projekti ekzekutiv dhe ndërtimi i rrugës Shkodër – Hani i Hotit” është likuiduar. Në këto kushte, më datë 29.6.2020 kërkuësja i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë me kërkesë për revokimin e vendimit nr. 107, datë 15.2.2018 të Kolegjit Administrativ të kësaj gjykate. Më datë 14.9.2020, Gjykata e Lartë ka publikuar në faqen e saj zyrtare, në rubrikën “Përgjigje e kërkesës”, njoftimin se ajo “Do të shqyrtohet bashkë me dosjen e themelit”. Më datë 29.9.2020 kërkuësja ka paraqitur një kërkesë tjetër, drejtuar anëtarëve të trupit gjykues të Kolegjit Administrativ, duke kërkuar që ky koleg të shprehej me vendim pranimi ose mospranimi për kërkesën e saj të datës 29.6.2020.

10. Në lidhje me rekursin, me vendimin nr. 00-2022-1201 (246), datë 16.6.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të

ndryshojë vendimin nr. 5136 (86-2017-5460), datë 7.12.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. 2990 (80-2016-2980), datë 13.6.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke rrëzuar kërkesëpadinë. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat më të ulëta nuk kanë vlerësuar drejt natyrën e marrëdhënies juridike, duke e zgjidhur në mënyrë të gabuar çështjen, si pasojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit. Sipas saj, konflikti ndërmjet palëve ka të bëjë me fushën e së drejtës administrative dhe në respektim të parimit *lex specialis*, në rastin në shqyrtim, zbatohen dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me prokurimin publik, sipas të cilit kontraktori është përgjegjësi kryesor për zbatimin e kontratës, pavarësisht nënkontraktimit. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se në kushtet kur pala e paditur nuk është palë kontraktore në kontratën e nënkontraktimit, ajo nuk mund të ngarkohet me asnjë lloj detyrimi as nga pala paditëse, as nga gjykata, duke mos pasur legjitimitet pasiv substancial në këtë çështje.

11. Më datë 9.12.2022 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimit nr. 00-2022-1201 (246), datë 16.6.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

12. Me vendimin nr. 4, datë 20.1.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtarë të saj për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje.

13. Më datë 7.3.2023 Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila më datë 16.3.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

14. Në parashtrimet e datës 18.4.2023 kërkuësja ka kërkuar marrjen në shqyrtim nga Gjykata edhe të vendimit nr. 107, datë 15.2.2018 të Gjykatës së Lartë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit në kontekstin e vendimit objekt kundërshtimi, duke pretenduar se ai ka sjellë cenimin, me pasoja të rënda, të së drejtës së pronës së saj.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se procesi gjyqësor i zhvilluar nga



Gjykata e Lartë i ka cenuar këto të drejta kushtetuese:

15.1 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, sipas nenit 42 të Kushtetutës, në drejtim të:

15.1.1 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë, në mënyrë të gabuar, ka argumentuar se mosmarrëveshja duhej të zgjidhej bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar (*ligji nr. 9643/2006*), i cili nuk lejon mekanizmin e pagesave të drejtpërdrejta nga autoriteti kontraktor tek nënkontraktori, pasi bëhet fjalë për fonde publike, pa marrë parasysh marrëveshjen e lidhur midis qeverisë italiane dhe asaj shqiptare, sipas së cilës, në dhënien e kontratave, detyrimisht duhet të zbatohen normat e prokurimit sipas Manualit të Procedurave të Komisionit Evropian në pjesën që trajton kontratat e shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve, të cilat bazohen në modelin e kontratave FIDIC. Ajo gjykatë nuk i ka kthyer përgjigje pretendimit të kërkuësës se ligji i zbatueshëm është ai i Bashkimit Evropian dhe jo ligji shqiptar për prokurimin publik. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk u ka kthyer përgjigje as pretendimeve të ngritura në kërkesat e datave 16.6.2020, 29.6.2020 dhe 29.9.2020 për revokimin e vendimit të pezullimit, duke mos u shprehur me vendim për thelbin e tyre. Në atë pjesë të vendimit ku pasqyrohen rrethanat e çështjes nuk janë pasqyruar kërkesat e paraqitura nga kërkuësja të datave 27.4.2018, 29.6.2020 dhe 29.9.2020, dhe as vendimi nr. 107/1, datë 5.6.2018 i asaj gjykate që e rrëzonte këtë kërkesë.

15.1.2 *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar*, pasi kërkuësja ishte në pamundësi për t’iu përgjigjur me shkrim relacionit të këshilltarit ligjor të caktuar për çështjen përpara se Gjykata e Lartë të jepte vendimin, i cili ka ndikuar në vendimmarrjen e asaj gjykate. Po kështu, kërkuësja ka qenë në pamundësi për t’iu përgjigjur me shkrim çështjeve të ligjit të ngritura kryesisht nga Gjykata e Lartë, në lidhje me faktin se për shkak se bëhet fjalë për fonde publike, ligji nr. 9643/2006 nuk lejon mekanizmin e pagesave të drejtpërdrejta nga autoriteti tek nënkontraktori.

15.1.3 *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në themel, ka rivlerësuar provat e marra nga gjykatat më të ulëta, duke mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ato, duke tejkaluar kufijtë e shqyrtimit të saj. Ajo ka

arsyetuar se nuk është zhvilluar procedurë përzgjedhëse prokurimi në lidhje me kërkuësen si nënkontraktore; se marrëdhënia e detyrimit ndërmjet kërkuësës dhe ARRSH-së nuk buron nga kontrata publike e datës 17.6.2009, por vetëm nga nënkontrata e datës 22.11.2012; shoqëritë OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. nuk mund të merrnin në dorëzim punimet, pasi ato duhet të merreshin nga ARRSH-ja. Ajo ka vlerësuar kryesisht origjinën e fondeve që kanë financuar kontratën publike të datës 17.6.2009 dhe nënkontratën e datës 22.11.2012, si dhe natyrën publike ose private të këtyre fondeve. Nga ana tjetër, zëvendësimi i anëtarëve të trupit gjykues në Gjykatën e Lartë nuk është bërë në bazë të shortit elektronik, pasi në dosjen gjyqësore rezultoi një formular në të cilin anëtarë të kolegjit që do të shqyrtonin çështjen e kërkuësës ishin gjyqtarët I.P., E.P. dhe S.S. (relator), ndërkohë që vendimi është marrë nga gjyqtarët S.S., G.M. dhe A.V. (relator).

15.2 *Të drejtën e pronës private*, sipas nenit 41 të Kushtetutës, pasi shuma prej 244,182 eurosh, detyrim kontraktor, përbën “pasuri” në kuptim të kësaj dispozite dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Mosdhënia përgjigje dhe arsyetimi i Gjykatës së Lartë për pretendimet e kërkuësës në lidhje me zbatimin e së drejtës të kontratave publike të Bashkimit Evropian ka ndikuar në gëzimin e qetë të pronës së kërkuësës.

15.3 *Parimin e epërsisë së marrëveshjeve ndërkombëtare dhe zbatimit të drejtpërdrejtë të tyre*, sipas nenit 122, pikat 1, 2 dhe 3, të Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë ka shpërfillur nenin 7 të shtojcave 2 dhe 3 të marrëveshjes së lidhur midis qeverisë italiane dhe asaj shqiptare. Ajo kishte detyrimin ta zgjidhte çështjen dhe ta interpretonte ligjin në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) që u jep operatorëve ekonomikë të njëjtin nivel mbrojtjeje dhe sigurie si traktatet dhe direktivat evropiane për kontratat publike.

16. **Subjekti i interesuar, ARRSH-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

16.1 Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë nuk mund të merrte për bazë marrëveshjen e lidhur midis qeverisë italiane dhe asaj shqiptare, e cila parashikonte pjesëmarrjen në tender vetëm të shoqërive italiane, pra nuk mund të zbatohet për kërkuësen. ARRSH-ja nuk ka asnjë detyrim kontraktor, pasi ajo ka dhënë vetëm të drejtën e



nënkontraktimit, gjë e cila është parashikuar shprehimisht në kontratë, si dhe ka miratuar paraprakisht subjektin e përzgjedhur nga kontraktori. ARRSH-ja, si autoritet kontraktor, i ka përmbushur të gjitha detyrimet kundrejt kontraktorit. Vendimi i Gjykatës së Lartë është shprehur për të gjitha pretendimet e palëve dhe ka treguar me qartësi të gjitha faktet dhe ligjin e zbatueshëm. Po kështu, kërkesja ka marrë dijeni dhe është njohur me shkaqet e rekursit, si dhe i është dhënë mundësia të paraqesë parashtrimet e saj në atë gjykatë.

16.2 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit të lidhur me drejtën për t'u dëgjuar*. Pozicioni i këshilltarit ligjor është i përcaktuar qartë në ligj dhe ai nuk merr pjesë në vendimarrjen e trupit gjykues. Po kështu, në ndryshim nga sa pretendon kërkesja, Gjykata e Lartë, në përputhje me ndryshimet ligjore, të cilat kanë zgjeruar kufijtë e vendimarrjes së saj në dhomën e këshillimit, ka respektuar parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

16.3 Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka administruar prova të reja dhe as nuk i ka rivlerësuar ato, por e ka zgjidhur çështjen në themel, duke arsyetuar se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ishte ligji për prokurimin publik dhe jo KC-ja. Edhe pretendimi për përbërjen e trupit gjykues nuk gjen mbështetje, pasi caktimi i gjyqtarëve është realizuar në përputhje me ligjin nr. 98/2016, datë 6.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 98/2016*) dhe vendimin e Këshillit të Gjykatës së Lartë nr. 8, datë 25.3.2022 “Për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të kolegeve të Gjykatës së Lartë”.

16.4 Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës së pronës private*, kërkesja duhet t'i ngrinte pretendimet e saj kundrejt subjekteve të interesuara, shoqërive italiane, me të cilat kishte një marrëdhënie kontraktore private, por jo kundrejt autoritetit publik (ARRSH-së), me të cilin nuk kishte një marrëdhënie të tillë. Kjo e drejtë do të ishte cenuar nëse kërkeses do t'i mohohej e drejta e aksesit në gjykatë për të mbrojtur të drejtat e saj.

16.5 Në lidhje me pretendimin për nenin 70 të MSA-së, direktiva evropiane që parashikon

mekanizmin e pagesave të drejtpërdrejta, së pari, nuk ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së procedurave të prokurimit publik dhe, së dyti, ajo parashikon një mundësi dhe jo detyrim për shtetet anëtare që me anë të legjislacionit të brendshëm të mund të parashikojnë një mekanizëm të tillë. Deri më tani në vendin tonë një mekanizëm i tillë nuk është parashikuar.

17. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

17.1 Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit* është i pabazuar, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë përmbush standardet kushtetuese për një vendim të arsyetuar. Vetëm fakti se në të nuk janë pasqyruar kërkesat e paraqitura nga kërkesja për revokimin e vendimit të pezullimit nr. 107, datë 15.2.2018, nuk përbën cenim të këtij standardi. Kërkesja nuk është privuar nga e drejta për të parashtruar pretendimet e saj për rekursin, pasi ajo është njoftuar rregullisht në lidhje me të dhe ka pasur mundësinë të paraqesë prapësimet e saj lidhur me shkaqet e tij. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me të drejtë, ka përcaktuar se kontrata e nënkontraktimit nuk sjell asnjë detyrim për ARRSH-në, pasi, në rast të kundërt, ajo do të ishte e detyruar të paguante dy herë të njëjtin zë punimi, si ndaj kontraktorit, ashtu edhe ndaj kërkeses. Pretendimet e kërkeses duhet të ishin ngritur ndaj kontraktorit dhe jo ndaj autoritetit kontraktor. Kontrata e lidhur ndërmjet ARRSH-së dhe kontraktorit është një kontratë ndërkombëtare, por jo e standardizuar (FIDIC).

17.2 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar*. Në lidhje me relacionin e këshilltarit ligjor, Gjykata e Lartë nuk ka asnjë detyrim për ta vënë atë në dispozicion të palëve në proces ose t'i njohë paraprakisht me të dhe ky akt nuk sjell efekte ligjore për to. Po kështu, ndryshimet ligjore kanë ripozicionuar dhomën e këshillimit, duke ia lënë asaj kompetencën të vendosë në themel për mosmarrëveshjen, ndërkohë që palëve në proces, përfshirë kërkesen, u është dhënë mundësia të parashtrorjnë pretendimet e tyre përpara asaj gjykate.

17.3 Në lidhje me pretendimin për cenimin e *parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, Gjykata e Lartë, si gjykatë e ligjit, nuk ka administruar prova të reja dhe nuk i ka rivlerësuar ato, por ka arritur në përfundimin se nuk ndodhet përpara një



mosmarrëveshjeje civile, por përpara një kontrate administrative. Nisur nga fakti se ARRSH-ja nuk është palë në nënkontratë, ajo nuk ka legjitimitet pasiv në këtë çështje. Edhe pretendimi se caktimi i trupit gjykues nuk është bërë me short, është i pabazuar, pasi ai është bërë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

17.4 Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së pronës private, nisur nga fakti se mosmarrëveshja ka lindur midis dy palëve private, detyrimi i shtetit kufizohet vetëm në përcaktimin e mekanizmave për sigurimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës për pretendimet e palëve në konflikt, çka, në rastin konkret, i është garantuar kërkuases.

17.5 Pretendimet e kërkuases për cenimin e rregullave të MSA-së për konkurrencën nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Ekzistenca e marrëveshjes dhe miratimi i saj me ligj nuk janë të mjaftueshme për ta bërë atë të zbatueshme në praktikë, por për këtë qëllim është lidhur kontrata e datës 17.6.2009. Kontratat për kryerjen e punëve publike janë kontrata administrative, të cilat, në zbatim të parimit *lex specialis*, rregullohen sipas dispozitave të ligjit për prokurimin publik. Në rastin konkret, kërkuësja nuk pretendon se ligji për prokurimin publik bie në kundërshtim me MSA-në, por me detyrimin e gjykatës për ta zbatuar drejtpërdrejt këtë instrument në sistemin e brendshëm juridik.

18. **Subjekti i interesuar, bashkimi i shoqërive “Ing. Claudio Salini Grandi Lavori S.p.A.” & “Salvatore Matarrese S.p.A.”**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, megjithëse është njoftuar rregullisht nga Gjykata nëpërmjet njoftimit me shpallje.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuases

19. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi

gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

20. Gjykata vëren se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në përfundim të të cilit është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen.

21. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, individ duhet të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 56, datë 25.7.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata konstaton se kërkuësja i është drejtuar asaj për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Për rrjedhojë, kërkuësja nuk ka mjete të tjera ankimi në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese, të pretenduara të cenuara, përveç paraqitjes së këtij ankimi kushtetues individual.

23. Gjithashtu, kërkuësja, në parashtrimet e datës 18.4.2023 ka pretenduar marrjen në shqyrtim nga Gjykata të vendimit nr. 107, datë 15.2.2018 të Gjykatës së Lartë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, pasi ai ka sjellë cenimin e së drejtës së pronës së saj. Për sa i përket këtij pretendimi, Gjykata vlerëson se ai duhet trajtuar së bashku me pretendimin për antikushtetutshmërinë e vendimit nr. 00-2022-1201 (246), datë 16.6.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për aq sa janë të lidhura me njëra-tjetrën.

24. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret, procesi gjyqësor në



Gjykatën e Lartë ka përfunduar me vendimin e datës 16.6.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë më datë 9.12.2022, pra në dukje jashtë afatit ligjor. Kërkesja ka parashtruar se nisur nga fakti se vendimi nuk po publikohej i arsyetuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, ajo i është drejtuar kësaj të fundit me shkresën e protokolluar nr. 4719, datë 20.9.2022. Më tej, më datë 26.9.2022 kërkesja dhe përfaqësuesi i saj, nëpërmjet postës elektronike, janë njoftuar nga administrata e Gjykatës së Lartë për vendimin objekt kërkesë, kurse me shkresën nr. 4719/1, datë 12.10.2022, drejtuar përfaqësuesit të saj, në përgjigje të kërkesës së paraqitur nga ajo, kancelari i Gjykatës është shprehur: *“Për çështjen administrative nr. 31003-00567-00-2018 regjistri themeltar, për të cilën është dhënë vendimi me nr. 00-2022-1201, datë 16.6.2022 nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, nga verifikimet e kryera, rezulton se vendimi është zbardhur dhe ju është njoftuar në adresën elektronike të kontaktit.”* Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese, nga i cili fillon të rrjedhë afati i paraqitjes së ankimit kushtetues, konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar është bërë efektivisht i disponueshëm për kërkesen. Në këtë kuptim, duke konsideruar në rastin konkret datën 26.9.2022 si momentin e konstatimit të cenimit, konsiderohet i përmbushur kriteri i legjitimitimit *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

25. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkesen dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur.

26. Gjykata vëren se kërkesja ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar, për shkak të pamundësisë së saj për t’u përgjigjur me shkrim gjetjeve dhe përfundimeve të Gjykatës së Lartë në lidhje me natyrën publike të fondeve që kanë financuar kontratën objekt i mosmarrëveshjes, të cilat (gjetjet dhe përfundimet), nga ana e tyre, kanë ndikuar në identifikimin e ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Duke pasur parasysh natyrën e këtij pretendimi, Gjykata vlerëson se, në thelb, ai ka të

bëjë me mënyrën e ushtrimit të kompetencave ligjore nga Gjykata e Lartë, për rrjedhojë do ta trajtojë atë në këndvështrim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

27. Kërkesja ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e parimit të epërsisë së marrëveshjeve ndërkombëtare dhe zbatimit të drejtpërdrejtë të tyre, pasi Gjykata e Lartë ka shpërfillur nenin 7 të shtojcave 2 dhe 3 të marrëveshjes së lidhur midis qeverisë italiane dhe asaj shqiptare dhe ajo kishte detyrimin ta zgjidhte çështjen dhe ta interpretonte ligjin në përputhje me MSA-në, duke u dhënë operatorëve ekonomikë të njëjtin nivel mbrojtjeje dhe sigurie si traktatet dhe direktivat evropiane për kontratat publike. Në lidhje me këtë pretendim, për nga mënyra se si është parashtruar ai, Gjykata vlerëson se, në thelb, ka të bëjë me mënyrën e arsyetimit të vendimit të kundërshtuar, për rrjedhojë do të trajtohet në vijim në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit.

28. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së pronës, Gjykata çmon ta analizojë çështjen në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

29. Për sa më sipër, duke qenë se pretendimet e parashtruara nga kërkesja, konkretisht për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e aksesit dhe të drejtën e pronës, janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues dhe ato do të shqyrtohen në vijim në lidhje me bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj

30. Sipas kërkeses, Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj teksa ka shqyrtuar çështjen në themel, duke rivlerësuar provat e marra nga gjykatat më të ulëta, duke mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ato (gjykatat e faktit) lidhur me provat dhe duke tejkaluar në këtë mënyrë kufijtë e shqyrtimit të çështjes. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se nuk është zhvilluar procedurë përzgjedhëse prokurimi për kërkesen si nënkontraktore; se marrëdhënia e detyrimit ndërmjet kërkeses dhe ARRSH-së nuk buron nga kontrata publike e datës 17.6.2009, por nga



nënkontrata e datës 22.11.2022; se shoqëritë OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. nuk mund të merrnin në dorëzim punimet, pasi ato duhet të merreshin nga ARRSH-ja. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar kryesisht origjinën e fondeve që kanë financuar kontratën publike të datës 17.6.2009 dhe nënkontratën e datës 22.11.2012, si dhe natyrën publike ose private të këtyre fondeve. Po në këndvështrim të këtij parimi, zëvendësimi i anëtarëve të trupit gjykues në Gjykatën e Lartë nuk është bërë në bazë të shortit elektronik, pasi në dosjen gjyqësore rezulton një formular në të cilin anëtarë të kolegjit që do të shqyrtonin çështjen e kërkuar ishin gjyqtarët I.P., E.P. dhe S.S. (relator), ndërkohë që vendimi është marrë nga gjyqtarët S.S., G.M. dhe A.V. (relator).

31. Subjekti i interesuar, ARRSH-ja, ka prapësuar se Gjykata e Lartë nuk ka administruar prova të reja dhe as nuk i ka rivlerësuar ato, por e ka zgjidhur çështjen në themel, duke arsyetuar se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ishte ligji për prokurimin publik dhe jo KC-ja. Për sa i përket pretendimit për përbërjen e trupit gjykues, ai është i pabazuar, pasi caktimi i gjyqtarëve është realizuar në përputhje me ligjin nr. 98/2016 dhe vendimin e Këshillit të Gjykatës së Lartë nr. 8, datë 25.3.2022 “Për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të kolegeve të Gjykatës së Lartë”.

32. Sipas subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, Gjykata e Lartë, si gjykatë e ligjit, nuk ka administruar prova të reja dhe nuk i ka rivlerësuar ato, por ka arritur në përfundimin se nuk ndodhet përpara një mosmarrëveshjeje civile, por përpara një kontrate administrative. Për rrjedhojë, nisur nga fakti se ARRSH-ja nuk është palë në nënkontratë, ajo ka vlerësuar se nuk ka legjitimitet pasiv në këtë çështje. I pabazuar është edhe pretendimi se caktimi i trupit gjykues nuk është bërë me short, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

33. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj”. Ky element, në sensin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre

gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik (*shih vendimet nr. 15, datë 23.3.2023; nr. 3, datë 7.2.2023; nr. 7, datë 23.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë, jurisprudenca kushtetuese ka theksuar se ajo nuk mund të ndryshojë vendimet dhe të shprehet për themelin e çështjes, duke bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve që janë administruar gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar ose jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta (*shih vendimet nr. 15, datë 23.3.2023; nr. 44, datë 19.7.2016; nr. 36, datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuar nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra për mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta dhe ajo nuk mund të anashkalojë ose të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimit në fakt (*shih vendimet nr. 15, datë 23.3.2023; nr. 10, datë 3.4.2018; nr. 20, datë 20.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës së faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore, pasi një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj (*shih vendimet nr. 15, datë 23.3.2023; nr. 44, datë 19.7.2016; nr. 36, datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Duke iu kthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuarja ka ngritur dy argumente: *së pari*, Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, duke rivlerësuar provat e marra nga gjykatat më të ulëta dhe, *së dyti*, Gjykata



e Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, sepse zëvendësimi i anëtarëve të trupit gjykues në Gjykatën e Lartë nuk është bërë në bazë të shortit elektronik.

37. Për sa i përket pretendimit që lidhet me shortin elektronik, Gjykata vëren se në dosjen gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, rezulton një formular i datës 2.7.2021, në të cilin anëtarë të kolegjit administrativ që do të shqyrtonin çështjen e kërkujes rezultojnë gjyqtarët I.P., E.P. dhe S.S. (relator), ndërkohë që vendimi është marrë nga gjyqtarët S.S., G.M. dhe A.V. (relator).

38. Nenet 23, pikat 2 dhe 3 dhe 38, shkronja “ç”, të ligjit nr. 98/2016 parashikojnë krijimin në çdo gjykatë të seksioneve dhe trupave gjykues, sipas rregullave të parashikuara në ligjin procedural, si dhe caktimin në to të gjyqtarëve, duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe fushën e tyre të interesit, ndërsa neni 25, pika 1, i këtij ligji parashikon se ndarja e çështjeve gjyqësore bëhet me short, i cili realizohet në rrugë elektronike, bazuar në parimet e transparencës dhe të objektivitetit.

39. Gjykata, për nevoja të këtij gjykimi, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me shkresë për informacion në lidhje me mënyrën e hedhjes së shortit. Në përgjigje të kësaj shkrese, Gjykata e Lartë ka informuar se çështja e kërkujes është regjistruar në atë gjykatë më datë 12.3.2018 dhe është rishortuar automatikisht te Kolegji Administrativ, me gjyqtar A.D., ish- anëtar i Gjykatës së Lartë. Bazuar në urdhrin nr. 93, datë 16.4.2020 “Evidentimi dhe hedhja në short e çështjeve gjyqësore që janë regjistruar për shqyrtim në Gjykatën e Lartë”, është realizuar rishortimi i të gjitha çështjeve administrative të gjyqtarit S.S., i caktuar në përbërje të Kolegjit Administrativ. Në vijim, bazuar në urdhrin nr. 164, datë 2.9.2021 “Për disa masa organizative lidhur me menaxhimin e çështjeve gjyqësore”, është realizuar rishortimi i të gjitha çështjeve administrative midis gjyqtarëve S.S. dhe A.V., të caktuar në përbërje të Kolegjit Administrativ. Të gjitha këto veprime janë pasqyruar në regjistrin e veprimeve (regjistri elektronik) të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se procedura e caktimit të shortit në çështjen e kërkujes është bërë në përputhje me bazën ligjore të zbatueshme dhe aktet e tjera të dala për këtë qëllim nga Gjykata e Lartë, pra ky argument i saj është i pabazuar.

40. Për sa i përket pretendimit se Gjykata e Lartë ka bërë rivlerësim të provave në tejkalim të kompetencave të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata vëren se objekt i mosmarrëveshjes gjyqësore ka qenë mospërmblidhja e detyrimit kontraktor nga ARRSH-ja në lidhje me punimet e kryera prej kërkujes në zbatim të kontratës së nënkontraktimit të lidhur midis asaj dhe kontraktorit (bashkimi i shoqërive “Ing. Claudio Salini Grandi Lavori S.p.A” & “Salvatore Matarrese S.p.A”) për zbatimin nga ky i fundit të kontratës së lidhur midis kontraktorit dhe ARRSH-së, me objekt rehabilitimin e rrugës Shkodër-Hani i Hotit, bazuar në nenin 875 të KC-së, sipas të cilit personat (kërkuësja, në rastin konkret), të cilët, duke qenë në varësi të sipërmarrësit (kontraktori/bashkimi i shoqërive italiane, në rastin konkret), kanë ushtruar veprimtarinë e tyre për zbatimin e veprës ose kryerjen e shërbimit, mund të ngrenë padi drejtpërdrejt kundër porositësit (ARRSH-së, në rastin konkret), për të marrë atë çka u takon deri në plotësimin e detyrimeve që porositësi ka ndaj sipërmarrësit.

41. Në lidhje me këtë padi, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar se detyrimet e palës së paditur (ARRSH-së) rrjedhin nga nënkontrata e datës 22.11.2012 e lidhur midis kërkujes dhe kontraktorit dhe se punimet e marra përsipër ishin punime të paparashikuara në kontratën e datës 17.6.2009 midis kontraktorit dhe ARRSH-së. Kjo e fundit lejonte nënkontraktimin dhe kërkuësja është miratuar si nënkontraktore e ligjshme nga ana e ARRSH-së, duke i kryer punimet konform kontratës dhe kërkesave të shoqërive OST sh.a. dhe OSHEE sh.a., të cilat janë pronaret e linjave elektrike. Gjithashtu, sipas asaj gjykate, ka rezultuar e provuar se pala e paditur, (ARRSH-ja), në përputhje me nenin 864 të KC-së ka mbajtur një garanci në rast se do të konstatoheshin parregullsi në zbatimin e kontratës. Nga akti i ekspertimit ka rezultuar se ARRSH-ja ka pranuar punimet e kryera dhe se nuk ka provuar me asnjë mjet ligjor se ka kryer plotësisht pagesën për këto punime te kontraktori ose kërkuësja. Për rrjedhojë, referuar nenit 698 të KC-së, gjykata ka arritur në përfundimin se pala e paditur ka detyrimin të paguajë detyrimin e pretenduar kundrejt kërkujes. Në këtë mënyrë gjykata ka arritur në përfundimin se mosmarrëveshja midis palëve është e natyrës civile dhe se ARRSH-ja



gjendet në pozitat e porositësit, në kuptim të nenit 875 të KC-së.

42. Gjykata Administrative e Apelit, e vënë në lëvizje nga subjektet e interesuara, ARRSH-ja dhe Avokatura e Shtetit, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, duke arsyetuar se në zgjidhjen e mosmarrëveshjes i referohet kontratës së datës 17.6.2009 dhe se detyrimi i ARRSH-së ka lindur nga nënkontrata e datës 22.11.2012 dhe parashikimet e KC-së. Ajo ka arsyetuar se punimet janë marrë në dorëzim pa pretendime nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si dhe përfundimi i punimeve është pasqyruar në aktet e marrjes në dorëzim të datave 25.5.2013 dhe 27.6.2013, ku rezulton se ato janë kryer në përputhje me kushtet teknike të kontratës së lidhur me OST sh.a. dhe OSHEE sh.a., të cilat janë pronaret e linjave të spostuara. Sipas gjykatës, pala e paditur nuk ka arritur të provojë që këtë shumë t'ia ketë shlyer kërkuases ose kontraktorit, ndonëse ka pranuar punimet dhe dorëzimin e projektit dhe është njoftuar nga kërkuësja për faktin se kontraktori nuk po shlyente detyrimin e saj. Edhe sipas gjykatës së apelit mosmarrëveshja midis palëve është e natyrës civile dhe ARRSH-ja gjendet në pozitat e porositësit në kuptim të nenit 875 të KC-së.

43. Në ndryshim nga sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se të dyja gjykatat më të ulëta nuk kanë vlerësuar drejt natyrën e marrëdhënies juridike, duke zgjidhur në mënyrë të gabuar çështjen, si pasojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit. Sipas tij, kontratat që lidhin organet e administratës publike me qëllim kryerjen e punëve publike, duke përdorur fondet shtetërore, rregullohen nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili përcakton rregullat që zbatohen lidhur me prokurimin e mallrave, të punëve dhe shërbimeve publike, me qëllim që të sigurohet mirëpërdorimi i fondeve publike, trajtimi i barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në procedurat e prokurimit publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit. Për rrjedhojë, administrata nuk karakterizohet nga autonomia e vullnetit dhe liria kontraktore në të njëjtën mënyrë me një palë private. Gjithashtu, në kontratat e prokurimit publik, autoriteti kontraktor miraton nënkontraktorët e propozuar nga operatori ekonomik, por ata mbeten në pozitën e të tretit në raport me autoritetin kontraktor dhe nuk mund t'i

drejtojnë atij kërkitje të drejtpërdrejta (*shih paragrafët 21 dhe 22 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

44. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Gjykata e Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 10, datë 3.4.2018; nr. 20, datë 20.3.2017; nr. 83, datë 30.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Duke iu kthyer rastit konkret, nën dritën e jurisprudencës së sipërcituar, Gjykata vëren se nga vendimet e gjykatave më të ulëta nuk rezultojnë të dhëna për natyrën dhe burimin e fondeve të përdorura për financimin e punimeve të parashikuara në kontratën midis autoritetit kontraktor, (ARRSH-së) dhe kontraktuesit (bashkimi i shoqërive italiane) ose midis këtij të fundit dhe nënkontraktuesit (kërkuësja). Pra, asnjëra nga gjykatat e faktit nuk është shprehur lidhur me origjinën e fondeve që kanë shërbyer për financimin e punimeve të parashikuara nga kontratat e sipërpërmendura (nëse ato janë fonde shtetërore/publike). Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se fondet që janë përdorur për financimin e punimeve të parashikuara janë shtetërore/publike, pa u vërtetuar një fakt i tillë nga gjykatat më të ulëta. Pikërisht, nisur nga kjo premisë (e pavërtetuar nga gjykatat e faktit), Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se kontrata objekt gjykimi është kontratë administrative dhe se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është ligji për prokurimin publik.

46. Përcaktimi i natyrës/burimit të fondeve mbi të cilat është realizuar puna publike (projekti për projektimin ekzekutues dhe përforcimin e rrugës Shkodër-Hani i Hotit) është në thelb një çështje fakti që duhej të ishte përcaktuar nga gjykatat e shkallëve më të ulëta. Këto të fundit, nga ana e tyre, nuk e kanë bërë këtë çështje (natyrën/burimin e fondeve) pjesë të debatit gjyqësor. Për pasojë, me analizën që Gjykata e Lartë i ka bërë natyrës së fondeve, duke arritur në përfundimin se ato (fondet) janë shtetërore/publike, ka marrë rolin e gjykatës së faktit, në kundërshtim me rolin rishikues të ligjit që ka ajo gjykatë.

47. Gjykata vlerëson se nëse Gjykata e Lartë do të kishte dyshime mbi faktin e origjinës / natyrës së fondit që ka financuar punimet e parashikuara nga



kontratat e mësipërme, ajo duhej ta kthente çështjen për rigjykim, duke dhënë udhëzimet përkatëse, në mënyrë që gjykatat e zakonshme të arrinin në një konkluzion të plotë për çështjen. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuësës për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj është i bazuar.

48. Në kushtet kur kjo çështje do të rishqyrtohet nga Gjykata e Lartë, Gjykata çmon të mos ndalet më tej në analizën e pretendimeve të tjera të kërkuësës në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e aksesit, ndërsa, për sa i përket pretendimit të kërkuësës për cenimin e së drejtës së pronës, Gjykata çmon se, për sa kohë konstatoi cenimin nga Gjykata e Lartë të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, ky cenim ka ndikuar edhe në këtë të drejtë.

49. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa, sipas arsyetimit të mësipërm, është e bazuar, ndaj duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1201 (246), datë 16.6.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
 3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 19.9.2023.

Shpallur, më 19.10.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë : Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Genti Ibrahim, Marjana Semini

Anëtarë kundër: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuësës shoqëria “Ndrekaj sh.p.k.”, me objekt: “*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1201 (246), datë 16.6.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.*”, jemi kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes rezulton se më datë 17.6.2009 ndërmjet subjekteve të interesuara, ARRSH-së (*autoriteti kontraktor*) dhe bashkimit të shoqërive “Ing. Claudio Salini Grandi Lavori S.p.A” & “Salvatore Matarrese S.p.A” (*kontraktor*), është lidhur një kontratë shërbimi për projektimin dhe përforcimin e rrugës Shkodër-Hani i Hotit. Për realizimin e një pjese të kësaj kontrate, kontraktori ka nënshkruar kontratën e nënkontraktimit të datës 22.11.2012 me kërkuësën, me objekt realizimin e punimeve dhe shërbimeve për spostimin e linjave elektrike në këtë segment rrugor. Me pretendimin se kontraktori nuk kishte përmbushur detyrimet financiare sipas nënkontratës, kërkuësja më datë 15.12.2015 i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me të paditur ARRSH-në dhe person të tretë kontraktorin, me objekt përmbushjen e detyrimit që buronte nga nënkontrata dhe detyrimin e palës së paditur t’i kthejë shumën prej 244,182 eurosh, si dhe kamatëvonesat.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2990 (80-2016-2980), datë 13.6.2016, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke detyruar ARRSH-në t’i shlyejë kërkuësës detyrimin që rrjedh nga nënkontrata e datës 22.11.2012, në vlerën 244,182 euro dhe kamatëvonesat në shumën 10,874 euro. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 5136 (86-2017-5460), datë 20.9.2018. Të dyja gjykatat kanë arritur në përfundimin se mosmarrëveshja midis palëve është e natyrës civile dhe se detyrimi i ARRSH-së buron nga neni 875 i Kodit Civil. Mbi rekursin e ARRSH-



së dhe Avokaturës së Shtetit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1201 (246), datë 16.6.2022, ka vendosur të ndryshojë vendimet e dy gjykatave më të ulëta, duke rrëzuar kërkesëpadinë.

4. Kërkesja, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, me argumentin se Gjykata e Lartë teksa ka shqyrtuar çështjen në themel, ka rivlerësuar provat e marra nga gjykatat më të ulëta, duke mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ato (gjykatat e faktit) lidhur me provat dhe duke tejkaluar, në këtë mënyrë, kufijtë e shqyrtimit të çështjes.

5. Për gjykimin që zhvillohet në Gjykatën e Lartë jurisprudenca kushtetuese, në mënyrë të vazhdueshme, ka vlerësuar se ai lidhet me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të marra nga gjykatat më të ulëta, ndërsa nxjerrja e konkluzionit mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave, nga vlerësimi i dy gjykatave të shkallëve më të ulëta, nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në atë gjykatë. Gjykata e Lartë nuk e ka kompetencën të konkludojë për provat, duke u nisur nga një tjetër vlerësim që kanë bërë gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit. Gjatë shqyrtimit të çështjeve ajo nuk merr prova, por shqyrton dhe analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe të bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara. Një kontroll i tillë konsiston në analizën e plotë të fakteve dhe të rrethanave, të cilat janë pranuar më parë si të vërteta nga gjykata e faktit dhe ajo e apelit, pa i ndryshuar ato (*shih vendimet nr. 13, datë 20.2.2017; nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimin në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi për themelin e çështjes, në kuptim të ligjit procedural, është që jo vetëm të mos nevojitet

administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimet nr. 40, datë 14.9.2023; nr. 15, datë 23.3.2023; nr. 10, datë 3.4.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Lidhur me këtë pretendim, shumica ka arritur në përfundimin se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Sipas saj “[...] nga vendimet e gjykatave më të ulëta nuk rezultojnë të dhëna mbi natyrën dhe burimin e fondeve të përdorura për financimin e punimeve të parashikuara në kontratën midis autoritetit kontraktor (ARRSH-së) dhe kontraktuesit (bashkimi i shoqërive italiane) ose midis këtij të fundit dhe nënkontraktuesit (kërkuesi). Pra, asnjëra nga gjykatat e faktit nuk është shprehur lidhur me origjinën e fondeve që kanë shërbyer për financimin e punimeve të parashikuara nga kontratat e sipërpërmendura (nëse ato janë fonde shtetërore/publike). Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se fondet që janë përdorur për financimin e punimeve të parashikuara janë shtetërore/publike, pa u vërtetuar një fakt i tillë nga gjykatat më të ulëta. [...] Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se kontrata objekt gjykimi është kontratë administrative dhe se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është ligji për prokurimin publik. Përcaktimi i natyrës/burimit të fondeve mbi të cilat është realizuar puna publike, është në thelb një çështje fakti që duhej të ishte përcaktuar nga gjykatat e shkallëve më të ulëta. Këto të fundit, nga ana e tyre, nuk e kanë bërë këtë çështje (natyrën/burimin e fondeve) pjesë të debatit gjyqësor. Për pasojë, me analizën që Gjykata e Lartë i ka bërë natyrës së fondeve, duke arritur në përfundimin se ato (fondet) janë shtetërore/publike, ka marrë rolin e gjykatës së faktit, në kundërshtim me rolin rishikues të ligjit që ka ajo gjykatë.” (*shih paragrafët 45-46 të vendimit*).

8. Në referim të standardeve kushtetuese të mësipërme, në ndryshim nga shumica, ne gjyqtaret në pakicë çmojmë se Gjykata e Lartë në dhënien e vendimit të kundërshtuar ka vepruar brenda kufijve të përcaktuar nga neni 141 i Kushtetutës, që parashikon se Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit. Në përputhje me këtë delegim kushtetues, ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, parashikon se një prej shkaqeve për të paraqitur rekurs lidhet me zbatimin e gabuar të ligjit material, të një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore (neni 58, shkronja “a”) dhe se



Gjykata e Lartë, ndër të tjera, vendos ndryshimin e vendimeve të gjykatave të faktit dhe zgjidhjen e çështjes në themel kur zbatimi i ligjit material nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes (neni 63, pika 1, shkronja “dh”).

9. Mbi bazën e këtij kuadri normativ, Avokatura e Shtetit ka rekursuar vendimet e gjykatave të faktit, duke parashtruar si shkak zbatimin e gabuar të ligjit material në përcaktimin e marrëdhënies kontraktore, ku ARRSH-ja ishte palë, me pretendimin se për këtë shkak ARRSH-së i mungonte legjitimiteti pasiv. Me fjalë të tjera, Avokatura e Shtetit ka pretenduar se kontrata e shërbimit për projektimin dhe përforsimin e rrugës Shkodër-Hani i Hotit, në të cilën ARRSH-ja ka pasur cilësinë e autoritetit kontraktor, është me natyrë administrative dhe jo civile, ndaj ajo nuk mund të paditej në gjykatë dhe më tej të ngarkohej me detyrime kontraktore sipas rregullave të Kodit Civil që trajtojnë sipërmarrjen dhe nënsipërmarrjen. Duhet theksuar se një pretendim i tillë nga Avokatura e Shtetit është ngritur edhe në ankimin në shkallë të dytë, pretendim i cili është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit, madje një gjyqtar i pakicës ka argumentuar në favor të këtij pretendimi.

10. Gjykata e Lartë ka shqyrtuar shkaqet e rekurseve të Avokaturës së Shtetit dhe ARRSH-së, duke vlerësuar se vendimmarrja e gjykatave më të ulëta *“është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit jo të drejtë të kërkesave të ligjit material, e një rëndësie themelore për zhvillimin e praktikës gjyqësore”* (shih paragrafin 18 të vendimit të Gjykatës së Lartë) dhe se *“gjykatat më të ulëta nuk kanë vlerësuar drejt natyrën e marrëdhënies juridike mes palëve ndërgjyqëse dhe si rrjedhojë janë orientuar nga dispozitat ligjore që nuk gjejnë zbatim në rastin konkret, duke zgjidhur në mënyrë të gabuar çështjen, si pasojë e interpretimit e zbatimit të gabuar të ligjit”* (shih paragrafin 19 të vendimit të Gjykatës së Lartë). Në vijim, Gjykata e Lartë ka konkluduar se kontrata e shërbimit publik ishte me natyrë administrative, si dhe ka arsyetuar se këto lloj kontratash rregullohen nga Kodi Civil vetëm për sa ai nuk bie ndesh me rregullimet specifike të normave të së drejtës publike dhe se nënkontraktorët kanë pozitën e të tretit në raport me autoritetin kontraktor, ndaj ato nuk mund t'i kundrejojnë kërkitë drejtpërdrejt autoritetit kontraktor, por vetëm operatorit ekonomik, me të cilin kanë lidhur kontratën e nënkontraktimit (shih paragrafin 22 të vendimit të Gjykatës së Lartë).

11. Për sa më lart, konstatojmë se Gjykata e Lartë ka analizuar mosmarrëveshjen në gjykim, duke vlerësuar se ajo i përket fushës administrative dhe jo asaj civile, dhe e ka zgjidhur çështjen duke përcaktuar se dispozitat e Kodit Civil për nënsipërmarrjen nuk gjejnë zbatim. Prandaj jemi të mendimit se Gjykata e Lartë ka ushtruar plotësisht funksionin e saj si gjykatë ligji, pasi nuk ka bërë as rivlerësim provash, as ripërcaktim faktesh të mosmarrëveshjes.

12. Përkundër pranimi se Gjykata e Lartë ka ripërcaktuar natyrën/ burimin e fondeve të përdorura për zbatimin e kontratës, shumica nuk ka arritur të evidentojë asnjë element i cili tregon rivlerësim të provave nga ajo gjykatë apo të identifikojë se cilat kanë qenë ato prova dhe ku qëndron ndryshimi pas rivlerësimit që ajo u ka bërë atyre. Referimi i Gjykatës së Lartë te fondet e përdorura për zbatimin e kontratës administrative, si “fonde shtetërore” ose “fonde publike” i ka shërbyer analizës së lirisë së vullnetit kontraktor në kontratat administrative, ndaj ky referim është një rrethanë periferike (dytësore) në çështjen konkrete dhe nuk përbën elementin themelor që ka përcaktuar natyrën administrative të kontratës konkrete të shërbimit publik.

13. Edhe pse Gjykata e Lartë nuk është ndalur të shpjegojë gjerësisht konceptin ligjor të fondeve publike, duhet evidentuar se ai nuk përbën rrethanë fakti të përcaktuar për herë të parë nga Gjykata e Lartë, që duhej përcaktuar me prova nga gjykatat e faktit. Jo vetëm që konceptin e fondit publik e përcakton ligji nr. 160/2022 “Për prokurimin publik” (shih nenin 4, pika 9), por qartësisht marrëveshja e ratifikuar me ligj ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për financimin e programit “Rehabilitimi i rrugës Shkodër-Hani i Hotit” përcakton se burimet financiare të nevojshme për realizimin e programit do të jenë në kredi ndihme me periudhë rimbursimi 39 vjet dhe fond grant (detyrime të qeverisë italiane), si dhe ato në kompetencë të qeverisë shqiptare (detyrime prej 4.500.000 eurosh), fakte të cilat nuk përmenden nga shumica në vendim. Në këtë kuptim, referimi “fonde publike”, ndonëse pa arsyetim, jo vetëm që nuk është rrethanë përcaktuese nga pikëpamja kushtetuese për standardin e gjykatës së caktuar me ligj, por përkundrazi është tregues se Gjykata e Lartë



ka vepruar brenda kompetencave të saj kushtetuese dhe ligjore.

14. Edhe nga përmbajtja e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk rezulton që ky kolegj të ketë administruar ndonjë provë të re apo të ketë bërë një rivlerësim të provave të administruara në gjykimet e faktit dhe më konkretisht të atyre që lidhen me përcaktimin e fondeve të përdorura gjatë zbatimit të kontratës. Referimi ose përmendja e fondeve publike në arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk duhet parë në këndvështrimin e trajtimit si provë më vete dhe e shkëputur nga arsyetimi ku bazohet vendimi i atij kolegj, por në kontekst të arsyetimit tërësor të vendimit dhe si konkluzion logjik i analizës së të gjithë procesit të lidhjes së kontratave, me qëllim kryerjen e një shërbimi publik. Në këtë këndvështrim, Gjykata e Lartë, në respektim të funksionit të saj kushtetues si gjykatë e ligjit, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe rrëzimin e kërkesëpadisë, duke mos u bazuar në mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Ajo nuk ka ripërcaktuar faktet e mosmarrëveshjes, nuk ka bërë rivlerësimin e provave dhe as nuk është shprehur në mënyrë të kundërt me provat e administruara në gjykim, nuk ka shqyrtuar ndonjë provë të re të paadministruar nga gjykatat më të ulëta dhe nuk ka disponuar një vendimmarrje që mund të bazohet në prova të pashqyrtuara më parë. Pra, Gjykata e Lartë nuk ka nxjerrë konkluzion të kundërt për provat, por ka arsyetuar në lidhje me ligjin e zbatueshëm në rastin konkret, çka hyn në atributin e saj kushtetues.

15. Referimi i Gjykatës së Lartë në fakte, konkretisht organi administrativ që ka qenë palë në kontratë, burimi i detyrimit të pagimit apo marrja në dorëzim e punimeve, ka qenë në funksion të arsyetimit të vendimit dhe në përputhje me kompetencat e saj kushtetuese të interpretimit të normave ligjore si gjykatë e ligjit. Madje edhe ky referim është bërë në mënyrë të kujdesshme nga Gjykata e Lartë, e cila është shprehur: “*Kolegji vlerëson se në referim të akteve të administruara në dosjen gjyqësore, të cilat janë marrë në shqyrtim nga gjykatat më të ulëta, si dhe të pretendimeve të palëve në proces, gjykatat e faktit kanë pranuar [...] (shih paragrafin nr. 24 të vendimit), për të vijuar më pas se mbi faktet e provuara gjyqësisht, gjykatat më të ulëta kanë gabuar në zbatimin e ligjit.*

16. Në përfundim, ne gjyqtaret në pakicë vlerësojmë se pretendimi për cenimin e parimit të

gjykatës së caktuar me ligj është i pabazuar, për rrjedhojë duhej të ishte vendosur rrëzimi i kërkesës.

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari

VENDIM Nr. 44, datë 26.9.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 26.9.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjes nr. 4 (D) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Dashmira Zaro

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të çështjes nr. 21234-02321-30-2022, datë regjistrimi 17.11.2022.

Konstatimi i mungesës së një mjeti ligjor efektiv për përshpejtimin e gjykimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Ministrisë së



Drejtësisë (MD) dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), si dhe Avokaturës së Shtetit, në cilësinë e përfaqësueses të subjekteve të interesuara, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 322, datë 15.4.2015 (VKM nr. 322/2015), ka vendosur shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve në Parkun e Viroit, Gjirokastrë, ku bën pjesë edhe kërkuësja. Për shkak se mbi bazën e kësaj VKM-je, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Gjirokastrë ka kufizuar pronën e kërkuësjes, ajo ka paraqitur padi për konstatimin e vendosjes së kufizimit mbi tagrat e pronësisë që barazohet me shpronësimin e pjesës së mbetur të pronës pas shpronësimit me VKM-në nr. 322/2015, detyrimin e ZVRPP-së, Gjirokastrë të hedhë gjurmën e projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, detyrimin e Bashkisë Gjirokastrë të ndalojë cenimin e pronës dhe të heqë barrierën e palëvizshme metalike nga rruga, si dhe detyrimin e kësaj bashkie dhe të Ministrisë së Zhvillimit Urban për nxjerrjen e akteve administrative që zgjidhin pasojat e përdorimit të pronës në funksion të rikonstruksionit të Parkut të Viroit.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, me vendimin nr. 443, datë 18.7.2017, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke urdhëruar ZVRPP-në, Gjirokastrë, të hedhë gjurmën e projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe të pajisë kërkuësen me certifikatë pronësie për pronën e mbetur nga shpronësimi. Në lidhje me kërkimin për ndalimin e cenimit të pronësisë dhe heqjen e barrierës së palëvizshme nga Bashkia Gjirokastrë, gjykata ka shpallur moskompetencën lëndore dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, si gjykata kompetente, kurse në lidhje me kërkimet e tjera të kërkesëpadiës ka vendosur rrëzimin e tyre.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, me vendimin nr. 392, datë 24.7.2017, ka vendosur mospranimin e ankimit të kërkuësjes për

pjesën që ka shpallur moskompetencën lëndore, i cili, pasi janë ezauruar mjetet e ankimit, është lënë përfundimisht në fuqi. Për sa i takon ankimit për pjesën që ka rrëzuar kërkimin e padisë për ndalimin e cenimit të pronësisë dhe nxjerrjen e akteve administrative, ai është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit. Në pritje të shqyrtimit të tij kërkuësja i është drejtuar, fillimisht, në datën 20.7.2018, relatores së çështjes dhe kryetarit të asaj gjykate, për përshpejtimin e gjykimit dhe pasi nuk ka marrë përgjigje, në datën 20.8.2018, bazuar në nenet 399/1, 399/2, pikat 1, shkronja “a” dhe 2, si dhe 399/6, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Civile (KPC) ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit dhe përshpejtimin e gjykimit.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës i Lartë, me vendimin nr. 2/5/2, datë 17.6.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ky vendim është kundërshtuar nga kërkuësja në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), duke kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit brenda një afati të arsyeshëm.

5. Gjykata, me vendimin nr. 2, datë 17.2.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duke detyruar Gjykatën Administrative të Apelit të gjykojë çështjen brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Për rrjedhojë, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt shpërblimin e dëmit si rezultat i konstatimit të cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Me vendimin nr. 4844, datë 28.9.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të saj dhe detyrimin e MD-së dhe MFE-së të paguajnë në favor të kërkuësjes shumën 200,000 (dyqind mijë) lekë, si shpërblim për dëmin jopasuror të pësuar për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes gjyqësore.

6. Në datën 26.9.2022, për shkak se çështja e themelit nuk ishte shqyrtuar ende nga Gjykata Administrative e Apelit, kërkuësja i është drejtuar sërish Gjykatës për konstatimin e vijimit të cenimit të së drejtës për proces të rregullt, si dhe konstatimin e mungesës së një mjeti ligjor efektiv për dëmshpërblim pas hyrjes në fuqi të vendimit të saj nr. 2, datë 17.2.2022. Me vendimin nr. 20, datë



5.4.2023, Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se edhe pse shqyrtimi i çështjes së themelit është bërë me rreth 6 muaj vonesë nga hyrja në fuqi e vendimit të saj, mjeti procedural i përdorur nga kërkesja e ka arritur qëllimin e tij, për sa kohë që Gjykata Administrative e Apelit e ka përshpejtuar gjykimin, duke u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë substanciale që lidhen me cenimin e interesave të ligjshëm të kërkeses. Po kështu, Gjykata ka vlerësuar se edhe pse me vendimin nr. 4844, datë 28.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur shpërblimi i kërkeses për periudhën nga 19.3.2019 deri më 23.3.2022, ajo nuk ka asnjë pengesë të kërkojë shpërblimin e drejtë për shkak të vonesës së shqyrtimit të çështjes me rreth 6 muaj nga Gjykata Administrative e Apelit. Në lidhje me kërkimin tjetër të kërkeses, Gjykata ka vlerësuar se ajo nuk ka arritur të argumentojë mungesën e efektivitetit të mjetit, për më tepër kur kërkesa e parë e saj për shpërblimin e dëmit jopasuror për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes gjyqësore ka rezultuar të jetë një mjet efektiv.

7. Ndërkohë, kundër vendimit nr. 4844, datë 28.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur ankim MD-ja më 20.10.2022 dhe në gjykatën e apelit është regjistruar më 17.11.2022, çështja nr. 21234-02321-30-2022.

8. Me kërkesat e datave 20.12.2022 dhe 30.1.2023 (data e regjistrimit të tyre), kërkesja i është drejtuar gjyqtarës relatores për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, në situatën që nga të dhënat e faqes zyrtare nuk rezultonte të ishte caktuar një datë për zhvillimin e seancës gjyqësore. Në datën 3.2.2023, çështja e kërkeses i është caktuar me short elektronik një gjyqtareje tjetër, kurse në datën 20.2.2023, nëpërmjet shërbimit postar, kërkesja ka paraqitur në gjykatën e apelit, si gjykata në vonesë, kërkesën drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes (ankimit) dhe detyrimin për gjykimin e saj brenda 30 ditëve. Sipas të dhënave të paraqitura bashkëlidhur kërkesës, kërkesja, në datën 4.4.2023, ka kërkuar informacion me *email* në lidhje me këtë kërkesë, për të cilën me *email*-in e datës 17.4.2023, të administratës së gjykatës së apelit ka marrë përgjigje se kërkesa është depozituar në atë gjykatë. Në vijim ajo ka kërkuar informacion nga gjykata e apelit nëse kërkesa e saj ishte dërguar në Gjykatën e Lartë, për

të cilën nuk rezultoi që të ketë pasur një përgjigje nga administrata e asaj gjykate.

9. Me *email*-in e datës 9.4.2023, kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë për informacion në lidhje me kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykatën e apelit dhe me *email*-in e datës 13.4.2023, të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë është informuar se në Gjykatën e Lartë nuk ka të regjistruar një kërkesë të tillë.

10. Në datën 24.4.2023, kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm të çështjes nr. 21234-02321-30-2022, datë regjistrimi 17.11.2022 dhe konstatimin e mungesës së një mjeti ligjor efektiv për përshpejtimin e gjykimit. Kjo kërkesë, pasi është plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 10.5.2023.

11. Me vendimin e datës 6.7.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, me vendimin e datës 14.7.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. Kërkesja, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar sa vijon:

12.1 Sipas parashikimeve të nenit 399/7, pika 1, të KPC-së çështje të kësaj natyre duhet të shqyrtohen brenda 3 muajve nga data e regjistrimit, ndërkohë që çështja është regjistruar më 17.11.2022 dhe deri në datën e paraqitjes së ankimit kushtetues nuk kishte përfunduar ende. Në çështjen *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë* Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), ka theksuar nevojën që këto procedura të kryhen në mënyrë të menjëhershme që zgjidhja të mbetet efektive, duke vlerësuar se shqyrtimi i këtyre kërkesëpadive bëhet sipas rregullave të posaçme, të cilat ndryshojnë nga ato të padive të zakonshme. Edhe pse kërkesja ka paraqitur në gjykatën që është në vonesë kërkesë për përshpejtimin e gjykimit, ajo nuk i është dërguar Gjykatës së Lartë për shkak të sjelljes, papërgjegjshmërisë së gjykatës së apelit.



12.2 Në lidhje me kërkimin për konstatimin e mjetit ligjor efektiv, edhe pse kërkesa drejtuar Gjykatës së Lartë është depozituar në gjykatën që është në vonesë në datën 22.2.2023, sipas shërbimit postar, në përputhje me nenin 399/5, pika 1, të KPC-së, ajo nuk i është dërguar Gjykatës së Lartë për shkak të sjelljes, papërgjegjshmërisë së gjykatës së apelit.

13. Subjekti i interesuar, MD-ja, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

13.1 Kërkuesja nuk ka shteruar formalisht mjetet juridike, pasi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt për shkak të mosshqyrtimit të kërkesës brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë, por nga dokumentet bashkëlidhur kërkesës nuk provohet që kjo kërkesë të jetë depozituar në atë gjykatë. Edhe në aspektin substancial, kërkuesja nuk ka arritur të argumentojë përmbushjen e kriterëve të tjera për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, sipas nenit 71/a, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, pra pasojat negative të drejtpërdrejta dhe reale dhe se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata do të mund të rivendoste të drejtën e shkelur.

13.2 Në lidhje me themelin e çështjes, kërkuesja nuk ka paraqitur argumente kushtetuese konkrete në mbështetje të pretendimit të saj, por ka referuar vetëm vendimin e GJEDNJ-së në çështjen *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë* dhe vendime të Gjykatës Kushtetuese për efektivitetin e kërkesave për përsheptim, pa argumentuar lidhjen e tyre me rrethanat dhe faktet e çështjes konkrete apo me të drejtën kushtetuese të cenuar nga gjykata e apelit. Referuar kriterëve mbi të cilat bëhet përcaktimi i tejzgjatjes së procedurave, rezulton se çështja (ankimi) është regjistruar në gjykatën e apelit më 17.11.2022, ndaj nuk ndodhemi në rastin e tejkalimit të afateve, pasi sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, afati i gjykimit të çështjeve civile në atë gjykatë është brenda 2 vjetëve. Pretendimi se çështje të kësaj natyre duhen gjykuar në gjykatën e apelit brenda 3 muajve, sipas përcaktimeve të nenit 399/7, pika 1, të KPC-së, është i pabazuar, pasi kjo dispozitë përcakton afatin për shqyrtimin e padive sipas nenit 399/6, pika 3, të KPC-së, lidhur me kërkesëpaditë për shpërbimin e dëmit që u drejtohen gjykatës së shkallës së parë, ndaj është i vlefshëm e zbatohet vetëm për ato gjykata.

13.3 Edhe në rast se do të merrej në konsideratë pretendimi i kërkueses për afatin 3-mujor, duke iu referuar kriterëve për përcaktimin e kohëzgjatjes së

arsyeshme, për sa i përket sjelljes së gjykatës së apelit mosveprimi i saj duhet parë nën dritën e rrethanave konkrete në të cilat ndodhet aktualisht sistemi gjyqësor, siç janë zbatimi i Reformës në Drejtësi, riorganizimi rishtazi i gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe ngarkesa totale individuale e gjyqtarit relator. Kërkuesja nuk ka provuar se mosveprimi i gjykatës së apelit ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit.

13.4 Në lidhje me sjelljen e kërkueses, nuk rezulton që të drejtat ose interesat e saj të kenë qenë të rrezikuara në nivele të konsiderueshme nga mosgjykimi i çështjes civile. Referuar objektit të gjykimit dhe mosmarrëveshjes gjyqësore, kjo çështje nuk përfshihet në ato që kërkojnë përparësi në radhën e gjykimit.

14. Subjekti i interesuar, MFE-ja, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

14.1 Parashikimet e neneve 399/1 e vijues të KPC-së nuk mund të interpretohen në mënyrë të ngushtë, pasi kjo do të sillte humbjen e qëllimit të tyre dhe disbalancë në raport me situatën objektive të përgjithshme të krijuar nga mbingarkesa e sistemit gjyqësor. Sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, afati prej 2 vjetësh i kohëzgjatjes së procesit plotësohet më 17.11.2024. Parashikimi i kësaj dispozite nënkupton konstatimin e cenimit edhe pa kaluar ky afat nëse verifikohen në mënyrë kumulative kriteret e kompleksitetit të çështjes, sjelljes së organit që procedon, zvarritja e qëllimshme etj.

14.2 Konstatimi i tejkalimit të afatit dhe përsheptimi i procedurave është i lidhur me shkeljen e së drejtës pa shkak ligjor dhe pa ekzistencën e një situatë objektive. Në rastin konkret nuk ndodhemi përpara një shkeljeje të qëllimshme të afatit të arsyeshëm, pasi ajo duhet të vijë si pasojë e veprimeve të organit që procedon dhe në mënyrë të padrejtë, por ndodhemi përpara një situatë objektive të ngarkuar të sistemit gjyqësor, që në gjykatën e apelit lidhet edhe me riorganizimin e saj për shkak të miratimit të hartës së re gjyqësore. Kjo përbën shkak objektiv të vonesës në gjykimin e çështjes, pasi transferimi, gjykimi dhe rishqyrtimi i çështjeve të transferuara në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm është një proces i shtrirë në kohë. Tejkalmi i afatit të arsyeshëm nuk nënkupton kalimin në kuptimin formal, por atë substancial, pra kundërligjshmërinë e veprimeve të



organit në vonesë, zvarritjen e qëllimshme ose të paarsyeshme etj.

14.3 Qëllimi i nenit 399/3 të KPC-së është përcaktimi, rast pas rasti, i shpërblimit në proporcion me gjendjen që e ka diktuar tejkalimin e afatit të arsyeshëm dhe qoftë edhe përsheptimi i procedurave do të konsiderohet shpërblim i drejtë kur është rasti. Kurse shpërblimi financiar duhet të jetë në raport të drejtë me situatën konkrete dhe jo domosdoshmërisht i nevojshëm.

15. Avokatura e Shtetit, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

15.1 Duke analizuar kriteret për përllogaritjen e afatit të arsyeshëm, në lidhje me periudhën që duhet marrë në konsideratë, çështja është regjistruar në gjykatën e apelit në datën 17.11.2022, për rrjedhojë nuk është kaluar afati 2-vjeçar i parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së. Ligjvënësi nuk ka parashikuar në nenin 399/7 afat për gjykimin në gjykatën e apelit.

15.2 Çështja konkrete lidhet me shpërblimin e dëmit në bazë të nenit 399/6, pikat 2 dhe 3, të KPC-së, për rrjedhojë tejzgjatja e procedurave gjyqësore nuk paraqet shkallë të konsiderueshme rreziku për interesin e kërkuësës. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, duhet mbajtur në konsideratë ngarkesa totale individuale e gjyqtarit relator, si dhe ngarkesa e tij në raport me gjyqtarët e tjerë. Kjo çështje i është caktuar gjyqtarës relatore në muajin shkurt, kur është depozituar edhe kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, e cila është dërguar në Gjykatën e Lartë bashkë me mendimin e gjyqtarës relatore dhe për të nuk është caktuar një datë shqyrtimi. Duke pasur parasysh efektet e Reformës në Drejtësi, si dhe riorganizimin e sistemit gjyqësor me hartën e re gjyqësore, mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime të gjyqtarit në kundërshtim me ligjin. Shqyrtimi i çështjeve në respektim të parimit të prioritetit në kohë, realizohet duke marrë në konsideratë atë më të hershme të regjistruar dhe aktualisht gjykata e apelit dhe gjyqtari relator kanë në shqyrtim çështje të regjistruara në vitin 2017.

15.3 Pretendimi për konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për përsheptimin e gjykimit, të cilin kërkuësja e ka lidhur me mosshqyrtimin e kërkesës nga Gjykata e Lartë brenda afatit 45-ditor, nuk përbën lëndë kushtetuese, pasi nuk janë shteruar mjetet juridike në dispozicion. Neni 399/2, pika 3, i

KPC-së ka parashikuar se pamundësia objektive në procedim është rrethanë që bllokoi konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Kërkuësja ka paraqitur në gjykatën e apelit kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm rreth 3 muaj pasi çështja është regjistruar në atë gjykatë, e cila i është dërguar Gjykatës së Lartë. Pretendimet se kjo kërkesë nuk është shqyrtuar brenda afatit 45-ditor nuk janë ngritur në nivel kushtetues dhe në mungesë të veprimeve që përbëjnë administrim të parregullt gjyqësor të çështjes e që lidhen me aspekte subjektive të gjyqtarit, nuk mund të konstatohet shkelje e afatit të arsyeshëm.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

16. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

17. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata vëren se në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, kërkuësja duhet të provojë legjitimitetin e saj si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individ, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të.



18. Për sa i përket interesit të kërkuësës për të vënë në lëvizje këtë gjykim kushtetues, subjekti i interesuar, MD-ja, ka pretenduar se në aspektin substancial ajo nuk ka arritur të argumentojë përmbushjen e kriterëve për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, sipas nenit 71/a, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, në drejtim të pasojave negative të drejtpërdrejta dhe reale dhe se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata do të mund të rivendoste të drejtën e shkelur.

19. Gjykata vëren se edhe pse qëllimi i dispozitave procedurale, nenet 399/1 e vijues të KPC-së, është që sigurojnë përshpejtimin e procedurave që janë duke u zhvilluar përpara organit kompetent, ato kanë parashikuar edhe një mjet kompensues, përmes të cilit palës i njihet e drejta e “shpërblimit të drejtë” për çdo dëm të pësuar si rezultat i tejzgjatjes jo të arsyeshme të procedurave dhe të konstatuar të tillë me vendim gjyqësor. Kërkuësja, ndërkohë që procesi gjyqësor i themelit në çështjen e saj ishte ende në pritje, ka përdorur mjetin juridik në dispozicion për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave. Për shkak të vendimmarrjes së Gjykatës nr. 2, datë 17.2.2022, me të cilën është njohur shkelja e afatit të arsyeshëm dhe është përcaktuar detyrimi i Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar çështjen brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të atij vendimi, kërkuësja ka paraqitur në gjykatën e shkallës së parë kërkesëpadi me objekt shpërblimin e dëmit, e cila është pranuar pjesërisht, duke u përcaktuar detyrimi i subjekteve të interesuara që të paguajnë në favor të saj shumën 200,000 lekë. Mbi bazën e ankimit të palës së paditur në atë proces, çështja është regjistruar në gjykatën e apelit, proces në të cilin kërkuësja është palë dhe për të cilin ka vënë sërish në lëvizje gjykimin kushtetues.

20. Sipas GJEDNJ-së, një vendim ose masë e favorshme, parimisht, është e mjaftueshme për të përjashtuar statusin e “viktimës” vetëm nëse autoritetet kombëtare kanë njohur në mënyrë të shprehur dhe në thelb shkeljen dhe e kanë riparuar atë (*shih Simaldone kundër Italisë, nr. 22644/03, datë 31.3.2009*). Në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave çështja nëse kërkuësi ka marrë riparim për dëmin e shkaktuar, që krahasohet me shpërblimin e drejtë, sipas nenit 41 të Konventës, është një çështje e rëndësishme. Aty ku autoritetet vendase kanë gjetur shkelje dhe vendimet e tyre përbëjnë korrigjim të mjaftueshëm, pala e interesuar nuk mund të

pretendojë më se është viktimë në kuptim të nenit 34 të Konventës. Për këtë qëllim GJEDNJ-ja ka përcaktuar disa karakteristika që një mjet i tillë korrigjues duhet të ketë, duke pasur parasysh faktin se pretendimi për statusin e viktimës do të varet nga korrigjimi që mjeti i brendshëm do t'i ketë dhënë kërkuësit (*shih Apicella kundër Italisë [DhM], nr. 64890/01, §§ 70–71; Scordino kundër Italisë (nr. 1) [DhM], nr. 36813/97, § 182, ECHR 2006 V*).

21. Gjykata vëren se edhe pse gjykata e shkallës së parë ka pranuar padinë e kërkuësës për shpërblimin e dëmit moral si pasojë e konstatimit të shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e themelit të çështjes së saj, ky vendim nuk ka marrë ende formë të prerë, sepse është ankimuar nga pala e paditur në atë proces gjyqësor. Ky ankim është regjistruar në gjykatën e apelit në datën 17.11.2022 dhe ende nuk është caktuar një datë për shqyrtimin e tij, edhe pse, sipas kërkuësës, çështje të kësaj natyre duhet të shqyrtohen brenda 3 muajve nga data e regjistrimit, sipas parashikimeve të nenit 399/7, pika 1, të KPC-së.

22. Në përgjigje të shkresave të dërguara nga Gjykata për informacion, gjykata e apelit ka mbajtur qëndrimin se shqyrtimi i çështjes civile të kërkuësës do të realizohet në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë datën e regjistrimit të saj në gjykatë, sipas nenit 460, pika 2, të KPC-së dhe se për këto çështje ndiqen rregullat dhe afatet e shqyrtimit të parashikuara nga KPC-ja (*shih paragrafët 47–48*).

23. Për sa më sipër, Gjykata vëren se kërkuësja, edhe pse ka kaluar rreth 1 vit nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka vendosur shpërblimin e dëmit, pra nga dhënia e masës së favorshme ndaj saj, ajo jo vetëm që nuk ka mundur ta ekzekutojë këtë vendim, por është ende në pritje të shqyrtimit të ankimit në gjykatën e apelit, e cila, për më tepër, mban qëndrimin se kjo çështje do të shqyrtohet në përputhje me afatet e përgjithshme procedurale. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuësja nuk e ka humbur statusin e viktimës, në drejtim të përshtatshmërisë dhe efektivitetit të mjetit kompensues.

24. Për rrjedhojë, kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi provon interesin e drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.



25. Një kriter tjetër është edhe ai për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Duke qenë se mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimin nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Thënë ndryshe, ky rregull nënkupton që kërkuuesi duhet të shterojë vetëm mjetet juridike “efektive”, përpara se t’i drejtohet Gjykatës, në kuptimin e shterimit vetëm të atyre mjeteve juridike, të afta për të rivendosur të drejtën, që pretendohet se është shkelur. Në të kundërt, vetë Gjykata rrezikon të mos konsiderohet si një “mjet efektiv” (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Për këtë kriter kërkuësja ka pretenduar se ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, duke parashtruar se bazuar në nenet 399/4 dhe 399/5 të KPC-së ka depozituar, përpara gjykatës në vonesë (gjykatës së apelit), kërkesë për përshpejtimin e procedurës së gjykimit të dëmshpërblimit në shkallë të dytë, kërkesë kjo që nuk i është dërguar Gjykatës së Lartë brenda 15 ditëve, sipas nenit 399/7, pika 2, të KPC-së. Subjekti i interesuar, MD-ja, ka prapësuar se kërkuësja nuk i ka shteruar mjetet juridike, pasi nga dokumentet bashkëlidhur ankimit kushtetues nuk provohet që ajo të ketë depozituar kërkesë në Gjykatën e Lartë për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit për dëmshpërblim.

27. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë këto qëndrime të palëve, vlerëson se duhet të analizojë nëse kriteri kushtetues për shterimin e mjeteve juridike efektive, në rastet kur individ i kërkon shpërblimin e dëmit që i ka ardhur nga shkelja e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, përfshin detyrimin e individit për të paraqitur kërkesë për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit në kuptim të neneve 399/1 e vijues të KPC-së.

28. Gjykata vëren se pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 ajo ka mbajtur qëndrimin se nuk mund të investohej drejtpërdrejt për shqyrtimin e kërkesave për konstatimin e

cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, duke arsyetuar se legjislacioni i brendshëm parashikon tashmë mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 3, datë 11.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, individ duhet t’u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që u ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimin nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Duke qenë këto mjete të reja, si dhe duke pasur parasysh qëndrimin e GJEDNJ-së për çështje të kësaj natyre, Gjykata e ka konsideruar të shteruar këtë kriter si në rastet kur Gjykata e Lartë është shprehur me vendim, ashtu edhe në rastet e mungesës së një vendimi (*shih vendimet nr. 25, datë 11.5.2023; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata vëren se, në ndryshim nga sa prapëson subjekti i interesuar, kërkuësja formalisht i është drejtuar gjykatës së apelit (gjykata në vonesë) me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt gjatë gjykimit të ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që i ka njohur shpërblimin e dëmit (jopasuror) për shkak të vonesës në gjykimin e themelit. Gjykata e apelit ia ka përcjellë me vonesë këtë kërkesë gjykatës kompetente dhe Gjykata e Lartë ende nuk e ka shqyrtuar atë. Në vijim, Gjykata vëren, gjithashtu, se kërkuësja i është drejtuar asaj me kërkesën në shqyrtim për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt, jo në lidhje me procesin e themelit të çështjes së saj, për të cilin asaj tashmë i është njohur shkelja e afatit të arsyeshëm dhe urdhëruar përshpejtimi i procedurës së gjykimit, si dhe për këtë shkak, edhe shpërblimi i dëmit (jopasuror), por në lidhje me procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në gjykatën e apelit për shqyrtimin pikërisht të ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka vendosur masën e shpërblimit për dëmin e shkaktuar nga kjo vonesë në gjykimin e themelit. Në këtë kuptim, rezulton se përmes mjeteve juridike të mbrojtjes që KPC-ja ka ofruar për garantimin e së drejtës për proces të rregullt në procesin gjyqësor në të cilin janë vënë në diskutim të drejtat e saj substanciale, konkretisht e drejta e pronës private, kërkuësja ka kërkuar që të mbrohet edhe në proceset gjyqësore për shqyrtimin e kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm,



përsheptimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit, në kuptim të neneve 399/1 e vijues të KPC-së.

30. Gjykata thekson se, bazuar në nenin 42 të Kushtetutës, ajo shqyrton pretendimin kryesor që lidhet me kohëzgjatjen e gjykimit të themelit që zhvillohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ndërsa procedurat dhe vendimet gjyqësore që shqyrtojnë kërkesat për përsheptimin e procedurave janë në funksion pikërisht të kësaj të drejte kushtetuese dhe nuk mund të qëndrojnë në mënyrë autonome nga pretendimi kryesor. Pavarësisht se kërkuësja ka kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt edhe në procesin që është duke shqyrtuar vendimarrjen që ka të bëjë me mjetin riparues/korrigjues, në thelb çdo veprim ose mosveprim i organeve kompetente në këtë fazë lidhet me vetë natyrën e mjetit riparues/korrigjues që ka ofruar legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave substanciale të individit, pra me efektivitetin e tij në praktikë. Për këtë arsye, individit nuk mund t'i kërkohej që edhe gjatë këtij procesi të përdorë apo të shpëtojë mjetet juridike që parashikojnë nenet 399/1 e vijues të KPC-së, pasi një qëndrim i ndryshëm do të bënte që këto mjete të humbnin qëllimin e tyre dhe do t'i vinin individit një barrë të tepruar, pasi do e detyronin atë të iniciojë procese gjyqësore për të siguruar shpejtësinë dhe efektivitetin e një mjeti që në vetvete ka për qëllim përsheptimin dhe parandalimin e shkeljes së kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor.

31. Sipas GJEDNJ-së, t'i kërkohej kërkuësit të paraqesë një kërkesë të re për t'u ankuar për kohëzgjatjen e tepruar të zbatimit të vendimit që ka dhënë një masë korrigjuese/kompensuese, do të ishte njësoj si ta mbyllje atë në një rreth vicioz në të cilin mosfunksionimi i një mjeti juridik do ta detyronte atë të iniciojë një tjetër. Një përfundim i tillë do të ishte i paarsyeshëm dhe do të përbënte një pengesë joproporcionale për ushtrimin efektiv nga kërkuësi të së drejtës së tij të ankimit individual, siç përcaktohet në nenin 34 të Konventës (*shih Vaney kundër Francës*, nr. 53946/00, § 53, datë 30.11.2004; *Simaldone kundër Italisë*, nr. 22644/03, datë 31.3.2009).

32. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret kërkuësja legjitimohet t'i drejtohet asaj drejtpërdrejt me kërkesë për të shqyrtuar efektivitetin e mjetit kompensues. Për këtë arsye, edhe pse kërkuësja, formalisht, ka paraqitur në gjykatat e zakonshme kërkesë për konstatimin e

vonesës në shqyrtimin e çështjes së saj civile, një rrethanë e tillë nuk është e rëndësishme në drejtim të legjitimitetit të saj në aspektin kushtetues, pasi ky lloj gjykimi nuk kërkon shterimin e mjeteve juridike.

33. Në lidhje me verifikimin e kriterit *ratione temporis*, Gjykata vëren se sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa paraqitet brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se në rastet kur është e qartë se kërkuësi nuk ka asnjë mjet juridik efektiv, afati për t'iu drejtuar asaj fillon nga data e aktit të kundërshtuar ose data në të cilën ai është prekur drejtpërdrejt ose ka marrë dijeni për efektet negative të aktit (*shih Mandija kundër Shqipërisë*, nr. 60262/10, datë 19.1.2023). Për më tepër, kur shkelja e pretenduar përbën një situatë të vazhdueshme kundër së cilës nuk ka mjete juridike të brendshme, afati i ankimit fillon të ecë vetëm kur kjo situatë përfundon (*shih Sabri Güneş kundër Turqisë [DhM]*, nr. 27396/06, §54, datë 29.6.2012). Për sa kohë që situata vazhdon, ky rregull nuk është i zbatueshëm (*shih Iordache kundër Rumanisë*, § 50; *Oliari dhe të tjerët kundër Italisë*, §§ 96–97). Sipas asaj gjykate, fakti që një ngjarje ka pasoja të rëndësishme me kalimin e kohës, nuk do të thotë se ngjarja ka prodhuar një "situatë të vazhdueshme" (*shih Iordache kundër Rumanisë*, § 49; *Călin etj. Rumanisë*, §§ 58–60). Megjithatë, një situatë e vazhdueshme nuk mund të shtyjë për një kohë të pacaktuar zbatimin e afatit të paraqitjes së kërkesës. GJEDNJ-ja ka përcaktuar detyrimin për të treguar kujdesin e duhur dhe iniciativën për aplikantët që dëshirojnë të ankohen për dështimin e vazhdueshëm të shtetit për të përmbushur disa prej detyrimeve të tij (*shih Varnava etj. kundër Turqisë [DhM]*, §§ 159–172; *Sargsyan kundër Azerbajxhanit [DhM]*, §§ 124–148; *Sokolov etj. kundër Serbisë*, §§ 31–36).

34. Referuar akteve bashkëlidhur kërkesës rezulton se çështja e kërkuëses, e vënë në lëvizje mbi ankimin e subjektit të interesuar, MD-së, është regjistruar në gjykatën e apelit në datën 17.11.2022. Me kërkesat e datave 20.12.2022 dhe 30.1.2023, kërkuësja i është drejtuar gjyqtarës relatore për përsheptimin e shqyrtimit të çështjes, kurse në datën 20.2.2023, ka paraqitur në gjykatën e apelit (si gjykata në vonesë) kërkesë drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes dhe detyrimin e gjykatës së apelit për ta gjykuar brenda një afati 30-ditor. Pasi ka kërkuar informacion nga gjykata e apelit dhe Gjykata



e Lartë për kërkesën e saj, si dhe pasi është informuar nga kjo e fundit se nuk kishte një kërkesë të tillë të regjistruar në atë gjykatë, në datën 24.4.2023 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues. Për rrjedhojë, për sa kohë që çështja e kërkuësës në gjykatën e apelit nuk është shqyrtuar ende dhe duke qenë se në rastin konkret vihet në diskutim efektiviteti i mjetit juridik, kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis* për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.

35. Në lidhje me kriterin e legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuësja ka kërkuar si konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të çështjes nr. 21234-02321-30-2022, datë regjistrimi 17.11.2022, e lidhur kjo me mënyrën se si ajo gjykatë ka zbatuar dispozitat procedurale për afatin e shqyrtimit të çështjeve që lidhen me shpërblimin e drejtë, ashtu edhe konstatimin e mungesës së një mjeti ligjor efektiv për përshpejtimin e gjykimit, të lidhur me mosshqyrtimin brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë të kërkesës për kohëzgjatjen e gjykimit në gjykatën e apelit. Për rrjedhojë, në kuptim të mënyrës se si janë parashtruar pretendimet e kërkuësës, Gjykata vlerëson që ta shqyrtojë pretendimin për konstatimin e shkeljes së të drejtës për proces të rregullt në drejtim të efektivitetit të mjetit juridik kompensues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për konstatimin e shkeljes të së drejtës për proces të rregullt për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues

36. Sipas kërkuësës, çështje të kësaj natyre duhet të shqyrtohen në përputhje me parashikimet e nenit 399/7, pika 1, të KPC-së, brenda 3 muajve nga data e regjistrimit, ndërkohë që çështja (ankimi) është regjistruar në gjykatën e apelit më 17.11.2022 dhe ende nuk ka përfunduar shqyrtimi i saj. GJEDNJ-ja në çështjen *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë* ka theksuar nevojën që këto procedura të kryhen në mënyrë të menjëhershme që zgjidhja të mbetet efektive, duke vlerësuar se shqyrtimi i këtyre kërkesëpadive bëhet sipas rregullave të posaçme, të cilat ndryshojnë nga ato të padive të zakonshme. Edhe pse kërkuësja ka paraqitur në gjykatën që është në vonesë kërkesë për përshpejtimin e gjykimit, ajo nuk i është dërguar Gjykatës së Lartë për shkak të sjelljes, papërgjegjshmërisë së gjykatës së apelit.

37. Subjekti i interesuar, MD-ja, ka prapësuar se sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, afati i gjykimit të çështjeve civile në gjykatat e apelit është brenda 2 vjetëve dhe pretendimi se çështje të kësaj natyre duhen gjykuar brenda 3 muajve, sipas përcaktimeve të nenit 399/7, pika 1, të KPC-së, është i pabazuar, pasi kjo dispozitë përcakton afatin për shqyrtimin e padive sipas nenit 399/6, pika 3, të KPC-së lidhur me kërkesëpaditë për shpërblimin e dëmit që u drejtohen gjykatës së shkallës së parë. Edhe në rast se do të merrej në konsideratë ky pretendim, referuar kriterëve për përcaktimin e kohëzgjatjes së arsyeshme, mosveprimi i gjykatës së apelit duhet parë nën dritën e rrethanave konkrete në të cilat ndodhet aktualisht sistemi gjyqësor, siç janë zbatimi i Reformës në Drejtësi, riorganizimi rishtazi i gjykatave të apelit dhe ngarkesa totale individuale e gjyqtarit relator

38. Sipas subjektit të interesuar, MFE-së, referuar nenit 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, afati 2-vjeçar i shqyrtimit të çështjes prezumohet të plotësohet më 17.11.2024, ndërkohë që parashikimi i nenit 399, pika 2, shkronja “b”, të KPC-së nënkupton konstatimin e cenimit edhe pa kaluar ky afat, me kusht që të verifikohen në mënyrë kumulative kompleksiteti i çështjes, sjellja e organit që procedon, zvarritja e qëllimshme etj. Në rastin konkret nuk ndodhemi para një shkeljeje të qëllimshme të afatit të arsyeshëm, por para një situatë objektive të ngarkuar të sistemit gjyqësor, që në gjykatën e apelit lidhet edhe me riorganizimin e saj për shkak të miratimit të hartës së re gjyqësore.

39. Kurse sipas Avokaturës së Shtetit, çështja është regjistruar në gjykatën e apelit në datën 17.11.2022, për rrjedhojë nuk është kaluar afati 2-vjeçar i parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, pasi ligjvënësi nuk ka parashikuar në nenin 399/7 afat për gjykimin në gjykatën e apelit. Çështja konkrete lidhet me shpërblimin e dëmit në bazë të nenit 399/6, pikat 2 dhe 3, të KPC-së, për rrjedhojë tejzgjatja e procedurave gjyqësore nuk paraqet shkallë të konsiderueshme rreziku për interesin e kërkuësës. Neni 399/2, pika 3, i KPC-së ka parashikuar se pamundësia objektive në procedim është rrethanë që bllokon konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Në mungesë të veprimeve nga ana e gjykatës, që përbëjnë administrim të parregullt gjyqësor të çështjes e që lidhen me aspekte subjektive të gjyqtarit, nuk mund të konstatohet shkelje e afatit të arsyeshëm.



40. Gjykata vëren se sipas GJEDNJ-së zgjidhjet në dispozicion të një individi në nivel të brendshëm për paraqitjen e një ankimi, në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave, janë “efektive”, sipas interpretimit të nenit 13 të Konventës, nëse ato mund të përdoren për të përshpejtuar procedurat përpara gjykatave kombëtare ose nëse i garantojnë individit korrigjimin e duhur për vonesat të cilat kanë ndodhur. Në rastin kur një sistem i brendshëm ligjor bën një parashikim për miratimin e një mase ndaj shtetit, një masë e tillë duhet të mbetet efektive, e mjaftueshme dhe e aksesueshme në përputhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave gjyqësore. Mjaftueshmëria e saj varet nga vonesat e tepërta dhe nga niveli i kompensimit (*shih Bara dhe Kola, nr. 43391/18 dhe 17766/19, datë 12.10.2021, §105*).

41. GJEDNJ-ja ka pohuar se sipas nenit 13 të Konventës, një mjet është efektiv nëse ai mund të përdoret ose për të përshpejtuar dhënien e vendimit nga gjykata që shqyrton çështjen, ose për t'i siguruar palës korrigjimin për vonesat që kanë ndodhur tashmë (*shih Sürmeli kundër Gjermanisë [DhM], 2006, §99*). Sipas saj, ky nen i Konventës i lejon një shteti të zgjedhë midis një mjeti “parandalues ose përshpejtues”, që synon përshpejtimin e procedurave në mënyrë që të parandalojë që ato të tejzgjasin dhe një mjeti “riparues, kompensues ose monetar”, që parashikon korrigjimin *ex post facto* për vonesat që kanë ndodhur tashmë, qoftë edhe nëse procedura është ende në shqyrtim apo ka përfunduar. Ndërkohë që disa shtete kanë zgjedhur t'i kombinojnë këto 2 lloje mjetesh. Sipas GJEDNJ-së, ndërsa mjeti parandalues është i preferueshëm, një mjet kompensues mund të konsiderohet si efektiv kur procedurat tashmë kanë qenë tepër të gjata dhe nuk ka asnjë mjet parandalues të disponueshëm (*Kudla kundër Polonisë [DhM], 2000, §158; Scordino kundër Italisë (nr. 1) [DhM]*). Për sa i përket përshtatshmërisë dhe mjaftueshmërisë së një kompensimi të tillë, ky përfundim zbatohet vetëm me kushtin që një kërkesë për kompensim të mbetet në vetvete një mjet juridik efektiv, i përshtatshëm dhe i aksesueshëm në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave gjyqësore (*shih Mifsud kundër Francës [DhM], 2002, §17*). GJEDNJ-ja ka vlerësuar se zgjidhja më e mirë është parandalimi (*shih Sürmeli kundër Gjermanisë [DhM], 2006, §100; Wasserman kundër Rusisë (nr. 2), 2008, §47; Burdov kundër Italisë, 2016, §45*).

42. Si përgjigje ndaj vendimit në çështjen *Luli etj. kundër Shqipërisë* (nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë), datë 1.4.2014, në respektim të nenit 46 të Konventës, shteti shqiptar ka vendosur një zgjidhje të brendshme në lidhje me kohëzgjatjen e tepruar të procedimeve. Kështu ligjvënësi ka bërë një parashikim për një zgjidhje përshpejtuese/parandaluese dhe kompensuese në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, efikasiteti i përgjithshëm i së cilës, në kuptim të nenit 13 të Konventës, është vlerësuar edhe nga GJEDNJ-ja në çështjen *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, duke arritur në përfundimin se zgjidhja për përshpejtimin e procedurave dhe ofrimin e kompensimit është efikase, pasi mund të parandalojë vijimësinë e shkeljes së pretenduar të së drejtës së individit, që çështja e tij të dëgjohet pa vonesa të tepërta, si dhe të garantojë korrigjimin e duhur për shkeljet që kanë ndodhur. Për pasojë, zgjidhja e ligjvënësit shqiptar, në parim, përmbush detyrimin e shtetit për të garantuar mjete efikase në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të një individi sipas Konventës (*shih Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, §119*).

43. Për verifikimin e efektivitetit të një mjeti kompensues në lidhje me tejzgjatjen e proceseve gjyqësore, sipas GJEDNJ-së, padia për kompensim duhet të shqyrtohet brenda një afati të arsyeshëm (*shih Scordino kundër Italisë (nr. 1) [DhM], 2006, §194*); kompensimi duhet të paguhet menjëherë, në parim jo më vonë se 6 muaj pasi vendimi që e ka dhënë atë është bërë i ekzekutueshëm (*po aty §198*); rregullat procedurale që rregullojnë një padi për kompensim duhet të jenë në përputhje me parimet e procesit të drejtë, të garantuar nga neni 6 (*po aty, §200*). GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje të nenit 13 në dritën e nenit 6 §1, edhe në rastet kur nuk mund të sigurohet një kompensim i shpejtë, së bashku me një dëmshpërblim të pamjaftueshëm (*Wasserman kundër Rusisë (nr. 2), 2008, §§ 54–58*). Nëse shteti ka marrë një hap të rëndësishëm, duke miratuar një zgjidhje kompensuese, kjo zgjidhje duhet të lejojë një hapësirë më të gjerë në vlerësimin e shtetit për t'i mundësuar që ta organizojë zgjidhjen në mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me sistemin e tij ligjor dhe traditat ligjore, si dhe të jetë në harmoni me standardin e jetës në vendin në fjalë (*shih Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, §110*).

44. Rregullat procedurale për shqyrtimin e kërkesëpadisë për kompensim duhet të jenë në përputhje me parimin e drejtësisë të parashikuar në



nenin 6 të Konventës. Kjo kërkesëpadi duhet të paraqitet pas konstatimit të shkeljes së kërkesës për “afat të arsyeshëm” në një nivel të juridiksionit dhe në lidhje me këtë aspekt, në parim, individët duhet të kenë mundësinë të ngrenë padi, në lidhje me kohëzgjatjen në tërësi të procedurave, deri në pikën që, në varësi të çështjes, mund të përfshihen një sërë nivelesh të juridiksionit. GJEDNJ-ja ka theksuar nevojën për t’i kryer këto procedura në mënyrë të menjëhershme, në mënyrë që zgjidhja të mbetet efektive. Në lidhje me këtë aspekt, duhet të mbahet në konsideratë shqyrtimi i këtyre padive sipas rregullave të posaçme, të cilat ndryshojnë nga ato që përdoren për paditë e zakonshme për shpërblim dëmi, për të shmangur rrezikun - në rastin kur shqyrtohen sipas rregullave të përgjithshme të procedurës civile - që zgjidhja të mos jetë mjaftueshëm e shpejtë (*shih Bara dhe Kola kundër Shqipërisë* §§ 112–115). I takon çdo shteti të përcaktojë, në bazë të rregullave të zbatueshme në sistemin e tij gjyqësor, se cila procedurë do të përmbushë më mirë kriterin e detyrueshëm të “efektivitetit”, me kusht që procedura të jetë në përputhje me parimin e drejtësisë të garantuar nga neni 6 i KEDNJ-së (*shih Simaldone kundër Italisë*, nr. 22644/03, datë 31.3.2009).

45. Kurse në lidhje me masën e kompensimit një shtet, i cili ka miratuar një sërë zgjidhjesh, njëra prej të cilave ka si synim përshpejtimin e procedurave dhe një tjetër kompensimin, mund të japë shuma që, edhe pse më të ulëta se sa ato të dhëna nga GJEDNJ-ja, nuk janë të paarsyeshme, me kushtin që vendimet në fjalë, të cilat duhet të jenë në përputhje me traditën ligjore dhe standardin e jetesës të atij vendi, të jenë të shpejta, të arsyetuara dhe të ekzekutohen shpejt. Po sipas GJEDNJ-së, zbatimi i menjëhershëm i vendimeve që japin kompensim ka rëndësi në mënyrë që zgjidhja të vijoje të jetë efikase (*shih Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, §§ 116–117).

46. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata konstaton se sipas nenit 399/3 të KPC-së shpërblimi i drejtë për shkeljen e afatit të arsyeshëm do të konsiderohet njohja e shkeljes, çdo masë e marrë për të përshpejtuar procedurat e hetimit, gjykimit të çështjes dhe të ekzekutimit të vendimit, dhe/ose shpërblimin e dëmit, sipas përcaktimeve të kreut X të titullit III të KPC-së. Sipas nenit 399/4, kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave i drejtohet gjykatës kompetente, sipas nenit 399/6, pika 1, kurse

kërkesëpadia, sipas nenit 399/6, pika 3, i drejtohet gjykatës civile të shkallës së parë kompetente, sipas rregullave të përgjithshme, vetëm pasi procedura e konstatimit të shkeljes dhe përshpejtimin të procedurës është ezauruar sipas pikës 1 të këtij neni, dhe nuk është ekzekutuar nga organi që ka kryer shkeljen vendimi i gjykatës, sipas pikës 1 të këtij neni. Neni 399/6 parashikon gjykatën kompetente për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave dhe sipas pikës 3 të tij, kërkesëpadia për shpërblimin e dëmit i drejtohet gjykatës civile të shkallës së parë ku ka qendrën organi ndaj të cilit është konstatuar shkelja. Padia parashkruhet brenda 6 muajve nga konstatimi i shkeljes me vendim të formës së prerë. Në lidhje me shqyrtimin e kësaj padie, neni 399/7 parashikon se ajo bëhet sipas rregullave të zakonshme të gjykimit brenda një afati 3-mujor nga depozitimi i saj.

47. Për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, me shkresat nr. 720/3 prot., datë 18.7.2023 dhe nr. 720/8 prot., datë 1.9.2023, Gjykata ka kërkuar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm kopje të dosjes gjyqësore që i përket çështjes civile ku kërkesja është palë, si dhe informacion në lidhje me kërkesën për përshpejtim gjykimi dhe konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe rregullat që ajo gjykatë ndjek për shqyrtimin e çështjeve me objekt shpërblimin e dëmit si rezultat i konstatimit të cenimit të afatit të arsyeshëm.

48. Me shkresën nr. 10412/1 prot., datë 31.8.2023, gjykata e apelit ka informuar Gjykatën në lidhje me ecurinë e kësaj çështjeje civile që prej regjistrimit të saj, si dhe se shqyrtimi i saj do të realizohet në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë datën e regjistrimit në atë gjykatë, sipas nenit 460, pika 2, të KPC-së. Sipas gjyqtarës relatores prej saj nuk ka asnjë mosveprim që të ketë krijuar vonesa apo të ketë dhënë shkas për vonesa në shqyrtimin e kësaj çështjeje. Me shkresën nr. 720/8 prot., datë 1.9.2023, Gjykata i është drejtuar sërish gjykatës së apelit, duke kërkuar prej saj kopje të dosjes gjyqësore që i përket çështjes civile të kërkeses, informacion në lidhje me kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, si dhe për rregullat që ndiqen për shqyrtimin e çështjeve civile që kanë për objekt shpërblimin e dëmit si rezultat i konstatimit të cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Me shkresën nr. 11694/1 prot., datë 4.9.2023, gjykata e apelit ka informuar Gjykatën se



kërkesat për përshpejtim drejtuar gjyqtare relatore nuk janë pranuar, kurse kërkesa për konstatimin e cenimit të shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes civile, së bashku me mendimin e gjyqtarit relator, i është përcjellë Gjykatës së Lartë me shkresën nr. 858/2, datë 4.9.2023. Për sa i përket gjykimit të çështjeve civile me objekt shpërblimin e dëmit si rezultat i konstatimit të cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, gjykata e apelit është shprehur se nuk ka ndonjë rregull në lidhje me to, por ndiqen rregullat dhe afatet e shqyrtimit të parashikuara nga KPC-ja.

49. Gjykata ka theksuar se problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë prej saj vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta kushtetuese themelore. Në këto raste, ajo bën një vlerësim të natyrës kushtetuese të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 42, datë 7.7.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Në çështjen konkrete Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizën e afatit 1-vjeçar që ka kaluar nga regjistrimi i ankimit në gjykatën e apelit, pra nëse kjo vonesë është e mjaftueshme për të hedhur dyshime mbi efektivitetin e mjetit juridik, për sa kohë që argumenti i parashtruar nga subjektet e interesuara dhe vetë gjykata e apelit për mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të dispozitave të reja procedurale në drejtëm të afatit ligjor për shqyrtimin e këtyre çështjeve vë në dyshim garantimin e efektivitetit të këtij mjeti. Gjykata, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, vlerëson se në rastin e një mjeti kompensues që ka për qëllim të riparojë pasojat e tejzgjatjes së procedurave, periudha kohore e shqyrtimit të tij nuk mund të tejkalojë një afat të arsyeshëm, pasi kjo do e zhvishte atë nga çdo efekt praktik. Në këtë kuptim, çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre.

51. Referuar përmbajtjes së nenit 399/7 të KPC-së, për sa i përket gjykimit të kërkesëpadisë për shpërblimin e dëmit, ai ka përcaktuar një afat të posaçëm prej 3 muajsh nga depozitimi i saj. Edhe pse kjo dispozitë, e parë së bashku me nenin 399/6, pika 3, të KPC-së, shprehet për shqyrtimin e kërkesëpadisë dhe nuk i referohet shqyrtimit të ankimit, qasja e ofruar nga vetë gjykata e apelit për mënyrën e zbatimit të saj nuk përputhet me përmbajtjen dhe qëllimin e dispozitave që kanë rregulluar mjetet mbrojtëse korrigjuese/kompensuese, të cilat kanë synuar që këto lloj gjykimesh jo vetëm të riparojnë shkeljen e së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm, por që kjo të sigurohet në një kohë sa më të shpejtë. Kjo pasi çdo qëndrim i ndryshëm nuk do të përputhej me qëllimin e ligjvënësit dhe do të vinte në dyshim efektivitetin e këtyre mjeteve. Në këtë kuptim, interpretimi i ngushtë që gjykata e apelit i bën përmbajtjes së nenit 399/7 të KPP-së cenon vetë thelbin e së drejtës kushtetuese së një individi për të pasur një gjykim të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm.

52. Për sa më sipër, duke pasur parasysh natyrën e këtyre mjeteve juridike, çdo interpretim që do të çonte në kohëzgjatje të tepruar të procesit gjyqësor në gjykatën e apelit, duke penguar palën që i është njohur e drejta e shpërblimit të dëmit për të ekzekutuar vendimin e saj përbën në thelb një kohëzgjatje të tepruar. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se gjykimi i këtyre lloj çështjesh, përfshirë edhe në gjykatën e apelit, duhet të jetë i shpejtë dhe ai nuk mund t'i nënshtrohet afateve të përgjithshme të gjykimit. Ky ka qenë edhe synimi i ligjvënësit kur në nenet 399/1 e vijues të KPC-së ka parashikuar afate të posaçme, të shkurtra, për shqyrtimin e mjeteve mbrojtëse të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Në veçanti, neni 399/7, pika 1, i KPC-së ka parashikuar një afat të posaçëm 3-mujor për gjykimin e mjetit kompensues në shkallë të parë, afat ky që meriton të mbahet parasysh edhe për gjykimin në apel. Gjykatat e zakonshme, gjatë zbatimit të ligjit në ushtrim të funksionit të tyre shfaqen edhe si interpretueset e para të normës ligjore. Për rrjedhojë, ato nuk kishin asnjë pengesë që të interpretonin vetë këto parashikime ligjore në përputhje me qëllimin dhe frymën e ligjvënësit, për të garantuar zhvillimin e procesit brenda afateve sa më të shpejta.



53. Gjykata vlerëson, gjithashtu, të theksojë se konstatimi prej saj i shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues synon të mundësojë rivendosjen sa më shpejt të së drejtës së shkelur kërkueses përmes përsheptimit të procesit në gjykatën e apelit, duke zbatuar kjo e fundit dispozitat procedurale në përputhje me kuptimin e mësipërm. Nga ana tjetër, ky konstatim nuk përbën njohje të një shkeljeje të re në procesin gjyqësor, pra nuk nënkupton se i njeh kërkueses të drejta të tjera në lidhje me afatin e arsyeshëm.

54. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses në lidhje me mungesën e efektivitetit të mjetit kompensues janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Konstatimin e shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 26.9.2023.

Shpallur më 20.10.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtar: Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Marjana Semini

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me vendimin nr. 414, datë 26.5.2023, vendosi zëvendësimin e kujdestarit Ilirjan Qytyku, i biri i Nikollaqit dhe i Gjenës, i datëlindjes 29.4.1970, lindur dhe banues në Berat, caktuar me vendimin nr. 359, datë 29.3.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, si kujdestare të shtetases Vasilika Qytyku, me kërkuesen Heroina Levenaku, me numër personal J56016071C, e bija e Shefqetit dhe e Vasilikës, e datëlindjes 16.10.1995, vendlindja Berat, vendbanimi Berat, gjendja civile beqar, shtetase shqiptare, si kujdestare e shtetases (nënës) Vasilika Qytyku, me numër personal G15207056D, bija e Nikollaqit dhe e Gjenës, e datëlindjes 7.2.1961, vendlindja Berat, gjendja civile e divorcuar, shtetësia shqiptar.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 256 lekë